

**ANTROPOLOGJIA E MENDIMIT JURIDIK SHQIPTAR  
PERMES LIRIVE DHE TE DREJTAVE TE NJERIUT  
SI DHE SIGURISE E GARANCISE KUSHTETUESE**

**Mallengjim Skenderaj**

Dorëzuar  
Universitetit European të Tiranës  
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkollën  
Doktorale, me profil E Drejtë Civile, për marrjen e gradës shkencore  
“Doktor”

**Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Ferit Duka**

Numri i fjaleve: 52457

Universiteti European i Tiranës, Dhjetor 2014

## **Abstrakt-**

Per te pasur nje koherence ne qellimin e mendimit juridik shqiptar eshte e nevojshme qe te unifikojme qendrimet tona ne sjelljen juridike, sociale, ekonomike, politike, qe perfundimisht ne formimin e se drejtes , te shkojme si Sovran ne miratimin e ligjeve dhe jo disa me mendimin anglo sakson, disa te tjere me mendimin gjermano romak, apo me mendimin francez dhe disa me mendimin socialist apo komunist dhe ne fund te mos dime se cfare te drejte prodhojme, kur duhet te prodhojme nje te drejte shqiptare ku te jete skalitur mendimi juridik shqiptar dhe ky i fundit te gjejte vendin ne integrimin e funksionit ne te drejten europiane te globalizimit juridik te se drejtes apo te drejtes se globalizuar.

Perqasia me kete legjislacion ben te mundur qellimin e studimit te antropologjise juridike te mendimit juridik shqiptar mes korpusit te lirive dhe te drejtave te njeriut dhe te garantimit dhe sigurimit te ketyre te drejtave dhe lirive nga shteti i se drejtes shqiptare te sanksionuara ne Kushtetute.

Ne metoden shkencore empirizmi eshte parimi qe thekson perfitimin e dijes me ane te pervojes dhe te informacionit shqisor dhe perben bazen e eksperimentit sipas te cilit nuk mjafton mendimi, arsyetimi, parandjenja, bindja e besimi per te provuar realitetin e nje hipoteze, sesa qe kjo duhet testuar dhe vazhduar ne menyre per t'u konsideruar e mirqene. Kjo na ndihmon te gjejme “guret e pare te kilometrazhit” qe kane vlejtur per kete Shqiperi te kultivuar qe ne kemi sot.

(...) Por reticenca, heshtja, nderprerja ne kohe te ndryshme e veprimit, mendimit dhe fjales na ben te humbasim ne thellesine e kohes duke kerkuar, hulumtuar neper labirinthe dhe duke krahasuar cdo fosil qe shkakton cdo dyshim se nga vijme, ku jemi dhe ku do te shkojme!

Nese veprimi ka fosilet e veta, po ashtu edhe mendimi dhe fjala kane fosilet e tyre. Te tria si nje trekendesh barabrinjes dhe si nje trinom i pa ndashem i jetes do te na cojne tek lindja, zhvillimi dhe konsolidimi i mendimit juridik shqiptar.

Prona dhe e drejta e pronesise eshte fermenti i kultures juridike per te ardhur te vokacioni i jehones juridike qe te fitojme sigurine juridike, politike, ekonomike e sociale!

**Fjalet kyce:** antropologjia juridike, mendimi juridik, shteti i se drejtes, Kushtetute, prona dhe pronesia

## **Abstrakt-**

To have a coherence in the scope of the Albanian legal opinion is needed to unify our positions in legal behavior, social, economic, political, ultimately to the formation of law, to go as sovereign state in the adoption of laws and not some Anglo Saxon opinion, others with German- Roman opinion or French thought and some socialist or communist opinion and in the end not know what do right produce, when it takes to produce an Albanian rightwhere to be sculpted Albanian juridical opinion and the latter to find the place in the integration of function in the European right to legal globalization of the right or the right of globalized.

The approach to this legislation enables the scope of legal anthropology study Albanian legal opinion between the corpus of freedoms and human rights and to guarantee and ensure these rights and freedoms by the legal state of the Albanian law enshrined in the Constitution.

In the empiricism scientific method is the principle that emphasizes the benefit of knowledge through sensory experience and information, and constitutes the basis of the experiment, according to which not enough thought, reasoning, intuition, conviction and belief to prove the reality of a hypothesis, rather than that it should tested and continuing in order to be taken for granted. This helps us to find "the first stones mileage" was worth it for this Albania we have cultivated that we have today.

(...) But reticence, silence, interruption at different times of action, thought and speech makes us lose the depth of time looking, researched through labyrinths and comparing you every fossil that causes you every doubt that we come from, where we are and where we are going!

If the action has its fossils, as well as thought and word have their fossils. All three as an equilateral triangle and as a detachable trinomial of life will lead us to the birth, development and consolidation of the Albanian legal opinion.

Property and the right of ownership are legal culture yeasts to come to legal feedback vocation of acquiring legal, political, economical and social security!

**Keywords:** legal anthropology, legal opinion, the rule of law, the Constitution, property and ownership

## **DEDIKIMI**

- Qe te jesh “Embleme profesonale” duhet te jesh frut i merituar i nje pune te veshtire dhe plot pasion e mbi te gjitha ta duash profesionin, ta adhurosh ate.

Une e kerkoj kete embleme.

Ligji eshte nje mates i arte.

Une nje metronom i kohes.

Asgje nuk humbet ne kete jete, cdo gje shnderrohet nga nje gjendje ne nje gjendje tjeter.

andaj, ky dedikim shkon per familjen time, gruan time Flora dhe dy djemte e mi Andi dhe Jon.

## **FALENDERIME**

Kam tentuar te rifolmuloj disa ceshtje thelbesore e te ndjek nje drejtim qe s'eshte eksploruar deri ne fund.

Jam i ndergjegjshem per karakterin e vacante te ketij kerkimi dhe shpresoj qe ne te ardhmen t'i trajtoj edhe me gjere disa nga keto probleme e ne vecanti ato qe i perkasin nje teorie te "Antropologjigjise Ligjore".

Idete qe trajtohen ne kete punim "teme jane paraqitur ne formen e" Eseve Juridike".

Deshiroj te falenderoj drejtuesin tim per kete punim "teme"mentorin Prof.Dr.Ferit Duka i cili me prudencen e tij gjendet gjithmone permes ketyre rreshtave te renditura enkas nga ana ime.

Duke i pasur borxh nje mirnjohje te thelle stafit akademik dhe drejtuesve te "U E T" te cilet me hapen deren e studimeve ne Shkollen Doktorale me nje reverance te vecante dhe bashkekohore, ate te respektimit te ideve .

Persa i perket permbajtjes se ketij punimi, permes nje teksti sa antopologjik, historik, filozofik, psikologjik, sociologjik, politik, juridik dhe krahasues ne epoken e globalizimit, pergjegjesia me perket vetem mua.

Faktikisht pozicioni im teorik i drejtohet se tepermi truallit te amesise dhe atesise si dhe prinderimit permes librave te cilat asnjehere nuk jane nje rastesi por nje "A D N" e nje anamneze familjare, vite e morbi.

## **PERMBAJTJA E LENEDES**

-Abstrakti

-Dedikimi

-Falenderime

### **KAPITULLI I: HYRJE**

Prolog (Reticence Empirke)..... 11

### **KAPITULLI II: SKELETI TEORIK DHE MODELI ANALITIK I TEMES**

Transkriptim..... 13

2.1. Hyrje dhe Bazimi Teorik..... 13

2.2. Shtrimi i Problemit..... 17

2.3. Qellimi i Studimit..... 20

### **KAPITULLI III: KONTEKSTI HISTORIK**

3.1. Nje veshtrim historik..... 23

### **KREU IV: ANALIZA EMPIRIKE 1**

4.1. Nje veshtrim Antropologjik..... 39

### **KAPITULLI V: ANALIZA 2**

5.1. Pronesia ne mendimin Juridik Shqiptar..... 50

5.2. Nacionalizimi dhe denacionalizimi i prones dhe te drejtes se pronesise ne Shqiperi..... 68

5.3. Mbrojtja e te Drejtave te Njeriut ne Fushen e Internetit ..... 118

Mbrojtja e Prones perballe kriminalitetit kompjuterik

5.4. Mbrojtja e interesave me te larta te femijes..... 141

Permes Lirive dhe te Drejtave te Njeriut dhe Shtetit te se Drejtes

5.5. Mbrojtja e Maredhenieve te Punesimit..... 155

Permes Lirive dhe te Drejtave te Njeriut dhe Shtetit te se Drejtes

KAPITULLI VI: ANALIZA 3

6.1. Ligji e Drejta, Drejtesia.....168

6.2. Lirite dhe te Drejta e Njeriut flasin Shqip.....183

6.3. Epilogu (Procesi Incidental).....196

KAPITULLI VII: KONKLUZIONE.....198

LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA.....205

## **KAPITULLI I: HYRJRE**

### **- PROLOG-**

#### **... RETICENCE EMPIRIKE**

Ne metoden shkencore empirizmi eshte parimi qe thekson perfitimin e dijes me ane te pervojes dhe te informacionit shqisor dhe perben bazen e eksperimentit sipas te cilit nuk mjafton mendimi, arsyetimi, parandjenja, bindja e besimi per te provuar realitetin e nje hipoteze, sesa qe kjo duhet testuar dhe vazhduar ne menyre per t'u konsideruar e mirqene. Kjo na ndihmon te gjejme “guret e pare te kilometrazhit” qe kane vlejtur per kete Shqiperi te kultivuar qe ne kemi sot.

(...) Por reticenca , heshtja, nderprerja ne kohe te ndryshme e veprimit, mendimit dhe fjales na bene te humbasim ne thellesite e kohes duke kerkuar e hulumtuar neper labilinte dhe duke krahasuar cdo fosil qe shkakton cdo dyshim se nga vjime, ku jemi dhe ku do te shkojme. Nese veprimi ka fosilet e veta, po ashtu edhe mendimi dhe fjala kane fosilet e tyre. Te tria si nje trinomi i pa ndare i jetes do te na cojne tek lindja, zhvillimi dhe konsolidimi i mendimit juridik shqiptar.

(...) Reticenca (heshtja), e cila vjen nga latinishtja; Ajo perfitohet duke e keputur menjehere mendimin, zakonisht perpara nje fjale ose shprehje me peshe, me qellim qe te nenkuptohet vazhdimi i tij, pikerisht qe eshte vendosur perpara fjales me shume peshe qe ne rastin konkret eshte “Empirizmi” qe mban ne vetvete peshen e madhe te koheve te kaluara. Por tashme e vendosur edhe mbas fjales me peshe te madhe per vet faktin se na kujton gurin e Sizifit dhe historine e tij. Empirizmi qe vjen nga trajta greke “empiri” qe



do të thote përvije, por dhe “empirizmos” që do të thote përvijesi, është qëndrim filozofik që mbështet rolin thelbësor të përvijes, pra të shqisave, në krijimin e ideve dhe të koncepteve. Mes këtyre dy fjaleve me peshe të madhe” reticence dhe empirizem” të cilat e marrin kuptimin e tyre nga dy gjuhë “te vdekura” latinishtja e vjetër dhe greqishtja e lashtë, mund të instalohemi nëpërmjet antropologjisë juridike, historisë të së drejtës, filozofisë të së drejtës, për të konsoliduar mes provash e faktesh origjinën e mendimit juridik shqiptar, strukturën dhe skeletin e tij si koncentrat të shoqërive të ndryshme të genesishme të cilat ndikuan në krijimin e teorive të së drejtës. Nuk marr për siper të jem sipërmarës i kësaj shkence në lidhje me antropologjinë juridike të së drejtës Shqiptare, por së fillimit të kësaj shkence në Shqipëri duhen parë ngushtesisht me shkencën e antropologjisë së ligjit në përgjithësi. Duke njohur se çfarë përfaqëson antropologjia e ligjit, cili është objekti i saj dhe vendi i saj, në këto kuader, pra në kuadrin e antropologjisë do të kuptojmë dhe do të pranojmë se antropologjia e ligjit synon të ndriçojë procesin e rregulluar të shoqërisë njerëzore. Nisur nga fakti se antropologjia e ligjit e vështron ligjin nga një perspektivë krahasuese ndërkulturore del qartë se qëllimi i saj është të identifikojë principet e përgjithshme.

## **KAPITULLI II: SKELETI TEORIK DHE MODELI ANALITIK I**

### **TEMES**

#### **Transkriptim**

##### **2.1. A. HYRJE DHE BAZIMI TEORIK**

“ Antropologjia e Mendimit Juridik Shqiptar Permes Lirive dhe te Drejtave te Njeriut si dhe Sigurise e Garancise Kushtetuese”

Ky propozim nga ana ime ka te beje me hulumtimin neper labirinhet qe ka kaluar Mendimi Juridik Shqiptar. Pra mbi te gjitha ka te beje me antropologjine juridike apo Antropologjine e se Drejtes e cila eshte shkenca mbi njeriun, ku veç te tjerash meret me sjelljet juridike te njeriut, si dhe sjelljet juridike te shtetit.

Qe te njohesh sa me mire mendimin juridik shqiptar, eshte e nevojshme qe te njohesh:

Antropologjine si shkence dhe vendin qe ze ajo mes shkencave natyrore e shoqerore,

Historine, Historine e se Drejtes, Filozofine, Filozofine e se Drejtes, Psikologjine, Psikologjine e se Drejtes, Sociologjine, Sociologjine e Se drejtes, Historine e Mendimit Politik, Globalizimi etj. Pra eshte nje game e madhe ku sejcila disipline te çon tek burimi, pra tek fillesat e saj e deri me sot tek integrimi ne Globalizimin e se Drejtes ne te Drejten Europiane.

Pra te ndermarresh kete ndermarrje eshte e nevojshme qe nese per shembull me jepen tete ore kohe, do te me duhen qe gjashte ore te ngas majen e lapsit dhe dy ore te

shkruaj. Pra ky shembull eshte kaq sinjifikativ i cili perben dhe qellimin kryesor qe do te pershkruaj te gjithë temen ne vijim, pra do te jete pika e prerjes ne kohe dhe ne hapesine ne lidhje me pyetesori tim i cili do te leviz si nje lavjeres nga lirite dhe te drejtat e njeriut tek siguria dhe garancia Kushtetuese qe jep shteti i se drejtes ne Shqiperi. Ky pyetesori perbehet nga keto pyetje:-Kush ? Cfare ? Kur ? Ku ? Pse ? Si ? te cilat ne dinamikën e zhvillimit te temes do te perbejne Harten antropologjike te krijimit dhe te zhvillimit te mendimit juridik shqiptar.

Sa mesiper, theksoj se ky punim ka lidhje me punimet e tjera te fushave te lartpermendura pasi mendimi juridik shqiptar kalon qe nga kohet e antikiteti nepermjet shtetit Ilir,atij te Arbrit,te Skenderbeut,atij para viteve 1912,atij te viteve 1912, e ne vijim te kohes se Monarkise, te kohes se Luftes se Dyte Boterore, te Shtetit Monist, si dhe atij aktual te viteve 1990 e ne vazhdim, pra te Shtetit te se Drejtes ku ne qender jane Mbrojtja e Lirive e te Drejtave te Njeriut.

Gjithçka ka lidhje analitike dhe integrale mes njera tjetres sepse ne gjendemi sot ne nje kohe ku ka shume ekspansion te ligjeve dhe ne duhet qe te krijojme filozofine tone se si ndertohen keto ligje,pasi çdo kohe, ka shoqerine e saj qe nga ajo primitivja tek skllavopronarja e deri me sot ne kohet moderne dhe pos modernizmit te cilat shoqerohen me sjellje te ndryshme, socilae, kulturore, fetare, zakonore, ekonomike, politike, juridike etj.

Ne sot kerkojme te krijojme ligje nga me te mirat ku ne thonjeza pretendojme te bejme pershembull kafshen me te bukur dhe per te realizuar kete kerkojme qe te marrim nga kafshet e tjera ate pjese te trupit qe ajo kafshe ka me te bukuren, keshtu pershembull nga xhirafa marrim qafen e saj, nga zebra lekuren e saj, nga luani koken e tij, nga leopardi kembet e tij etj, dhe keshtu do te na dali kafsha me e shemtuar pasi asnje nga

keto elemente nuk eshte ne vendin e saj dhe kjo kafshe e shemtuar nuk mund te jetoje pasi duhet te kete dhe kushtet e saj, vendin e saj. Pra e njejta gje ndodh edhe me ligjet, kur ne kerkojme qe te bejme nje ligj nuk duhet te ndjekim kete shembull, por mes menimit juridik shqiptar, filozofise sone te bejme ligje te cilat na perkasin ne, na pershtaten ne, duke pasur keshtu te drejten shqiptare.

Eshte e vertete qe mendimi juridik shqiptrar ka kaluar qe nga ai empirik, po ashtu tek ai ka ndikuar sipas pushtimeve romake e drejta romake dhe me pas nga ndarja e Romes, nga Pushtimi i bizantit, e drejta bizantine deri tek kodi i Justinianit te pare. Po ashtu ka ndikuar pushtimi Turk me te drejten e tyre fetare marre nga Kurani, pra e drejta e Sherihatit dhe me pas nga pushtimi i Italise gjate luftes se dyte boterore. Tek ai ka ndikuar dhe deformimi i se drejtes nga shteti monist e deri me sot nga ky ekspansion i ligjeve qe vjen nga jashte.

Pra ajo qe ka shpetuar pa ndikim ne thonjeza pasi nuk kemi akte te shkruajtura eshte veteme drejta zakonore e cila perfshin zakonet e mira dhe te drejten kanunore ku nje vend te rendesishem zene Kanuni i Lek Dukagjinit, i Skenderbehut, i Laberise etj.

Ne kete konteks dua te theksoj se nuk na mungone filozofia jone kombetare sepse e kemi te perqar nga Rilindasit tane, po ashtu nuk na mungon as kthjelltesia dhe inteligjenca pasi kemi mjaft jurist shume te mire si dhe iluminist me mendje te ndritur te cilet mund te arijne te veprojne duke e pare ligjin jo vetem si nje grumbull regullash, por ta shikojne dhe nga aspektet e kendveshtrimit te anes sociale, kulturore, ekonomike, politike e juridike, ne kete kontekst te bejne te mundur te studjojne dhe te pecaktojne tek ai se si kane ndikuar dhe ndikojne ne perpilimin e ligjit ana sociale, kulturore, ekonomike, politike dhe juridike e tij ne shoqeri dhe kohe te caktuar.

Nga globalizimi i kohes se Romes, Bizantit, Perandorise Turke, mendimi juridik shqiptar ka shpetuar nga asimilimi i tij nga fqinjët, pra nga Serbet dhe Greket, por gjithsesi edhe Globalizimi European nuk duhet te na asimiloje ne kete kontekst, por ne duhet qe ne kete Integrim te shkojme me mendimin tone juridik ku te spikasin vlerat tona me te mira te mendimit Juridik shqiptar, duke konservuar ate qe eshte e nevojshme, e domosdoshme per te ruajtur vlerat me te mira dhe duke i dhene ketij globalizimi European ate qe eshte sa me shqiptare.

E permenda me larte shrehjen time se nese me jepet nje kohe prej tete orersh, ato do ti perdorja ne kete menyre, per gjashte ore do te mprihja majen e lapsit dhe per dy ore do te shkruaja, kjo ka nje kuptim te tille, per gjashte ore do te mprehja mendimin tim dhe per dy ore do ta hidhja ne leter kete mendim. Pra del qarte dhe lind pyetja se sa kohe duhet te mpresh mendimin juridik, cilat jane mjetet objektive dhe subjektive te mprehjes se ketij mendimi Juridik, sa kane ndikuar dhe ndikojne tek ai sjelljet e tjera njerezore, kushtet e ndryshme, qellimi dhe shkaqet e krijimit te nje shprehje idiomatike pra te nje ligji ku ne radhe te pare duhet te bejme marreveshjen e fjales, ku duhet te analizojme strukturen formale dhe mteriale te tij dhene ne forme dhe ne permbajtje nga ndikimet e sjelljeve sociale, kulturore, ekonomike, politike e juridike te cilat perfundimisht pershkruhen nga ajo filozofi e mendimit Juridk shqiptar. Pra ne themel te ndertimit te ligjit dhe te se drejtes shqiptare te jete pra kjo Filozofi, ku per realizimin e saj eshte i dobishem studimi i antropologjise se mendimit juridik Shqiptar.

Eshte e vertete se antropologjia si shkence meret me te tjeret, pra me popuj dhe vende te tjera, por ajo meret edhe me veten, pra me popullin dhe vendin tend. Ne kete kontekst eshte i nevojshem ky studim edhe per faktin se ne rafshin krahasues hulumtimi do te kaloje ne stacione te ndryshme ku treni modern european do te marre edhe vagonin

tone per ne Europen e Bashkuar. Per kete si fakt spikat dhe shprehja monumentale e Papa Vojtiles i cili mes te tjerash ne mesazhin qe i jepte botes i thote:-“Ne do te shkojme ne Europen e Bashkuar, por jo pa Bosnjen dhe Shqiperine, por drejt katolicizmit !”

Po ashtu kaq e madhe dhe sinjifikative eshte dhe shprehja e presidentit te Amerikes Bill Klinton ne kuadrin e çlirimit te Kosoves,ku veç te tjerash ai u shpreh se:-

“Ne fituam luften kurse juve ju del per detyre te fitoni paqen.Kosova eshte e ardhmja e niperve dhe e sterniperve tane !”

Keto dy shprehje tregojne qarte vullnetin qe ka bota perendimore per mbrojtjen e lirive dhe te Drejtave themelore te njeriut, permes ndertimit te shtetit te se drejtes dhe te nje doktrine te se drejtes globale ne funksion te ketyre shoqerive demokratike pasi jane vetem keto shoqeri qe garantojne, sigurojne njerezimin ne udhetimin drejt lirise dhe demokracise.

Nga pikpamja sasiore dhe cilesore teoria e perdorur eshte ne menyre deduktive dhe e vendosur ne nje menyre te tille qe studimi i pergjigjet lidhjes shkakesore, pra shkak pasojë, ku investigimi qendron tek faktet kuçe, te drejtperdrejta dhe te terthorta.

## **2.2. B. SHTRIMI I PROBLEMIT**

Te llogjikosh duhet te dish dhe te vendosesh duhet te njohesh !

Pra jane keto dy alternativa ne kohe dhe ne hapesire nepermjet te cilave ne njohim veten tone dhe kohen ne te cilen jetojme.

Per te ardhur ketu duhet qe te evokojme te kaluaren nepermjet nje retrospektive ndoshta ne reticencen historike, sociale, kulturore, ekonomike, politike e juridike sepse siç thote dhe

Shen Agostini” Historia e njerezimit eshte mes te mires dhe te keqes”

Ne kete kuader dhe ne kete kontekst gjendet ne te drejten romake se drejtesia ka tri urdhera:-

- Te jetosh me nder;
- Te mos i besh dem tjetrit;
- Sejcili te marre ate qe i takon.

Kurse ne zakonet tona te mira gjendet edhe sot keto urdheresa:

- Mos i bej tjetrit ate qe nuk do te te bejne ty;
- Buke e kriper e zemer te bardhe;
- Fshat e zanat, dere e tabjat;
- Jepi Cesarit ate qe i takon Cesarit, etj.

Keto tregojne qarte per lidhjen shpirtore qe ka polulli me te drejten zakonore, pra me te Drejten e pashkruar e cila mbetet ne themel te zakoneve te mira, ku ne e kemi te percaktuar edhe ne te drejten civile ku theksojme se aty ku nuk ka ligj perdoren zakonet e mira.

Pra edhe pse jemi perpara nje jurisprudence te kodifikuar, perseri kane vend zakonet e mira te popullit i cili i ka ruajtur ato si gure te çmuar ne shekuj e ne vite.

Tri jane shpikjet me te medha te njerezimit: - Zjarri; -Rrota; -Paraja;

Por nje nga aritjet me te medha dhe nje nga fitoret me te medha te njerezimit eshte vendosia e drejtesise!

Per te krijuar kete te drejte shqiptare dhe per te dhene drejtesi duhet te theksojme se:

“Drejtesia eshte e verteta ne dinamike”, pra e verteta ne levizje, sepse siç thote dhe latini“Me jete kuptojme levizje” dhe kjo levizje duhet te jete ne te gjitha kohrat dhe ne te gjitha aspektet, veç te tjerash edhe ne fushen e se drejtes.

Per te ilustruar sa mesiper do te marr nje shembull nepermjete kesaj fabule pra:

Ishin dy myshkonja te cilat po diskutonin dhe po debatonin ne lidhje me mendimin e tyre.

Njera thoshte per qiriun se eshte flake, kurse tjetra po thoshte se eshte drite. Pra te dyja i kishin mbushur mendjen vetes se kishin te drejte dhe e mbronin te drejten e tyre deri ne fund. Nderkohe vjen nje myshkonje tjetere e trete dhe nderhyn duke ju thene se çfare kishin mes njera tjetres qe po debatonin dhe po diskutonin duke e mbrojtyur te drejten e tyre veç e veç ato i shpjeguan versionin e se drejtes se tyre dhe myshkonja e trete ju pergjigje; “Po mire po shkoj une dhe po e provoj se çfare eshte flake apo drite”.Si perefundim myshkonja e trete shkoi per ta perovuar por nuk u kthye me.

Po keshtu eshte dhe e drejta, pasi nga dy pale sejcili pretendon se ka te drejte dhe ne kete menyre kemi dy te drejta dhe te drejten e vertete, ku per ta gjetur kete te drejte te vertete, ia delegojme kete vetegjyqesi, trupit gjykues i cili vendos mbi te drejten !

Pra sa mesiper del qarte se eshte i nevojshem te behet ky stydim dhe ky kerkim shkencor ne

Fushen e Antropologjise ligjore pasi kemi te bejme ne kete rast edhe me psikologjine gjyqesore me psikologjine e paleve, me psikologjine e te pandehurit dhe me psikologjine e gjyqtarit, si dhe me sociologjine e se drejtes.

Po ashtu vlen per te percaktuar te drejten e cila eshte objekt i shkences juridike, por kur behet fjale per prejardhjen, permbajtja dhe natyra e se drejtes vleresohen jo vetem nga shkolla e se Drejtes natyrore e cila buron prej arsyes se vullnetit dhe natyres se puneve, pra eshte e perhershme dhe ka fuqi ne çdo vend dhe ne çdo kohe, por edhe nga shkolla e te drejtes historike e cila rrjedh nga vullneti kolektiv i njerezve qe jetojne se bashku ne nje vend, duke ndryshuar sipas vendit, kohes dhe kontraditave historike te çdo



populli, duke formuar kështu një komb, një shtet, një gjuhë, të cilës i përgjigjet në këtë formim të këtij trekëndeshi barabrinjës studimi i antropologjisë së mendimit juridik shqiptar.

### **2.3. C. QELLIMI I STUDIMIT**

Antropologjia e mendimit juridik shqiptar ka si qëllim në studimin e saj, që nga koha antike e deri më sot, të hedhë dritë mbi formimin e së drejtës shqiptare dhe të formimit të juristëve sot në kohët moderne, që në shkrimin ligjor të korpusit të ligjeve të kënaqësive reale që mos të perseritet legjenda e gurit të sizifit. Po ashtu të kënaqësive që të fshijnë njëherë e përgjithmone nga mentaliteti i gabuar dhe shovinist i fqinjëve se gjoja në shqiptarët nuk mund të ndërtojme një shtet. Gjithashtu duhet që nëpërmjet këtyre studimeve të vendoset në qendër të mendimit juridik shqiptar, se në shqiptarët si nga mendimi juridik dhe shtetit të së drejtës i perkasim Europës perëndimore dhe jo asaj lindore, një shprehje kjo që na mundon në shekuj se ku gjendemi, mos vëlle më lindjes dhe perëndimit si urë kalimi? Apo në lindje? Apo në perëndim?

Këtyre pyetjeve i ka dhënë mesemiri përgjigje populli edhe në kanonet dhe të drejtën zakonore, por e gjen të skalitur edhe në mozaikun e “Fare Hedhesit” ku nga studimi i këtij Mozaiku Kishtar del dhe fryma përkrahëse perëndimore, pasi njeriu i pikturuar është një burrë i cili po mbjell tokë, pra në rastin konkret jetën e tij dhe nga fara që merr në torben e tij, pra merr farën e jetës për ta mbjellë në tokë, qëndrimi dhe vështrimi i tij është nga perëndimi.

Kjo është kaq e vërtetë dhe tregon se në shqiptarët i perkasim si në mendim dhe në veprim, në mentalitet, histori, kulturë e zhvillim perëndimit dhe jo lindjes, paçka se në

veshtiresite e luftrave qe jane bere nga barbaret ata kane shkruar historine e tyre ne dem te historise sone.

Por sot qe ne i jemi kthyer ne sistemin e se drejtes dhe te drejtes romake e cila ka influencia edhe ne evolimin e mendimit juridik modern te vendeve te ndryshme, ka influencuar edhe ne formimin e mendimit juridisk shqiptar qe ne pushtimin e Ilirise.

Pra duke qene se polullsia Ilire, paraardhesit tane te Shqiptareve qe nga koha e Mbretit te pare Bardhyl e ne vijim ka qene nje popullsi autoktone e cila asnjehere ne historine e saj nuk ka sulmuar asnje polull tjetër, por ka qene i ngulur ne tokat e tij dhe si rrjedhoje eshte ushtruar e drejta zakonore, pra e drejta empirike, pasi ne kete kohe nuk kemi shkrime.

Me pushtimin Romak u vendos dhe e drejta romake e cila ka funksionuar perkrah te drejtes zakonore.

E njejta gje ndodhi edhe me pushtimin e Bizantit ku ka ekzistuar vec te drejtes zakonore shqiptare edhe ajo Bizantine. Po ashtu ndodhi edhe me te drejten e sherihatit nga pushtimi Turk, ku veç kesaj te fundit nje vend te rendesishem gjente edhe e drejta zakonore.

Por ajo qe i rezistoi me shume kohes ishte e drejta zakonore e zakoneve te mira shqiptare dhe e drejta romake e cila sot pershkruan dhe mendimin juridik modern te kohes persa i perket Europes perendimore.

Per te pasur nje koherence ne qellimin e mendimit juridik shqiptar eshte e nevojshme te unifikojme qendrimet tona ne sjelljet juridike, sociale, ekonomike, politike, qe perfundimisht ne formimin e se drejtes dhe shtetit te se drejtes te shkojme si sovran ne miratimin e ligjeve, jo disa me mendimin anglo sakson, disa me mendimin gjermano romak disa me mendimin francez e disa me mendime socialiste apo

komuniste dhe ne fund te mos dime se çfare te drejte prodhojme, kur duhet qe te prodhome nje te drejte shqiptare ku te jete skalitur mendimi juridik shqiptar dhe ky i fundit te gjeje vend ne integrimin e funksionit ne te drejten europiane te globalizimit juridik te se drejtes.

Perqasia me kete legjislacion ben te mundur qellimin e studimit te antropologjise juridike te mendimit juridik shqiptar mes korpusit te lirive dhe te drejtave te njeriut dhe te garantimit dhe sigurimit te ketyre te drejtave dhe lirive nga shteti i se drejtes shqiptare.

## **KAPITULLI III: KONTEKSTI HISTORIK**

### **3.1. NJE VESHTRIM HISTORIK**

*“... Njeriu eshte me origjine andej nga ka me shume te vdekur se sa te gjalle.”<sup>1</sup>*

Nisur nga kjo ide me lind per detyre qe te hulumtoj ne te kaluaren permes fakteve dhe provave, pasi e shkuara qofte edhe e panjohur ose e harruar fare nder ne, ne brendesine tone vepron parreshtur. Ne gjakun tone permblidhen mijera breza dhe vetite e te pareve shfaqen here pas here edhe pa dijenine tone. Pra eshte fjale e pakundershtueshme, se tek i biri fshihet i ati, tek i ati fshihet gjyshi, se tek gjyshi fshihet stergjyshi e mandej katragjyshi e keshtu me radhe mijera breza kane depozituar vetite e trasheguara nderi sot dhe ne do t'ua leme te tjere, pasardhesve tane, por me nje ndryshim sepse ata, te paret tane admirues te palles e perbuznin penen e vogel, te padukur, si veglen e te dobteve, nuk shkruanin dhe humben me kete menyre dhe veprat e shkelqyera te palles se tyre dhe ne sot dime shume pak mbi te kaluaren e tyre madheshtore. Ne, perkundrazi duhet te perfitojme nga ky mesim dhe pesim i hidhur dhe duhet te mos leme gje pa mbledhur, pa shenuar, qe te mos i leme pasardhesit tane ne erresire si na lane ne te paret, pothuaj ne mosdije te plote te ngjarjeve dhe te vetive te kohes se tyre.

Por ne keto shkrimet tona duhet te jemi te paanshem me sa te jete e mundur, te ndershem gjer ne palce, te mos krijojme, te mos shtremberojme, me nje fjale, e verteta duhet te jete parimi yne i patundur, perndryshe shkojme te veme vetullat dhe nxjerrim

---

<sup>1</sup> Lufta e Vlores (Ago Agaj)

syte, se nuk mbetet gje e fshehur, e pazbuluar me kohe prej kritikeve e historianeve te mevonshem dhe atehere humbet vleren, jo vetem shkrimi yne, por behen te dyshimta dhe veprat e verteta te te pareve tane dhe keshtu behemi shkak ne t'i zvogelojme ose te humbasim fline dhe gjakun e tyre te derdhur me qellim te shenjte per te mirene tone. Dhe kete gje nuk besoj ta doje njeri me mend e me ndergjegje<sup>2</sup>.

Pervec kesaj, e shkuara, historia, eshte nje mesonjese e pashoqe sikurse e kane treguar provat, faktet dhe e ka pranuar bota mbare.

Ne kete kontekst mendoj se eshte pune e mencur dhe e domosdoshme qe te mbeshtetemi ne te shkuaren per te pergatitur te ardhmen, se pa kete do te mbetet nje zbrazetire, qe permban ne vetvete shume rreziqe. Dëshira per te kaluaren nuk ka te beje aspak me percipitimin e saj, sepse “shkaterimi i se shkuares eshte ndoshta krimi me i madh nder te gjithë krimet”.

Nje vend te vacante ne historine tone ze dhe mozaiku i zakoneve, dokeve dhe te drejtes zakonore si dhe asaj kanunore. Ne kete aspekt e drejta zakonore e laberise dhe kanuni i laberise zene nje vend te rendesishem ne jeten e kesaj krahine te quajtur Laberi si dhe ne te gjithë histroine e zhvillimit te se drejtes zakonore dhe asaj kanunore ne Shqiperi.

Perpos kesaj ne te gjithë shtrirjen e zhvillimit te saj e drejta zakonore dhe kanunore labe eshte percuar nga nje fryme. Etika si nje sistem vlerash te larta morale si dhe parimet themelore juridike te mbrojtjes se nderit, burrerise, fisnikerise, beses, mikpritjes ,bujarise, parimet e barazise, se gjakut, te lirise, ashtu sic pasyqrohet ne te drejten

---

<sup>2</sup> Lufta e Vlores (Ago Agaj)

zakonore mbare shqiptare dhe ne te gjithë spektrin kanunor shqiptar nga veriu ne jug dhe nga lindja ne perendim.

Perpara se te trajtojme zhvillimin historik te se drejtes zakonore labe dhe te kanunit te laberise mendoj se eshte me inters te madh te percaktohet fillimisht harta gjeografike e kesaj krahine pra te Laberise si dhe kush jane fshatrat dhe vendet si dhe njerzit qe kane zatur te drejten zakonore labe dhe kanunin e laberise.

Vlore dhe vlonjate, Gjirokaster e gjirokastrite, Libohove dhe libohovite, Tepelene dhe tepelenas, Himare dhe himarjote, (Bregas), jane emra dhe ndasira administrative, por populli qe banon ne keto vende quhet lab dhe vendi i tyre quhet Laberi<sup>3</sup>. Pra Laberia eshte bashkesi etnografike e formuar ne nje territor autokton, pra eshte nje zone nder me te medhate etnografike, me shtrirje gjeografike mjaft te gjere e cila ndodhet ne jugperendim te Shqiperise ne te cilen gjendet per kete shkak gjuhe, zakone, tradita kulturore te perbashketa.

Nder te dy qytetet, si ne Vlore dhe ne Gjirokaster, sic eshte e natyrshme, ka banore qe nuk jane leber, por te ardhur nga te gjithë vendet e Shqiperise dhe per kete shkak si edhe per arsye subjektive nuk e quanin veten leber.

Dua te citoj si me pare edhe ne vijim se cfare ka thene Ago Agaj ne librin e tij "Lufta e Vlores"<sup>4</sup> se:- Nga rrjedh emri Lab ? Njeri nuk e di, vendi i`a dha emrin banoreve, apo keta i dhane emrin vendit te tyre? Nuk dihet.Nisur nga nje pikepyetje e madhe se vendi e merr emrin nga njerezit qe jetojne ne kete vend, apo njerezit qe jetojne ne kete vend e marrin emrin nga vendi qe jetojne. Me te kuptueshem e ben kete krahasim edhe permes hulumtimit qe vjen si rrjedhoje e emigrimeve dhe imigrimeve qe

---

<sup>3</sup> Lufta e vlores (Ago Agaj)

<sup>4</sup> Luta e Vlores (Ago Agaj)

kane bere njerezit ne kohera dhe vende te ndryshme ne zhvillimin e tyre per te kerkuar nje jete me te mire.

Laberia ka qene treva e Kaoneve ne kohen e Ilireve qe permend Tukidi (629 p.e.r).Laberia sic eshte shprehur Sami Frasheri eshte Arberia qe perfshin nga lumi Vjose e deri ne detin Jon.

Gjejme ne kohet e vjetra, perpara Krishtit,<sup>5</sup> nje popull te quajtur Labeate, ne rrethin e Shkodres se sotme dhe Liqeni i Shkodres quhej Liqeni i Labehatve. Me tej e me perpara gjejme afer Zamtes ne Dalmaci nje Liqen te Labeateve, me ne veri, ne Gjermanine Jugore, shohim kater lumenj me emrin”Laber” dhe se fundi ne Gjermanine Lindore ndodhet nje qytet me emrin”Labbes”. Te gjitha keto emra qytetesh, lumenjsh e liqenesh, ndodhen pikerisht ne rrugen qe kane marre Iliret duke ardhur prej Lindjes, (vendeve baltike te cileve u dhane emrin Balte); dhe me vone u kthyhen me ne Jug si kunder na thote profesori i famshem H.Krahe ne vepren e tij.

Ky dijetar permend nje sasi te madhe emrash, vendesh e lumenjsh te Gjermanise se Jugut,te cilet rrjedhin prej Ilirishtes qe nga koha kur Iliret banonin atje,dhe profesori Wirth ne librin e tij”Der Balkan” thote se tiparet dhe veti te njejta shihen nder Bavjeras dhe Shqiptare rrjedhin nga kjo kohe.

Apo jane Lebrit pasardhesit e Lapitheve, qe guxuan te luftonin kunder Kentaurve sipas nje legjende te grekerve te vjeter? Ka me shume te ngjare qe ky fis Ilirjan te kete ardhur po asaj rruge qe erdhen edhe Iliret e tjere, domethene prej Lindjes ne vendet Baltike, ne Gjermanine Perendimore, ne ate te Jugut, ku me vone u ndane dhe njera dege kaloi ne Itali dhe tjetra mori Dalmacine e Poshtme deri ne Epir.

---

<sup>5</sup> Lufta e Vlores (Ago Agaj)

Duke lene si kujtim te banimit te tyre emra vendesh dhe lumenjsh sic pame me siper e pasi lane edhe rrethet e Shkodres, erdhen e u vendosen aty ku i gjejme dhe sot dhe ketu pesuan ndikimin e fqinjeve kushurinjeve te tyre sic ishin epirotet, maqedonasit dhe thraket.

Lebrit kane dhe nje emer tjeter arber dhe arberesh .Qytetaret e Vlores me pare ketu e rreth 100 vjete nuk thoshin se erdhi nje lab, por erdhi nje arber ose arberesh dhe kur arratisej ndonje fajtor per ne Laberi, thoshin”Mori Arberine perpjete”. Ali Asllani, qe eshte prototipi i vjershetoreve te Laberise, ne vjershat e tij flet gjithmone per Arber e Arberi. Ai nuk ben ndonje ndryshim midis ketyre fisefeve, por ne te vertete nje ndryshim ekziston. Leber jane banoret me te vjeter, shume me te vjeter dhe arberit jane ata qe kane ardhur me vone duke u shkeputur prej vendit e fisit te origjines ne Shqiperine e Mesme.

Kufite e Laberise jane natyrale ku ne perendim eshte deti Adriatik, ne veri e ne lindje lumi i Vjoses gjer ne gryken e Zagorise, ne jug gryka e Selckes, pjese perendimore e maleve te Libohoves gjer ne Nepravishte, prej ketu hidhet ne Qafe te Muzines, rrezen jugore te maleve veriore te Delvines dhe duke formuar nje gjysme harku, arrin ne Nivice Bubar e mbaron prape ne det.

Pra kryesisht Laberia eshte nje bashkesi etnokulturore e formuar ne nje territor autokton, zone nder me te medhate etnografike, me shtrirje gjeografike mjaft te gjere ne jugperendim te Shqiperise me shume se rreth 500 fshatra me gjuhe, zakone e tradita kulturore te perbashketa.



Eqerem Vlora shkruan se: Ne Shqipëri dhe Jugut ka qene ne veprim nje “ligj i zakonit” ndërmjet popullatave malore te Labërisë, te Toskerisë dhe te Camërisë<sup>6</sup>. Kishte emra te ndryshem dhe konkretisht ne Toskeri (nga Korca e deri ne Permet) e quanin “Kanuni I Adetit”, ne Camëri e quanin shkurt “Adeti”, vetem ne Labëri (Lumi I Vlores, Himare, Kurvelesh) e quanin “Kanuni Papa Zhulit” dhe me shpesh “Kanuni i Idriz Sulit”.

Fakti eshte kokeforte se e drejta zakonore shqiptare e cila u ruajt edhe gjate pushtimit Osman te cilet kerkuan te vendosnin dhe te zbatonin te drejten e tyre te sherihatit, pikerisht kjo ndodhi pervete ruajtjen qe populli i beri zakoneve, adeteve, Kanuneve ne unitet me gjuhen, origjinen, kulturen, historine dhe vlerat morale te perbashketa si kurore dhe temel te identitetit shqiptar per vetqeverisjen e tyre.

Ne Kanunin e Labërisë jane sanksionuar parimet themelore juridike ne te cilat shprehet filozofia popullore per t’u vetqeverisur me drejtesi, sipase rregullave, normave te se drejtes zakonore, te rrenjosura ne mendje te cilat i tregojne se cfare eshte e drejte dhe cfare jo, se c’ duhet bere e cfare jo, se si te sillen njerezit.

Kuptimi dhe rendesia qe ka pasur nderi per popullin e kesaj krahine dhe kesaj bashkesie kane luajtur rol te madh ne zbatimin e Kanunit.

Keto rrethana kane percaktuar qe bashkesite dhe organizmat e veteqeverisjes vendore te reagojne ashper ndaj te gjitha shprehjeve dhe sjelljeve me rrezikshmeri shoqerore me qellim ruajtjen e unitetit te bashkesise dhe mbrojtjen e individit. Edit Durhan thote mes te tjerash se ketu qendron kjo filozofi e ligjit, tek e drejta e pashkruar

---

<sup>6</sup> Kujtime (Eqerem Vlora)

e trashëguar brez pas brezi në vetmbrojtje të bashkësisë dhe të vetëqeverisjes, e cila qëndron edhe mbi “dhjetë urdherat e Zotit”.

Kanuni i Labërisë është dëshmi e gjallë e bashkësisë labë, që kur nuk ekzistonte autoriteti shtetëror e në vazhdimësi, nuk ka jetuar në anarki e në arbitraritet, por ka ruajtur e ka zbatuar normat e së drejtës zakonore për rregullimin e marrëdhënieve shoqërore në mes njëzëve në fusha të ndryshme të jetës.

Keto norma janë krijuar si rezultat i zhvillimit të marrëdhënieve shoqërore ekonomike të këtij grupi etnik dhe kanë vepruar brenda tij në truallin e Labërisë. Si formë e vetëdijës shoqërore ato kanë hyrë thellë në shpirtin e këtij etnosi dhe janë respektuar dhe zbatuar me fanatizëm konsekuent nga bashkësia dhe çdo pjesëtar i saj krejt natyrisht, sipas traditës së përditëshme, të pranuar nga të gjithë, pa forcën e shtetit, aq sa do ta kishte zili çdo formë shtetërore për zbatimin e ligjit.

Respektimi i këtyre normave lidhet ngushtësisht me vetëqenien e vetëqeverisjes së këtyre bashkësive dhe të pjesëtarëve të tyre, kurse mosrespektimi i tyre vinte në rrezik jetën kolektive të bashkësive dhe të individëve.

Keto rrethana kanë përcaktuar që bashkësitë dhe organizmat e vetëqeverisjes vendore të reagojnë nëpërmjet vendimeve të tyre ndaj të gjitha sjelljeve me rrezikshmëri shoqërore, me qëllim ruajtjen e vlerave të bashkësive dhe mbrojtjen e interesave të individit. Edhe në këto kontekste historike metodat dhe format si dhe menyrat e reagimit kanë ndryshuar në dinamike duke sjellë në vëmendje që nga debimi i personit të denuar, bojkotimit të një kuvendimi, si dhe vrasjes së fajtorit etj.

Ne kushtet kur nuk kishte shtet shqiptar te pavarur, nuk kishte Kushtetute dhe ligje. Kanuni luante rolin e Kushtetutes per rregullimin e marredhenieve juridike te popullise se njesive te vetqeverisjes vendore, perfshire ne kete pikpamje edhe Laberine.

Kjo vjen ne korelacion dhe provohet me faktin se ne vitin 1492, Porta e Larte, i njohu zyrtarisht Himares, si kryeqender e kryengritjeve te laberise kunder pushtuesve osman, venomet e saj, te drejten per t'u vetqeverisur me normat juridike te saj. Himara, ne shekujt XV\_XVI perfshin bregun e detit e deri ne Butrint dhe pothuajse gjithe laberine e sotme. Ne kete krahine benin pjese rreth 53 fshatra.

Anglezet qe kane vizituar krahinen e Himares ne shek.XVII, K.Liku, E.Liri, J.Hobhaus etj, shkruajne per nje kod zakonor te forte qe vepronte ne Himare<sup>7</sup> (cituar nga Gjecov). Njohja e venomeve vazhdoi edhe kur filluan te zbatoheshin reformat e Tanzimatit (1839).

Me vone sipase gojedhenave popullore njihet si ligjvenes i kesaje krahine Gjokuta i Kucit icili mendohet se ka jetuar ne mesjete (1615), por edhe per kete si fakt nuk ka dokumenta si per shume fakte te tjera. Por edhe ne mungese te dokumentacionit arkivor ne shek.XVII-XX jane zhvilluar kuvendi i burave i mbledhur ne Senice te Delvines ne shek.XVII ku si perfaqesues ka pasur nga Delvina ,Zhulali ,Filati, Smokthina, Himara, Vunoi, Qeparoi, Borshi, Piqerasi, Shevasia, Nivica, Tatzati, Palasa, Kardhiqi, Lukova, Lunxheria etj.

Kete kuvend burrat e mbledhur e quajten apo e pagezuan me emrin”Ne Senice u be palcimi”domethene pajtimi, bashkimi, kjo per faktin se Kuvendi u mblodh ne nje fshat

---

<sup>7</sup> Kanuni I Laberise (Gjecov)

qe i perkiste besimit kristjan dhe me pjesmarrjen edhe te shume fshatrave ku popullsia e tyre ishte kthyer ne myslymane.

Kjo ishte me rendesi te madhe pasi tregonte nje vlere te bashkejeteses paqesore mes tyre. Mbeshtetur ne kete realitet shqiptar Faik Konica shprehet se ne “Shqiperi ka tolerance fetare dhe eshte i vetmi vend ne Europe, ku nuk ka pasur luftera fetare”<sup>8</sup>. (Konica, vepra 1993).

Perseri sipas gojdheneve popullore Kuvendi i dyte i madh me rendesi te vecante historike per te drejten zakonore te Laberise u mbajt ne shekullin XVIII ne Zhulat, nen drejtimin e burit te zakonit, agait Idriz Sulit. Edhe ne kete kuvend moren pjese burra nga keto fshatra te lartpermendura, pra nga e gjithe laberia te cilet i perkisnin besimeve te ndryshme. Ata moren ne mbrojtje ndryshimet dhe reformimin e se drejtes zakonore ne Laberi. Ndryshimet e rendesishme ne Kanun si dhe normat e reja te vendosura, u njohen me emrin “Shartet e Idriz Sulit” te cilat jane pasurimi i se drejtes zakonore te Laberise te cilat i kundervihen ndikimeve te Sherihatit dhe ligjeve Osmane.

Nder ndryshimet me te rendesishme mund te permenden, forcimin e mbrojtjes se prones private, prirja per mbrojtjen e te drejtave te njeriut, posacerisht te gruas, duke i njohur te drejten qe te punonte jashte shtepise se bashku me burrat. Deri ne ate kohe nen ndikimin e Sherihatit grate qendronin te mbyllura ne shtepi dhe te mbuluara ne fyture me perce. Norme tjeter e re ishte edhe ndarja e gruas, pa sjelle si pasoje vrasjen e saj. Nje shart tjeter ishte qe hajdutit te mos i pritej dora, sic veprohej me pare nen ndikimin e se drejtes bizantine dhe te kuranit, por te paguante njefishin e sendit te vjedhur kur ishte

---

<sup>8</sup> Konica (vepra 1993)

jashte shtepise, ndersa brenda shtepise dyfishin ose pesefishin dhe peseqind grosh kallauz. Gjithashtu u vendosen denime te renda per krimin e tradhetise.

Ali Pashe Tepelena (1740-1822) ne pashallekun e tij, krahas sherihatit per popullsine myslimane dhe kanuneve kishtare per banoret e krishtere, zbatoj bujurdite, urdheresat e tij. Ne raste te vecanta lejoi te zbatohet edhe e drejta zakonore vendase. Ali Pasha u perpoq te bente organizimin gjyqesor ne cdo qytet e krahine dhe te zbatonte ligjet njelloje si per myslimanet dhe te krishteret, sipase parimit te barazise perpara ligjit. Një veshtrim ky drejt vendeve perendimore.

Gjithashtu ai kufizoi vrasjet per gjakmarrje si dhe e zevendesoj ate me denime te tjera alternative si ate te pagimit te djetes, pra shperblimin e gjakut ose me debimin e deri ne denimin me vdekje, sic veprohej ne shtetet e tjera per vrasjen me dashje.

Per kufizimin e gjakmarrjes e te pasojave te saj, ngujimit ne Laberi kane luajtur rol te madh Kuvendet e burave qe nga shekulli XVIII e ne vazhdim.

Ky fakt eshte nje argument tjetër mjaft i rendesishem ne mbeshtetje te pikepamjes qe At Gjergj Fishta<sup>9</sup> ka shprehur dhe mbajtur, persa i perket zerave kunder Kanunit te Leke Dukagjinit ne lidhje me gjakmarrjen, te cilet shpreheshin per barbarine e egersine e kombit shqiptar. "Mbas Kanunit thote Fishta qe asht te shprehunit e shpirtit te Kombit shqiptar, vrasja eshte e ndeshkueshme me dek."<sup>10</sup>(Parathenia e KLD f.22).

Procesi i kufizimit gradual deri ne zhdukje i gjakmarrjes ne Laberi, eshte deshmi e gjalle edhe kunder pikepamjes se Lombrozos e pasuesve te tij, te cilet shpjegonin gjakmarrjen nga pozita biologjike dhe ia atribuonin ate races shqiptare, ndonese dihet boterisht qe ajo ka qene nje fenomen historik-shoqeror i gjate, mbare nedkombetar, i cili

---

<sup>9</sup> At Gjergj Fishta (Kanuni i Leke Dukagjinit)

<sup>10</sup> Kanuni i Leke Dukagjinit

ka lindur qe ne bashkesine primitive dhe u percoll ne dinamike ne jeten e perbashket, e solidaritetit ndermjet njerezve, qe percaktonte vetembrojtjen ne kushtet e mungeses se shtetit.

E thene ndryshe, si ne zonat e tjera malore edhe ne Laberi, ne nje shoqeri ku nuk kishte autoritet shteteror, hakmarrja ne kuptimin e gjere te fjales, vepronte per rivendosjen e drejtesise, si shpagim per rrahjen, fyerjen, shpifjen ose nga cdo veprim tjetër i padrejte ne dem te pales se demtuar.

Derisa nuk kishte autoritet shteteror per mbrojtjen e jetes, gjakmarrja funksiononte si mjet i vetmbrojtjes. Ndryshe qendron ky fenomen dhe kjo veper penale, pra gjakemarrja ne kushtet e funksionit te shtetit i cili kthehet nga nje mjet vetembrojtje, ne vetegjyqesi dhe eshte e denueshme nga ligjet e shtetit.

Normat e se drejtes zakonore vazhduan te vepronin ne Laberi edhe pas shpalljes se Pavaresise dhe krijimit te shtetit kombetar Shqiptar ne 28 Nentor 1912. Per shkak te gjendjes politike, ekonomike e shoqerore ne te cilen ndodhej Shqiperia e atyre viteve, te izolimit dhe te veprimit te zakoneve e te traditave te vjetra, lejoi perkohesisht normat e sedrejtës zakonore e traditave te vjetra, sidomos ato qe kishin te benin me rregullimin e hakmarrjes e te gjakmarrjes. Ky qendrim gjeti mirkuptim jo vetem ne Laberi por edhe ne popullsine e atyre vendeve e zonave ku ishte problem i gjakmarrjes, e cila mbeshteti qeverine, sic ishte vendimi i kreteve te malesise se veriut te dates 6 shtator 1913 te mbledhur ne Kruje.

Ne Kanunin e Zhulise viti 1913te miratuar nga qeveria e Ismail Qemalit, krahas normave juridike me karakter penal e procedural, ka edhe disa norma te se drejtes zakonore. Edhe pse Laberia u pushtua pas vitit 1913, ne vitin 1916 nga andartet grek

dhe me pas nga Italianet, kjo gjendje vazhdoi edhe gjate luftes se pare boterore 1918 dhe deri ne luften e Vlores 1920 dhe perseri populli i Laberise vazhdoi te veteqeverisej per aq sa mundej, nepermjet se drejtes zakonore.

Ndryshime e permiresime te Kanunit te Laberise <sup>11</sup>nga pleqte e zakonit dhe kuvendet e burrave jane bere edhe ne vitet pasardhese deri ne vitin 1920 te shekullit XX nga perfaqesues te Kurveleshit te mbledhur ne Gusmar ne vitin 1921 i cili vendosi pajtimin e gjaqeve dhe hasmerive.

Me rendesi te madhe historike, politike e juridike eshte Kuvendi i laberise i mbledhur ne Kuc ne 28 Nentor 1924 ne kohen kur Fan Noli kishte programuar reforma te thella ligjore permes qeverise se tij edhe pse normat e se drejtes zakonore vepronin me force ne kete krahine.

Ky kuvend mori karakter kombetar pervet faktin se ne te moren pjese edhe perfaqesues nga Kruja, Lumi i Matit, Mirdita, Shala e Dugagjinit etj. Pervet ndryshimeve te larte permendura nje nga vendimet kryesore te ketij Kuvendi ishte edhe ne aspektin e mbrojtjes se famijes duke ndaluar keshtu fejesat mes femijeve te paralindur dhe te miturve duke vendosur keshtu standarte demokratike per emancipimin e gruas dhe barazise se saj me burrin.

Nje rol te rendesishem ka pasur ne drejtimin e ketij Kuvendi edhe juristi Sali Hallkakondi nga Vranishti i Vlores si njohes i zakoneve te vendit dhe ligjeve perparimtare te kohes ne shtetet perendimore dhe demokratike si aspirate edhe e Rilindasve tane dhe Kongresit te Lushnjes 1920.

---

<sup>11</sup> Kanuni I laberise (Ismet Elezi botimet Toena)

Me pas kete game ndryshimesh dhe parimesh e pasuan gjate viteve 1928-1939<sup>12</sup> nen regjimin e Monarkise, ku dolen Kodet e rinj dhe ligje me orjentim perendimor permes qeverisjes se Mbretit Zog, por megjithate u njohen gjate kesaj perjudhe edhe Kanunet e Laberise, te Lekes, e te Skenderbehut per rregullimin e maredhenieve te ndryshme te vecanta.

Sistemi feudal qe kaloi jo vetem vendi yne por edhe gjithe Europa, ka qene nje vecori tjeter kryesore e se drejtes zakonore. Ky fenomen pershkoi jovetem Shqiperine por p.sh. edhe Francen feudale ne te cilen ne ate kohe kane vepruar mbi 300 sisteme te se drejtes zakonore locale (coutumier) te shkruara e te pashkruara te cilat u mblodhen nga Filip Bomahuer ne shek. XVIII, te cilat me pas u kodifikuan nga Napolon Bonaparti permes qeverisjes se tij<sup>13</sup>.

Pra kjo gjendje zakonore juridike ka pershkruar jo vetem vendin tone pro edhe vendet e tjera te cilat kane kaluar permes sistemeve te ndryshme duke dhene e marre njekohesisht nga seicili sistem dhe kohe e pershtateshme apo e papershtateshme. Kjo per faktin tjeter se nuk kemi burime arkivore te shkruara, nuk mund te perjashtojme dukurite subjektive apo te modernizimit te asaj apo kesaj norme juridike ne kohe dhe ne hapesire, pasi nuk mund te mohohet koha dhe gjurmet e saj ne te cilen jane mblodhur keto norma.

Ne kete aspekt eshte e nevojshme dhe e domosdoshme qe ne mbledhjen, intrpretimin dhe zbatimin e tyre duhet qe te kuptojme fillimisht konotacionin e emertimit kanun si term i cili ka ngjallur diskutim te madh mes autoresh te ndryshem.

---

<sup>12</sup> Kodi civil i vitit 1929

<sup>13</sup> Historia e shtetit dhe e se drejtes .(Botimet Luarasi)



Pavaresisht se nga rrjedh ky term e si u perhap ne Shqiperi eshte fakt i pamohueshem se termi u pranua ne te gjitha variantet e kanuneve shqiptare nga veriu deri ne jug e nga lindja ne veri.

Termi “Kanonizma” eshte perdorur ne aktin e Komitetit te Fshehte te Manastirit”Per Lirine e Shqiperise te themeluar ne vitin 1865.Gjithashtu termi”Kanon”eshte perdorur nga qeveria e Vlores ne aktin e quajtur ”Kanon i Zhurise”<sup>14</sup>ne 10 Maj 1913.Eshte e vertete se ne popull perdoreshin fjaltet”Shart”,”Adet” “Zakon”, te cilat jane me origjine te huaj dhe dallohen parimisht nga normat juridike te se drejtes zakonore.Per kete si shkak edhe persa i perket Kanunit te Laberise eshte trajtuar qe te mos kete kete titullim por te quhet “Zakonet juridike te Laberise”, por ka pasur mendime qe te quhej edhe “e drejta tokesore”, por ky term nuk njihej dhe nuk perdorej ne Laberi.Nen kete drite dua te theksoj se At Gjergj Fishta ka thene se fjala “Kanon” rrjedh nga greqishtja e vjeter “Kanon” qe u perhap me pas edhe ne gjuhe te tjera.

Ndersa Kristo Frasheri<sup>15</sup> mendon se termi “Kanon” eshte me origjine bizantine, rrjedh nga “Kanon”.Ka mendime te tjera se ne vendin tone ky si term hyri nepermjet turqishtes” Kanun” e “Kanunname”.

Perfundimisht jemi perpara nje emeruesi te perbashket duke u nisur nga permbajtja e tij qe do te kemi kete perfundim se:-

Kanuni paraqitet si teresi normash juridike, rregullave te sjelljes, te pashruara, te vendosura ne kohe te ndryshme e te percjella ne traditen gojore nga njeri brez ne tjetrin dhe qe sherbejne per rregullimin e marredhenieve juridike ne mes njerezve, ne fusha te

---

<sup>14</sup> Kanoni I Zhurise( Botim I qendres se publikimeve zyrtare Korrik 2009)

<sup>15</sup> Himara dhe perkatesia etnike e Himarioteve. (Kristo Frasheri botimet toena)

ndryshme te jetes, zbatimi i te cilave sigurohet sipas tradites nga vete bashkesia e njesise se veteqeverisjes vendore, pa forcen e shtetit.

Trajtimi i organizimit tokesor e shoqeror parashtetor ne njesite e veteqeverisjes vendore perben nje drejtim te rendesishem per te kuptuar e shpjeguar se bashkesia labe nuk ishte tribu fisesh nomade apo te mbyllura e te izoluara, por jetonte ne nje njesi tokesore me kufij e ndarje administrative te percaktuara sipas tradites dhe ndikimeve te trasheguara nga perandoria romake, bizantine e osmane, mehalle apo ceta, fshati apo katundi, krahina. Mbi kete baze ndertohej edhe struktura e organizmave te veteqeverisjes vendore, qe nga plaku i barkut e deri tek Kuvendi i burrave, me gjurme te demokracise gjinore dhe elemente te organizimit shtetor nga Iliret e deri tek pashalleku i Janines se Ali Pash Tepelenes.

Rendi shoqeror (vllazeria, farefis, barku, brezat), marredheniet familjare e martesore ne kanun pasqyrojne evoluimin nga bashkesia gjinore tek rendi patriarkal ne familje nga e drejta romake per patrefamiljas dhe me prirje zhvillimi gradual drejt nje fare emancipimi ne marredheniet familjare te cilat ishin edhe nen ndikimin e sherihatit ku spikaste mosbarazia e gruas me burrin si dhe martesa monogame e egzogame.

Kontaktet e laberise me qytetet kryesore te vendit si dhe me kulturen, shkollen dhe emigrimin kane luajtur nje rol te vacante per te percuar kete kulture edhe ne keto vende kontakti si dhe ka qene e vlefshme qe te shihej edhe krahasimi i vlerave kanunore qe ekzistonte ne vendin tone permes kanuneve te ndryshem. Ne kete kontekst vlen te permenden mbi te gjitha ngjashmerite themelore midis te pakten kater kanuneve kryesore si edhe kanuneve te tjera te vendit te cilet deshmojne per lashtesine e popullit

shqiptar, te kultures se tij ne pergjithesi dhe asaj juridike ne vecanti, si dhe unitetin e pandashem te kombit tone ne trojet e paraardhesve te tij Ilir.

Keshtu shpjegohet fakti qe Kanuni paraqitet i kodifikuar me kerkesat e teknikes ligjore ne formen e nje Kodi Zakonor, duke ruajtur me besnikeri permbajtjen e normave te trasheguara, te sistemuara sipas objektit te marredhenieve juridike.

## **KAPITULLI IV: ANALIZA EMPIRIKE 1**

### **4.1. NJE VESHTRIM ANTROPOLOGJIK**

Meqenese deshirat e njerezve jane te pakufizuara, ndersa burimet jane te kufizuara, atehere njerezit hyjne ne konflikt me njeri-tjetrin per te plotesuar te njejten deshire.

Nga ana tjetër, disa njerez kane me shume deshire per pushtet se te tjeret. Kjo fuqi perkthehet ne deshire per te perfutur te mira, te cilat mund te zoterohen nga te tjeret. Per rrjedhim, disa njerez deshirojne nje pjese te pushtetit te te tjereve. Per kete arsye, edhe atyre qe kane me pak etj per pushtet u duhet ta perdorin pushtetin e tyre ne lufte me ata qe duan t'i shtypin e t'i nenshtrojne. Nga ana tjetër, te gjithë njerezit jane” te barabarte “ dhe nuk mund te rrijne me gjate ne gjendjen e natyres, sepse pasioni i tyre per ruajtjen e jetes nuk ia keshillon kete gje. Atehere njeriu perdor si mjet per te dale nga kjo gjendje arsyen, pasi frika e shtrengon ate te dale nga gjendja e natyres, ndersa arsyeja i rrefen rrugen per ta arritur kete gje. Pra mund te themi se njeriu perdor te gjitha mjetet qe ka ne dispozicion per te dale nga ajo qe eshte gjendja e tij me e keqe dhe me e rrezikshme qe eshte “gjendja e natyres”.

Sipas ketij kendveshtrimi nje koncept me rendesi per mendimin juridik eshte ligji natyror i cili eshte ai rregull, te cilit individi i bindet ne menyre instiktive, pasi ky ligj eshte shprehje e pasionit te tij per veteruajtje.

Nisur nga fakti se ligjet e natyres jane rregulla te pergjithshme, te mbeshtetura ne arsye, te cilat e ndalojne njeriun te bej gjera qe do te ishin shkaterimtare per jeten e tij. Atehere lind pyetja se cfare eshte lira natyrore?

Liria natyrore eshte e drejta per te bere gjithcka qe duhet per te ruajtur jeten. Per pasoje, ne gjendjen natyrore, sejcili ka te drejte natyrore per te gjykuar se cilat mjete i duhen per te ruajtur veten. Ne kete menyre, sejcili eshte gjykatesi i vetem i vetes se tij dhe nuk ekziston asnje lloj morali tjetër përveç atij qe njeriu i jep vetes se tij. Per kete arsye, ne gjendjen e natyres nuk mund te flitet per padrejtesi apo per thyerje te moralit.

Ky perfundim eshte i rendesishem se na jep te kuptojme zhveshjen e njeriut nga cdo moral hyjnor pasi njeriu quan te drejte e te moralshme gjithcka qe eshte ne interes te tij .

Pra njeriu permes dy gjendjeve te fuqishme te tij, arsyes dhe pasionit te cilat udheheqin veprimin e tij te motivuar, ne menyren e krijimit te nje morali te perbashket i cili mungon ne gjendjen e natyres. Pra per pasoje njerezit nuk mund te jetojne me ne gjendje natyrore, pasi kjo eshte e rrezikshme per jeten e tyre. Menyra se si njerezit e zgjidhin problemin e mbijeteses eshte heqia dore nga e drejta per te bere gjithcka.

Kjo marreveshje midis njerezve quhet kontrate shoqerore e cila eshte nje premtim i ndersjellte qe mbeshtetet ne besim. Besimi nuk do te ekzistojë për sa kohe palet nuk do te kene frike nga shkelja e premtimit. Per kete arsye duhet te ekzistojë nje Sovran, i cili t'i kercenoje palet me nje ndeshkim me te madh nga cdo lloj perfitimi qe ata mund te nxirnin nga thyerja e kontrates.

“Kontrata pa shpate s`eshte gje tjetër vecse fjale ne ere”.

Sipas ketij korelacioni kohor ne veprim njerezit formuan mitet dhe permes tij mitizuan te drejtat e tyre per ti zhvilluar ato, po ashtu mitizuan sovranin nepermjt mitit te shtetit. Per ti mbrojtur ato.

Por permes mitit te te drejtave te tyre dhe mitit te shtetit gjendet nje mit i trete i cili eshte “miti i Sizifit”.

E pare ne veshtrimin antropologjik nga nje prespektive krahasuese nderkulturore, qellimi i antropologjise se mendimit juridik eshte te identifikojne principet e pergjithshme qe karakterizojne kete pjese te jetes social kulturore, per te kuptuar rregullimin normativ te shoqerise, d.m.th, forcat shoqerore qe synojne te krijojne dhe te institucionalizojne “nyjet” e kohezionit qe e mbeshtetin shoqerine ne perballjen me ndikimin e interesave individuale.

Ne rastin me te mire, keto principe nuk jane gjykime pretenduese per te vertetat e” ligjit” te cilat lidhen kundrejt sistemeve te tjera normative te kontrollit social te cilat identifikojne se si e perdorin ligjin shoqeria dhe perfaqesuesit e saj legjitim per te “sheshuar” ndarjet dhe per te zgjidhur mosmarreveshjet qe ekzistojne brenda nje komuniteti, per te siguruar drejtesine ne cilindo forme qe te kerkohet duke analizuar ne proces vlerat normative qe ndikojne ne marrjen e vendimeve.

Nje nga shtyllat kryesore te antropologjise se mendimit juridik eshte se ligji eshte nje perberes i rendesishem i kultures e cila na ka cuar ne studimin me imtessi te praktikave zakonore dhe ligjore te popullit tone ne prespektive krahasuese deri ne analizen e proceseve politike e juridike te diteve te sotme per ndermarrjen e rregullimeve ligjore bashkekohore si ne rastin e mbrojtjes se prones, famijes, femijes, punes etj.

Nisur nga fakti se cfare perfaqeson antropologjia e mendimit juridik<sup>16</sup> e cila ndricon procesin rregullues te shoqerise njerezore nga forma me primitive e deri ne shoqerite e hapura duke kulmuar sipase nje skeme zhvillimi per te dalluar shoqerite ku te drejtat dhe pergjegjesite ligjore mbeshteten ne statusin social ne ato shoqeri ku keto te drejta

---

<sup>16</sup> Antropologjia Kulturore (Roger Keesing, Andrew Strathern)

dhe detyrime lidhen me marreveshje kontraktuale midis individeve apo paleve. Ky dallim u perditesua ne praktike duke bere kalimin evolutiv nga statuti tek kontrata.

Me nje spekter te gjere ndikimesh dhe perqasjesh me shkencat e tjera per te bere sa me efikas studimin permes antropologjise juridike eshte e nevojshme dhe e domozdoshme per te qendruar rast pas rasti ne ndikimet dhe lidhjet qe kane mes tyre edhe me antropologjine kulturore, sociale ,filozofike,politike etj.

Nese antropologu ligjor ka interes qe ta shtrij kerkimin e tij edhe ne kohe, per te ndjekur rrugen qe ka pershkruar organizimi politik dhe i institucioneve dhe posacerisht atyre ligjore<sup>17</sup>, lidhja me antropologjine social kulturore gjendet pikerisht per faktin se ne kete rrugetim perfshihet dhe studimi i parametrave te mjedisit social te shoqerise, duke perfshire ketu normat, statusin, procedurat e vendimmarrjes, pushtetin dhe ndikimin e tyre ne plotesimin e te drejtave themelore te njeriut.

Pra eshte e nevojshme qe te kordinohen veprimet pasi antropologjia kulturore<sup>18</sup> merret me studimin e kulturave qe rregullojne menyren e jeteses se popujve ne te cilen perfshihen zakonet e shoqerive te ndryshme njerezore, pershkallezimi i aftesive transformuese, ne varesi te shkalles se zhvillimit ekonomik e kulturor, mbijetesa e traditave, ngjashmerite dhe dallimet ne kulturen e popujve te ndryshem persa i perket p.sh. martesave, familjes dhe praktikave te rritjes se femijeve sipas artit popullor, praktikave fetare dhe besimeve, jetes ekonomike, e deri ne tiparet psikologjike. Ne kete kendveshtrim antropologu ligjor interesohet se ne c' mase lidhen segmente te vecanta te kultures me njera tjetren, ne kuadrin me te gjere te fenomenit "njeri", nderkohe qe

---

<sup>17</sup> Hyrja ne Antropologji.(Aleksander Dhima)

<sup>18</sup> Antropologjia Kulturore (Roger Keesing,Andrew Strathern)

shkencat e tjera te karakterit social dhe mjedisor studjojne ane te ndryshme te jetes njezore, qofte edhe ne aspektin kulturor, por qe jane te palidhura me njeratjetren.

Dallimet relative qe kane mes tyre antropologjia kulturore me ate sociale i ben keto te dyja te kene nje lidhje ngushtesisht ne nje emer te perbashket pervec preferences se marrjes ne studim te aneve te vecanta te rastit. Per kete shkak antropologu social i drejton kerkimet e tij kryesisht ne grupe njezore specifike ku merr te dhena mbi organizimin e shoqerise locale, ritet me karakter shoqeror, funksionimin e sistemeve ekonomike e politike te vendit.

Pershkrimi me vertetesi i dukurive te tilla jep informacione shume te vlefshme per antropologun ligjor mbi ndikimin e institucioneve, te shtetit dhe te ligjit, ne menyren e jeteses se popullit.

Nje lidhje e posacme mes antropologjise se ligjit dhe psikologjise sociale<sup>19</sup> gjendet ne eksplorimin e individit dhe grupit si nje njesi analitike e vetme ne trajtimin e nderveprimin midis personit dhe vaiabelve situative, shmangieve te personalitetit, dhunimit te rregullave reziduale, raporteve midis kultures, konfliktit dhe krimit.

Per antropologjine e ligjit nje interest e vacante kane tema te tilla si politikrat krahasuese, teorite e lindjes se shtetit, ceshtjet e lidershipit, llojet dhe sfidat e pushtetit, format institucionale te mbrojtjes se te drejtave te njeriut dhe etika politico juridike.

Ne kete kontekst gjen lidhje shkakesore kjo disipline me antropologjine politike e cila eshte nje drejtim i specializuar i antropologjise sociale ku ka si objekt studimin e sfidave qe lidhen me pushtetin, aktivitetin politik dhe institucionet politike. Synimi perfundimtar i saj eshte analiza e dukurive politike ne kontekstin e jetes shoqerore.

---

<sup>19</sup> Hyrje ne Antropologji (Botimi I trete A.Dhima)



Kurse persa i perket antropologjise filozofike, per te formeuar njohurite nderkulturore ne studimin e tyre nuk e vendosin theksin tek arsyetimi, por mbeshteten ne vezhgimin dhe pervojen ku si pike lidhese me antropologjine e ligjit eshte eksplorimi nderkulturor i sjelljes ndaj ligjit dhe miti mbi shtetin.

Nese do te qendrojme per te pare nen kete drtite te ketyre shkencave rrugetimin e bere nga njerezimi per te krijuar mitin mbi te drejtat dhe lirate e tij si dhe mitin e shtetit, pa dashur me kujtohet se ky rrugetim i ngjan” Mitit te Sizifit”. Per te bere me aktuale kete legjende, po pershtasim, dhe per te kuptuar krahasimin mes kesaj figure dhe njerezimit si dhe shkembit me ligjin, do te kuptojme se njerezimi eshte heroik ne ndertimin e shtetit te se drejtes si dhe mbrojtjes se lirive dhe te drejtave te njeriut.

Po ti besojme Homerit, Sizifi <sup>20</sup>eshte njeriu me i ditur dhe me i kujdesshemi midis te vdekurve.

Megjithate, sipas nje tradite tjeter, ai terhiqej nga zanati i cubit.Nuk me duket se ka kontradite.Opinionet jane te ndryshme per shkaqet perse u denua te bente nje fare pune te padobishme.Para se gjithash, e qortojne per mendjelehtesi ne sjellje me perendite edhe pse e kishin denuar Sizifin te ngjiste pa pushim nje shkemb(ligji) ne maje te nje mali, nga ku guri (ligji) rrokullisej vetvetiu.Ato kishin gjykuar me te drejte se nuk ka ndeshkim me te tmerrshem se puna e padobishme dhe e pashprese nese nuk i ruan sekretet e tyre pra te Perendive, pasi Egina , vajza e Azopit u rrembye nga Jupiteri.

I ati u befasua nga kjo zhdukje dhe u ankua tek Sizifi.Ky i fundit, qe kishte dijeni per rrembimin, i premtoj Azopit t’i trgonte me kusht qe ky t’i jepte uje keshtjelles se Korinthit.Midis rrufeve qiellore dhe bekimit te ujit, ai zgjodhi te dytin. Per denim u

---

<sup>20</sup> Miti i Sizifit.(Homeri)

dergua ne ferr.Homeri na tregon gjithashtu se Sizifi kishte lidhur me zinxhire Vdekjen. Plutoni nuk mund te duronte kete pamje te shkrete e te heshtur te mbreterise se vet.Ai dergoi perendine e luftes qe te clironte vdekjen nga duart e ngadhjimtarit.

Tregojne, gjithashtu, se Sizifit, ne prag te vdekjes i hipi ne koke te vinte ne prove dashurine e gruas se vet.E urdheroi t'ia hidhte trupin e tij, te lene pa varr, ne mes te sheshit te qytetit.Per kete e cuan ne ferr. Dhe atje, i zemeruar nga bindja, aq e kundert me dashurine njerezore te se shoqes, i mori leje Plutonit te kthehet ne toke per te ndeshkuar te shoqen.Por kur erdhi perseri mbi toke, kur shijoi ujin e diellin,guret e nxehte e detin, nuk deshiti te kthehej prape ne erresiren e sketerres.Thirrjet , zemerimet e paralajmerimet rane ne vesh te shurdhet . Edhe per shume vite, ai jetoi ne harkun e gjirit, prane detit te shkelqyer dhe buzeqeshjeve te tokes.

U desh nje vendim i perendive.Merkuri erdhi dhe e kapi per zverku te pabindurin dhe duke e shkeputur nga gezimet e tij, e coi me force ne ferr ku e priste shkambi (ligji) i tij.

Kuptohet se Sizifi eshte heroj absurd .Ai eshte i tille si per pasionet, ashtu edhe per vuajtjet e tij.Percmimi per perendite , urrejtja e vdekjes dhe pasioni per jeten bene qe te vuaje nje denim te papare ku e gjithë qenia perpiqet te mos perfundoje asgje.Ky eshte cmimi qe duhet paguar per pasionet e kesaj bote.Asgje nuk na thuhet per Sizifin ne ferr.Mitet jane bere per te ndezur imagjinaten.Ne mitin e sipermendur shohim vetem perpjekjet e trupit te tendosur per te ngritur nje gur(ligj) te madh, per ta rrokullisur dhe per t'iu ngjitur pambarim nje te perpjete. Dallojme fytiren e ngerdheshur, faqen e mbeshetur te guri, nje shpatull nen gurin me balten rreshqitese, nje kembe qe e mban, dy duar qe e mberthejne, sigurine plotesisht njerezore te dy duarve te bera plote balte.

Ne mbarim te kesaj perpjekje te gjate, te kufizuar nga hapesira per qiell dhe koha pa thellesi, qellimi arrihet. Atehere Sizifi shikon gurin(ligjin) qe ne pak sekonda rrokulliset drejt botes se poshtme , nga ku duhet te ngrihet perseri per ne maje. Ai zbret ne fushe.

Pikerisht gjate kthimit, gjate kesaj pause, Sizifi me intereson ne kete legjende, fabul empiriko-juridike.

Nje fytyre qe lodhet aq afer gureve (ligjeve) eshte bere tashme gur (ligj) vet! E shoh kete njeri duke zbritur me hap te rende e te njejte drejt vuajtjes pa fund. Kjo ore qe eshte si nje frymemarrje dhe qe perseritet po me aq siguri sa edhe fatkeqesia e tij, eshte ora e ndergjegjes, ne cdonjerin nga keto caste, kur ai zbret nga maja dhe zhytet ne strofkat e perendive, ai qendron mbi fatin e vet. Eshte me i forte se shkambi (ligji) i tij.

Nese ky mit eshte tragjik, kjo ndodh ngaq hero i tij eshte i ndergjegjshem. Ne te vertete, cfare vlere do te kishte vuajtja e tij, ne qofte se cdo hap do te ushqente shpresen, per t'ia dale mbane?

Por ai nuk eshte tragjik, pervec rasteve kur behet i ndergjegjshem. Sizifi, i denuari nga perendite i pafuqishem dhe i revoltuar, e njeh gjithë shtrirjen e gjendjes se vet te mjeruar gjate zbritjes ai mendon per te. Qartesia, e cila duhej t'i shkaktonte vuajtje, realizon, ne te n jecten kohe, fitoren e tij. Nuk ka fat qe te mos perballohet me ane te percmimit.

Keshtu, nese disa dite zbritja behet me dhembje, ajo mund te behet gjithashtu me gezim. Kjo fjale nuk eshte e tepert por proverbiale. Per kete shkak e perfytyroj ende Sizifin duke u kthyer tek shkambi(ligji) dhe dhembja eshte ne fillim. Ku pamjet e tokes nguliten fort ne kujtese, kur thirrja per lumturi behet shume e rende, ndodh qe trishtimi

shfaqet ne zemren e njeriut, ky eshte ngadhnjimi i shkembit(ligjit), eshte vet shkemi(ligji).Kjo fatkeqesi e pamase eshte teper e rende per t'u perballur.Keto jane netet tona te Getsemanit.Por te vertetat shtypese asgjesohen kur behen te njohura.Keshtu, Edipi i bindet ne fillim fatit pa e ditur.Nga casti kur meson te vertete, fillon tragjedia e tij.Por ne te njejten kohe , i verber dhe ideshperuar, ai zbulon se e vetmja lidhje e tij me boten eshte dora e njome e nje vajze te re. Atehere nje e folur e "oshetin" pavaresisht nga veshtiresite e medha, mosha ime e thyer, dhe madheshtia e shpirtit tim me bejne te mendoj se, gjithcka eshte mire".Edipi i Sofokliut, ashtu si Kirilovi i Dostojevskit, na japin formulen e ngadhnjimit absurd. Urtesia e lashte takohet me heroizmin modern.

Nuk e zbulon dot absurdin pa ngasjen per te shkruar ndonje doracak per lumturine.Atehere lind pyetja "pse ne rruge kaq te ngushta"...? Por ka vetem nje bote. Lumturia dhe absurti jane dy femije te se njejtës bote.Jane te pandashem.Do te ishte gabim te thoshte se lumturia lind detyrimisht nga zbulimi i absurdit.Mund te ndodh qe ndjenja e absurdit te lind nga lumturia.

"Une mendoj se gjithcka eshte muire", thote Edipi, dhe kjo fjale eshte e shenjte.Ajo oshtin ne gjithesine e egersuar e te kufizuar te njeriut.Ajo na meson se jo gjithcka eshte shteruar.Ajo debon nga kjo bote nje perendi qe kishte hyre aty ne pakenaqesine dhe shijen e dhembjeve te panevojshme.Ajo e shnderon fatin ne ceshtje njerezore qe duhet te rregullohet midis njerezve.

Aty qendron i gjithe gezimi i heshtur i Sizifit.Fati i vet i perket atij.Shkembia (ligji) eshte prone e tij.Po ashtu, njeriu absurd kur kqyr vuajtjen e vet, ben te heshtin te gjithe idolet .Ne gjithesine ku papritur eshte vendosur heshtja, degjohen mijra zera te

mbrekulluar te tokes, thirrjet e pavetedijshme e sekrete, nga te gjitha fytyrat jane faqja tjeter dhe cmimi i fitores.

Nuk ka diell pa hije, prandaj duhet njohur nata.Njeriu absurd thote “po”, dhe perpjekja e tij nuk rresht kurre.Ne qofte se ekziston nje fat vetiak, nuk mund te kete fat te larte ose, te pakten,ekziston vetem nje fat, per te cilin mendohet qe eshte fatal dhe i percmuar.Per cfare mbetet, ai e di veten zot te diteve te tij.Ne kete cast te veshtire kur njeriu kthen syte nga jeta e vet Sizifi duke shkuar drejt shkembit(ligjit), sodit kete rrjedhe veprimesh pa lidhje qe behet fati i tij, i krijuar prej tij, i unifikuar nen veshtrimin e kujteses se tij dhe se shpejti i vulosur me vdekjen e tij.Per rrjedhoje, i bindur per origjinen krejtesisht njerezore te gjithckaje qe eshte njerezore, i verber qe deshiron te shohe dhe qe e di se nata nuk ka fund, ai eshte gjithmone ne udhe.

Shkambi (ligji) vazhdon te rrokulliset.

Po e le Sizifin ne kembet e malit! Gjithmone takojme barren e tij.Por Sizifi na keshillon nje besnikeri te larte e cila mohon perendite dhe ngre shkembinjte (ligjet).Edhe ai mendon se gjithcka eshte mire.Kjo gjithesesi, ketej e tutje pa zoteri, nuk i duket as shterpe as boshe.Cdo kokerrize e ketij guri (ligji), cdo ndricim mineral i ketij mali te zhytur ne terr formojne ne vetvete nje bote.

Vete lufta drejt majave mjafton per te mbushur zemren e njeriut.

Duhet ta perfytyrojme Sizifin (njeriun) te lumtur!

## **KAPITULLI V: ANALIZA 2**

### **5.1.Pronesia ne mendimin Juridik Shqiptar**

- **Ipsa Jure-**
- **Nga vete natyra e ligjit.**
- **Non in legendo sed intelligendo leges consistant-**
- **Ligjet kane vlere jo ne leximin por ne kuptimin e tyre-**

Koncepti ligj eshte teper i veshtire per tu kuptuar.Kjo per arsye se ligji mund te shihet ne kendveshtrime te ndryshme dhe nga secili kendveshtrim mund te nxirret nje kuptim i ndryshem mbi konceptin ligj. Veshtiresite mbi kuptimin e konceptit ligj linden pikesepari sepse jurisprudenca qe merret me studimin e ketij koncepti e studion ate ne dy kuptime:

- 1- Ne kuptimin analitik
- 2- Ne kuptimin normativ

Duke u nisur nga sa mesiper kemi ndarjen ne jurisprudence normative dhe jurisprudence analitike.

Jurisprudenca analitike merret me studimin analitik te strukturave dhe koncepteve ligjore, me shpjegimin e elementeve thelbesor ligjor qe perben te drejten ne teresi, apo ne sisteme ligjore te vecanta. Jurisprudenca normative merret me studimin dhe vleresimin e rregullave dhe strukturave ligjore duke u bazuar ne disa standarde ideale

dhe percakton kriteret lidhur me ate se cfare perfaqson nje e drejte e mire. Me pak fjale jurisprudenca analitike nenkupton te drejten sic eshte ndersa jurisprudenca normative nenkupton te drejten sic duhet te jete.

Nga ky kendveshtrim do te trajtohet vendi qe ze prona dhe pronesia ne mendimin juridik shqiptar mes lirive themelore te njeriut si dhe sigurise e garancise kushtetuese, pra permes dy ligjeve kryesore.

### **Kuptimi I ligjit**

Ne perputhje me ndarjen e mesiperme edhe koncepti i ligjit<sup>21</sup> perdoret ne dy kuptime, duke i kuptuar ligjet si deskriptive ose pershkruese dhe preskriptive ose urdheruese. Ligjet descriptive jane pohime qe tregojne se si ndodhin ne fakt gjerat si rregull si p.sh.ligjet e fizikes dhe natyres. Ligjet preskriptive jane pohime autoritare per ato gjera qe duhej te ndodhnin p.sh neni 21 dhe 22 i Kushtetutes se Republikes se Shqiperise<sup>22</sup>. Keto jane ligje te qarta urdheruese qe kane te bejne me miratimin e ligjeve te tjera urdheruese. Ato paraqesin qarte ate ne lidhje me cka Kuvendi duke miratuar ligje te tjera urdheruese lejohet ose jo te beje. Keto lloj ligjesh urdheruese jane objekt studimi ne filozofine e se drejtes, ndersa ligjet pershkruese studiohen nga filozofia e shkences.

Dallimi midis ligjeve urdheruese dhe pershkruese eshte ndonjehere i veshtire dhe kjo eshte nje arsye tjeter pse studimi i konceptit ligj eshte i veshtire. Autore te ndryshem e shikojne konceptin e ligjit ne elemente te ndryshem duke e ngaterruar ate, apo me keq akoma duke e barazuar me moralin, dhunen apo rregullin. Nje nga keta autore (Harti),<sup>23</sup>

---

<sup>21</sup> Filozofia e se drejtes (Luan Hasani)maluka Tirane 2005

<sup>22</sup> Kushtetuta e Republikes se Shqiperise.

<sup>23</sup> Filozofia se Drejtes Xhefri G.Merfi Xhuls L.Kolman.

shprehet se ligji nuk eshte gje tjeter vecse nje mjet per realizimin e kontrollit shoqeror duke i detyruar njerezit te benin disa gjera qe nuk do ti benin po ti lije ne vullnetin e tyre te lire.

Vertet mund te ngaterrohen konceptet moral dhe ligj, por ndonjehere te dy keto koncepte rregullojne te drejten, pergjegjesite etj. Ka shume detyrime ligjore qe nuk jane morale apo anasjelltas p.sh.lidhja e kontrates se huas mbi 50 mije leke me shkrese, apo mos ecja me shpejtesi me te madhe se 25 km/ore ne qendrat e banuara, jane detyrime ligjore por jo morale, ashtu si edhe disa detyrime te miresjelljes, sinqeritetit dhe dashurise jane detyrime morale por jo ligjore. Dallimi thellesor midis detyrimit moral dhe atij ligjor qendron ne faktin se detyrimi moral zbatohet vet ne ndergjegje dhe nuk sjell ndonje pasoje negative ne rast moszbatimi, ndersa detyrimi ligjor zbatohet edhe pa ndergjegjen e personit dhe moszbatimi i tij sjell pasoja ose sanksione negative te cilat mund te jene ndeshkuese ne rastin e te drejtes penale dhe privuese ne rastet e ligjeve civile, ne kuptimin qe personi nuk do te realizonte qellimin per te cilin ai kryen veprimin e caktuar. Vec kesaj detyrimi ligjor nuk duhet te ngaterrohet me dhunen, pasi eshte e vertete qe nje sistem ligjor eshte i bazuar mbi dhunen, sidomos kur behet fjale per ligjet penale. Mirepo ka nje dallim thellesore midis dhunes se ushtruar ne nje sistem ligjor me ate te ushtruar ne menyre te jashteligjshme p.sh.ne qofte se nje person vret nje tjeter dhe denohet me vendim te formes se prere nga gjykata me burgim dhe policia gjyqesore e zbaton me force kete vendim, ku personi i denuar e kundershton po me force policine, atehere eshte e qarte se jemi para perdorimit te ligjshem te dhunes,pasi nje nga deryrat e policise gjyqesore eshte zbatimi dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqesore. Nga ana tjeter kur nje person te del perpara me maske dhe te kerkon parate duke te kercenuar me arme eshte e qarte se ai po ushtron mbi ju dhune,



por kjo dhune ndryshon nga ajo qe perdor policia gjyqesore. Dhuna qe ushtron polici eshte e ligjshme, ndersa dhuna qe ushtron personi i armatosur eshte e paligjshme.

Nje aspekt tjeter qe e ben te veshtire kuptimin e natyres se ligjit eshte edhe fakti se koncepti i ligjit ndeshet me disa raste te diskutueshme praktikash ose institucionesh qe kane tipare te perbashketa me raste te qarta ligjore sa na shtyjne ti quajme ligje, por nga ana tjeter kane aq shume ndryshime sa mund te mos quhen te tille. Keshtu eshte e diskutueshme nese e drejta nderkombetare apo e drejta primitive perbejne apo jo ligje. Ne se i quajme te atille pra ligje, mund te pyesim se cili kuvend i ka miratuar, cili trup gjykues i interpreton dhe cilet organe ndeshkimore i mbeshtetin ato me force. Nese i qendrojme strikt konceptit te ligjit, sidomos ne fushen penale eshte e veshtire te pranohet se te drejta te tilla jane ligje. Por po te shohim problemin ne nje aspekt me te gjer, ne kuptimin qe nje norme mund te jete shnderruar ne ligj pa u miratuar nga nje trup ligjvenses, por thjesht per efekt zakoni sic jane shume norma te se drejtes nderkombetare, atehere mund te themi se e drejta nderkombetare dhe e drejta primitive perbejne raste te diskutueshme praktikash ligjore.

Nje tjeter aspekt i rendesishem i jurisprudences qe merret me natyren e studimit te ligjit eshte te beje dallimin midis koncepteve ligj dhe rregull.<sup>24</sup> Koncepti i ligjit kerkon nje analize nepermjet elementeve te cilet ne vetvete paraqesin ceshtje filozofike te rendesishme. Disa ligje ngjajne ose lidhen ose mund te jene vete rregulla. Rregullat nuk jane objekte materiale qe mund te shihen, qe mund te preken, megjithate nuk eshte e pavertete te thuash se, ne shoqerine tone ka nje rregull qe ndalon vrasjen apo vjedhjen. Po ashtu eshte e vertete qe nuk ka nje rregull qe te detyron qe te jesh i sinqerte.

---

<sup>24</sup> Filozofia e se Drejtes(Luan Hasani)maluka 2005

Ne kendveshtrimin midis koncepteve rregull dhe ligj, mund te them se koncepti rregull eshte me i gjere. Koncepti rregull perfshin nje koncept me te gjere se ai i ligjit dhe mund te themi pohimin se cdo ligj mund te jete nje rregull, por jo anasjelltas, jo cdo rregull mund te jete ligj. Ne aspektin e zbatimit te rregullit dhe ligjit mund te bejme dallimin qe rregulli nenkupton zbatimin e tij nga personi pa u shoqeruar nga sanksioni, ndersa nje rregull i shnderuar ne ligj nenkupton zbatimin e tij dhe papelqimin e personit duke u shoqeruar me sanksion. Do me thene nese nje person nuk zbaton nje ligj ai do te vuaje sanksion privues ne rastet e te drejtes civile dhe nje sanksion ndeshkues ne rastet e te drejtes penale.

Problemi i fundit i objektit te filozofise dhe natyres se ligjit eshte problemi i kuptimit dhe interpretimit te ligjit ne nje rast konkret. Ata qe pergjithesisht nuk kane njohuri per natyren e ligjit mendojne se eshte e lehte te gjejne ligjin qe duhet zbatuar, por shpesh here ne te vertete procesi i kuptimit te ligjit nuk eshte i thjeshte. Mundet qe ligji ti thote gjerat ne menyre te mjegullt pjeserisht apo te mos i parashikoje fare. Ne keto kushte interpretimi dhe gjetja e normes nga zbatuesi i se drejtes nuk eshte nje gje mekanike, por nje pune krijuese sidomos ne sistemin common law, ku gjyqtari me shume se interpreton nje norme konkrete, bazohet ne precedentin e meparshem gjyqesor. Veshtiresia ne interpretimin dhe zbatimin e ligjeve ne nje rast te dhene eshte nje arsye tjeter praktike pse studimi i konceptit ligj dhe natyres se tij eshte e rendesishme si objekt i filozofise.

Merite ne kete duhet te kete konstitucionalizimi i gjuhes juridike, e cila duhet qe te kete termat dhe fjalorin e saj dhe menyren e vecante te shprehjeve, ku brenda shkrimit te gjuhes letrare te ligjit te gjejne vendin e tyre te duhur shprehjet juridike .

Ky imperativ duhet te ekzistojë në shkrimin ligjor nëpërmjet teknikes legjislative si dhe te frymezuar nga shkrimi akademik.

Nga sa më sipër lind pyetja se kush mund ta bëjë këtë?

Pike së pari këtë mund ta bëjë ai që ka titullin “JURIST” i cili mund të jetë pjesëmarrës në disa institucione si ato legjislative, ekzekutive apo gjyqësore etj dhe përfundimisht mund të bëhet nga kontrolli kushtetues që i bënë Gjykata Kushtetuese ligjeve në funksion të Kushtetutes.

Pra norma juridike, ligji apo dispozitat ligjore që të krijohen, të miratohen dhe të zbatohen duhet që të kalojnë nëpër një infrastrukturë juridike të qartë dhe kompetente.

Suksesi i vertet në këtë rast varet shumë prej dijeve ligjore dhe aftësive për të konkretizuar këto dije në aspektin teorik dhe atë praktik të së drejtës. P.sh. nëpërmjet paligjshmërisë dhe antikushtetueshmërisë duhet të këtë ndërprerje dhe kufiri i ndërprerjes duhet të jetë ligji si akt me konkretë së kushtetuta. Aty ku paligjshmëria është e kontestueshme aty do të kemi vetëm kontroll ligjshmërie nga Gjykata Kushtetuese<sup>25</sup>. Ndërsa cenimet e të drejtave të personave nga akti normativ do të interpretohen, arsyetohen dhe analizohen nga gjykatat e zakonshme të cilat kanë të drejtë të vendosin në bazë të ligjit. Pra në këtë rast kemi të bëjmë me dy aspekte. Aspekti i parë është pakushtetueshmëria dhe aspekti i dytë është paligjshmëria. Në lidhje me aspektin e parë gjejmë të sanksionuar se është Gjykata Kushtetuese<sup>26</sup> ajo që përben garantin kushtetues nëpërmjet interpretimit kushtetues dhe koncepteve lëndore. Në lidhje me aspektin e dytë gjejmë të sanksionuar se janë gjykatat e zakonshme ato që interpretojnë ligjin dhe vlerësojnë nëse faktet janë në përputhje me ligjin (nga de fakto në de jure).

---

<sup>25</sup> Neni 132 i kushtetutes së Republikës së Shqipërisë.

<sup>26</sup> Neni 124 i kushtetutes së Republikës së Shqipërisë.

Pra e para tregon qarte se ceshtjet kushtetuese nuk mund te bihen ne nje gjuhe te ngushte teknike te ndonje dege te se drejtes por ka per qellim qe te gjykoje nese ligji bie ndesh apo jo me Kushtetuten.

Kurse e dyta tregon qarte se ceshtjet e vecanta qe i perkasin nje dege te se drejtes vleresojne nese nje fakt eshte i ligjshem apo jo.

Pra ne gjuhen juridike qe perdoret ne gjykatën e zakonshme trajtohet fakti sipase ligjit, kurse ne gjuhen kushtetuese diskutohet pikerisht ligji i cili eshte apo nuk eshte kushtetues.

Por edhe ne raset kur kemi te bejme me ceshtjet te cilat i neneshtrohen juridiksionit te gjykatave te zakonshme, eshte sanksionuar tashme nga neni 6<sup>27</sup> i KNDNJ dhe ne Kushtetute procesi i rregullt ligjor ku cdo subjekt fizik apo juridik i drejtohet Gjykares Kushtetuese te marre ne shqyrtim shkeljet qe i jane bere nga gjykatat e zakonshme nga nje proces i pa rregullt ligjor<sup>28</sup>, ku hyjne interpretimi kushtetues dhe kopetencat lendore mbi gjykimin e ketyre ceshtjeve .

Lind pyetja, me kaq sa mesiper a mund qe te identifikojme te drejten?

Une them se jo pasi kemi pare vetem disa pika referimi nga ana e brendeshme e ligjit dhe se drejtes. Por ekzistenca dhe permbajtja e se drejtes mund te identifikohet duke ju referuar burimeve shoqerore te se drejtes, si legjislacioni, vendimet e gjyqesorit ose zakonet shoqerore, pa ju referuar moiralit, me perjashtim te rasteve kur e drejta qe identifikohet keshtu i ka ne perberjen e vet kriteret morale per identifikimin e saj.

---

<sup>27</sup> Neni 6 KDDNJ.

<sup>28</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë neni 42

## **Ndikimi i kushteve historike dhe ekonomiko-shoqerore ne mendimin juridik shqiptar**

Ne kete kontekst mendimi juridik ashtu si edhe shteti dhe e drejta ka lindur ne kushte historike te caktuara. Procesi i formimit te tij ka qene i gjate e i nderlikuar. Ai ka kaluar neper stade te ndryshme te zhvillimit te shoqerise. Mendimi juridik, kultura juridike ne pergjithesi eshte zhvilluar ne rende te ndryshme ekonomiko-shoqerore, si dhe ne kushtet e pushtimeve te huaja, te cilat ka perjetuar Shqiperia. Per shkak te pozites se saj gjeografike dhe gjeopolitike midis lindjes dhe perendimit, kane qene te pashmangshme ndikimet e kultures te popujve te vendeve lindore dhe te vendeve perendimore mbi kulturen juridike shqiptareve dhe anasjelltas.

Por megjithate, ajo ne rrjedhen e shekujve ruajti identitetin e saj. Kultura juridike tradicionale e popullit shqiptar ka lidhje te ngushte me kulturen materiale e shpirterore te tij, me shtetin, filozofine, fene, moralin, psikologjine, ideologjine, e politiken qe ushtrojne ndikim te fuqishem mbi te, pavaresisht se ne analize te fundit, percaktohen nga nevojat materiale te njerezve ne etapa te ndryshme te zhvillimit te shoqerise shqiptare.

Mendimi juridik, ashtu si e drejta, ka pesuar evolucionin e tij historik. Fillimisht ai shprehej ne format me te thjeshta empirike, ne normat e sjelljes se njerezve, te cilat buronin nga filozofia popullore ne qendrim ndaj drejtesise e padrejtesise, ndaj te mires dhe te keqes, e pastaj, ne normat e se drejtes zakonore. Ai tani ka arritur nivele te larta, te sintetizuara ne ligjet pozitive dhe vecanerisht ne Kushtetuten e re te shtetit demokratik.

Kushtetuta, si ligj themeltar i shtetit<sup>29</sup>, eshte baze per te relizuar plotesisht reformen ligjore dhe institucionale, sipas mendimit juridik bashkekohor si dhe vepra shkencore te autoreve shqiptar.

Mendimi juridik, e drejta pozitive dhe shteti bashkeveprojne ne jeten e shoqerise dhe se asnjeri pa tjetrin nuk mund ta bejne. Realizimi i funksioneve te shtetit behet neprmjete normave juridike, ne te cilat sintetizohet mendimi juridik, kurse shpjegimi dhe interpretimi shkencor i tyre behet nga shkenca juridike.

Pikerisht se ekziston kjo lidhje dhe varesi e ndersjellte midis tyre, mendimi juridik luan rol te madh ne ndergjegjshmerine e njerezve ne qendrimin e tyre korrekt ndaj shtetit dhe per respektimin dhe zbatimin e ligjeve te tij.

Pervoja jetesore e popullit tone, perfshire vitet e tranzicionit paskomunist, ka treguar se mungesa e kultures juridike ndikon negativisht deri ne paralizen e shtetit, shkeljen e ligjeve, dhe ne anarki dhe ne vetegjyqesi.

Kuptohet se per shkak te kushteve historike te Shqiperise deri ne gjysmen e dyte te shk.XIX nuk mund te pretendohet qe mendimi juridik shqiptar te shprehej ne vepra shkencore juridike te shkruara. Mendimtaret e medhenj te Rilindjes sone kometare (shek.XIX) kane dhene kontributin e tyre per problemet e shtetit dhe te se drejtes. Pas tyre duken juriste te mirefillte, te paret e mendimit juridik shqiptar (1912) e ne vazhdimesi shkuan duke u bere gjithnje e me shume e me vepra shkencore.

Pa e njohur procesin e lindjes e te formimit te mendimit juridik, nuk mund te njihet sa duhet as historia e shtetit dhe e se drejtes, e anasjelltas. Ne keto kushte, per paraqitjen

---

<sup>29</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë neni 4

e mendimit juridik nga Iliria deri ne shekullin XIX<sup>30</sup>, ka rendesi te madhe te mbahen parasysh disa vecori kryesore dhe rrethana historike mbi frymen e ligjit ku lozin rol faktoret objektiv, kerkesat e praktikes. Kjo dikton nevojne qe njererzit te mendojne dhe te kerkojne pikpamje, koncepte e norma sjelljeje, te cilat fillimisht, kane karakter moral, gradualisht kthehen ne shprehi zakonore qe perseriten vazhdimisht dhe me krijimin e shtetit, shnderohen ne norma te se drejtes zakonore, qe pasqyrojne pikpamjet e shtresave e klasave te ndryshme. Po ashtu duhet te mbahen parasysh edhe faktoret subjektiv dhe konkretisht te autoreve anonime, pikpamjet e tyre per te drejten dhe te padrejten. Keto pikepamje juridike u shfaqen ne vendosien e normave zakonore te pashkruara.

Vecoria e shtetit Ilir<sup>31</sup> qendron ne faktin se, mendimi juridik ashtu sikurse krijuesit e se drejtes mbeten anonim, ndryshe nga Roma e vjeter apo Greqia e lashte, ku e drejta u shkrua dhe mendimi juridik i shkruar kane ardhur deri ne kohen tone.

Nga pikpamja antropologjike mendimi juridik ne shtetin Ilir e kishte bazen filozofike ne mencurine popullore, bazuar ne botkuptime pagane, fetare, empirike, idealiste.

Sigurisht mungesa e veprave te shkruara me permbajtje juridike e veshtireson, por nuk e ben te pamundur, argumentimin e ekzistences dhe te zhvillimit te mendimit juridik, sado ne formen embrionale e empirike. Por pa nje mendim juridik nuk mund te konceptohej se si mund te arrihej ne organizimin e shtetit Ilir, ne percaktimin e kompetencave te organeve te tij, dhe te ekzistonte dhe te vepronte e drejta per rregullimin e marredhenieve juridike. Po ne baze te ketyre pikpamjeve eshte bere

---

<sup>30</sup> Historia e Shtetit dhe e se Drejtes botimi i 3-te. L.omari A.anastasi.

<sup>31</sup> Historia e Shtetit dhe e se Drejtes botimi i 3-te. L.omari A.anastasi

organizimi i shtetit te Arbrit(Shek.XII)<sup>32</sup> i principatave feudale shqiptare gjate shek.XII-XV, para pushtimit osman, e aq me shume,organizimi e funksionimi i shtetit te pavarur nen udheheqien e Skenderbeut(shek.XV),<sup>33</sup> i cili realizonte funksionet e brendeshme e te jashtme per gati 25 vjet, duke qene ne lufte kunder pushtuesve osmane.

Mjafton te kemi parasysh vepren e kronistit Marlin Barletit e te Dhimiter Frankut per te krijuar nje perfytyrim per shtetin nen udheheqien e Skenderbeut, pavaresisht se nuk ishte botuar ndonje monografi juridike, ndryshe nga gjuhesia ku njihet vepra e Buzukut, Budit, Bogdanit, etj.

Argument tjetër për sa mesipër është se evolucioni i mendimit juridik mund të kalojë nga normat e së drejtës zakonore të pashkruara, në sanksionimin e Kushtetutës së shtetit të Epirit në Ilirine e Jugut në kohën e sundimit të Pirros së Epirit (297-262) para erës së re e të ligjeve të tjera. Përkishtë nga evolucioni i mendimit juridik mund të ndërtohet sistemi i së drejtës me deget e saj në shtetin e pavarur të Skenderbeut e deri në kanunet e mesjetarë shqiptarë, ku sintetizohen zakonet e traditat e popullit shqiptar dhe përvoja shekullore në zgjidhjen e konflikteve. Ndonëse ende nuk është provuar që këto kanune të kënaqëne të shkruara, dihet me siguri se ato u trasmentuan në gojdhenat popullore brez pas brezi deri në kohën tonë, sa u mbledhën e u kodifikuan nga fillimi i këtij shekulli e ketëj.

Nuk mund të mohohet se në zhvillimin e mendimit juridik shqiptar gjatë këtyre shekujve ka vepruar e ndikuar fuqimisht qyteterimi greko-romak e bizantin, ligjet dhe kultura juridike e tyre që kishte nivel të lartë. Ky proces filloi që nga pushtimi i Ilirisë

---

<sup>32</sup> Historia e Shtetit dhe e së Drejtës botimi i 3-te. L.omari A.anastasi.

<sup>33</sup> Historia e Shtetit dhe e së Drejtës botimi i 3-te. L.omari A.anastasi.



nga Roma<sup>34</sup> (V.167 para eres se re), ku dihet qe shteti dhe e drejta romake ishin mbi baza te forta filozofike e juridike. Pas pushtimit bizantin qe zgjati rreth 1000 vjet, ndikimet e legjislacionit (ndikimet e Kodit te Justinianit) dhe te mendimit juridik u thelluan edhe me tej.

Po me pushtimin e Shqiperise nga perandoria Osmane qe zgjati gati 470 vjet, krahas ndikimit te mendimit juridik greko-romako-bizantine u shtua dhe ajo osmane, bazuar ne ideologjine fetare te islamit (sheriatit etj).

E megjithate kultura juridike, si pjese perberese e kultures popullore nuk u asimilua, ajo u skalit ne te drejten zakonore te zakoneve te mira e ne ate kanunore nga jugu ne veri ne Kanunet e Laberise, te Lek Dugagjinit, te Skenderbeut, Statuti i Scutarit etj. Edhe mendimi juridik anonim ruajti ne masa te ndryshme origjinalitetin e tij.

Pa perjashtuar zigzaket ne labirinthet e kohes ne procesin e zhvillimit te mendimit juridik shqiptar e ndryshimet qe pesoi gjate rrethanave te rrjedhes se shekujve, ai mbijetoi dhe mori trajta te qendrueshme ne veprat e mendimtareve te shquar te Rilindjes sone Kombetare.

Nga vete natyra e ligjit per pos sa mesiper duke u nisur nga karakteri tipizues dhe karakteri pergjithesuse, nje rendesi te madhe dhe kryesore mendimi juridik shqiptar ze permes lirive dhe te drejtave te njeriut si dhe sigurise e garancise Kushtetuese.

---

<sup>34</sup> Historia e Shtetit dhe e se Drejtes botimi i 3-te. L.omari A.anastasi.

## **E drejta e pronesisë në themel të rendit juridik**

Nisur nga fakti se, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qendrojnë në themel të të gjithë rendit juridik<sup>35</sup>, një nga të drejtat kryesore dhe themelore është ajo e të drejtës së pronesisë e cila madje është një e drejtë absolute dhe e garantuar me ligj.

Të drejtat e njeriut janë parime baze pa të cilat njerezit s'mund të jetojnë si qenie njerezore me dinjitet dhe si rrjedhojë respektimi i tyre bën të mundur progresin, prosperitetin dhe integrimin e individit dhe të shoqërisë.

E drejta dhe liria shndërohen në koncepte themelore në momentin që sanksionohen nga Kushtetuta si dhe nga traktate të rëndësishme ndërkombëtare si konventat të cilat zënë vend në të drejtën e brendshme nëpërmjet radifikimit të tyre nga ligjvënisi.

Pronesia është një institut juridik dhe e drejta e pronesisë megjithëse është “një e drejtë”, ajo nuk është një entitet abstrakt dhe ideal, por imazhi i një realiteti të caktuar shoqëror, ku në rëndë të ndryshme juridike ka pasur mbrojtje të ndryshme.

Në rendin demokratik dhe shtetin e së drejtës, mbrojtjes së saj i jepet një rëndësi e vecante pasi konsiderohet si kushti themelor për zhvillimin e pronës dhe marrëdhënieve me pronësinë që kanë personat fizik e juridik vendas e të huaj.

Pikërisht ligjvënisi ynë duke u nisur nga fakti se prona<sup>36</sup> është një e drejtë vetiake, e ka sanksionuar atë në Kushtetute dhe konkretisht në nenin 41 të saj, ku është përcaktuar

---

<sup>35</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë neni 15

<sup>36</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë neni 41

menyra e fitimit te pronesis private nepermjet trashegimise, dhurimit, blerjes si dhe cdo menyre tjeter klasike te parashikuar ne K.C sipase neneve 149 e vijues te tij.<sup>37</sup>

Pervec garantimit qe Kushtetuta i ben te drejtes se pronesis nepermjet nenit 41 dhe te drejtes subjektive per nje proces te rregullt ligjor parashikuar nga nenet 42 e 43 te saj parashikohet edhe e drejta e ankimit ne gjykate. Kjo dispozite kushtetuese, pra neni 43, zbatohet drejperdrejt duke qene se ne legjislacionin tone parashikohen edhe mjete te tjera per te bere te mundur garantimin e te drejtes se pronesis.

Keshtu ne pjesen e pergjitheshme dhe te posacme te K.Pr.C te miratuar me ligjin nr.8116 dt.29.03.1996, zberthehen normat e se drejtes se pronesis qe garantone Kushtetuta.Keshtu ne nenin 31 K.Pr.C<sup>38</sup>, individit i njihet e drejta per te bere padi si nje e drejte e personit per tu degjuar, ne menyre qe gjykata te shpalle nje vendim te bazuar ne fakte dhe ne ligj ose jo. Po ashtu ky akses gjendet edhe ne dispozitat e posacme te neneve 369 e vijues te K.Pr.C<sup>39</sup> persa i perkete pjestimit te pasurise se perbashket si dhe dispozitave te K.Familiar per regjimin ligjor apo kontraktor te pasurise bashkeshortore.

Pervec ketij aksesit qe i ka dhene individit Kushtetuta dhe legjislacioni civil material dhe procedural apo ai penal persa i perket mbrojtjes se pronesis ne nenet 134-140; 141-147; 148-159; 199-200:205-206 te K.P<sup>40</sup>, po ashtu edhe dispozitat procedurale te neneve 61 e vijues te K.Pr.P<sup>41</sup> persa i perket padise civile ne procesin penal etj, Shqiperia ratifikoje dhe K.E.D.N j ne vitin 1996<sup>42</sup> dhe e perfshiu ate ne sistemin ligjor te saj. Ketu e drejta e pronesis ka nje raport te drejte me kete konvente, pasi kjo konvente ju

---

<sup>37</sup> Kodi Civil neni 149

<sup>38</sup> Kodi i Procedures Civil neni 31

<sup>39</sup> Kodi i Procedures Civil neni 369

<sup>40</sup> Kodi Penal

<sup>41</sup> Kodi i Procedures Penale neni 61

<sup>42</sup> Kushtetuta e Republikes se Shqiperise

ngarkone te gjitha shteteve detyrimin pozitiv per mbrojtjen e te drejtave te njeriut te parashikuara ne dispozitat e saj. Nje nga keto te drejta qe shteti Shqiptar eshte angazhuar te mbroje eshte edhe e drejta e pronesise.

### **Detyrimet dhe funksionet qe sjell e drejta e pronesise ne mendimin juridik shqiptar**

Te drejtat sjellin dhe detyrime dhe ne kete rast mund te zberthehen ne tri drejtime kryesore:-

-1-Detyrimi per te respektuar te drejten e pronesise ku do te kuptohet detyrimi i shtetit per te mos nderhyre ne te drejten e pronesise se individit, te personave fizike, apo juridike vendas e te huaj.

-2-Detyrimin e mbrojtjes se saj ku do te kuptohet mbrojtja e prones se personit fizik apo juridik nga nderhyrjet e personave qe pretendojne se kane nje te drejte pronesie.

-3-Detyrimi i shtetit per te krijuar kushtet e nevojshme qe kjo e drejte pronesie te ushtrohet efektivisht dhe ne menyre te qete.

Sipase jurisprudences se Gjykates Evropiane per te Drejtat e Njeriut<sup>43</sup>, e drejta e pronesise ka dy funksione:-

-a-Fuksioni privat i cili sjell ndikimin e vet ne gezimin normal te lirive dhe te drejtave te individit. Kuptimi historik dhe ai i perditesuar i garancise se prones eshte kuptimi i nje te drejte themelore qe lidhet pazgjithshmerisht me lirine individuale.

-b-Funksioni shoqeror ku prona ka njekohesisht edhe funksion te dallueshem shoqeror, pasi perdorimi i saj duhet t'i sherbeje vec te tjerash edhe mireqenies publike.

---

<sup>43</sup> KEDDNJ neni 46

Persa kohe funksioni i pronës është një mjet për ruajtjen e lirisë vetiake, prona gëzon një mbrojtje të veçantë. Nga ana tjetër, ligjvënësia mund të vendosë kufizime ndaj pronës sa më i madh të jetë funksioni social i saj. Sidoqoftë “garancia Kushtetuese e pronës” nuk mund të pranojë kufizime jo proporcionale, d.m.th. kufizime që nuk justifikohen me konsiderata sociale.

Funksionet e mesiperme nuk cenojnë të drejtën e shteteve që të vënë në fuqi ligjet që ato i quajnë të domozdoshme për të rregulluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar shlyerjen e taksave, tatimeve, të detyrimeve të tjera apo gjobave të ndryshme.

Në këtë mënyrë garancia që i japin individit normat Kushtetuese i bashkëngjiten edhe normat e të drejtës ndërkombëtare të cilat nëpërmjet marrëveshjeve ndërkombëtare të radifikuara në Shqipëri bëhet pjesë e së drejtës së brendshme pas publikimit në fletoren zyrtare e në gjuhën shqipe.

Për rrjedhojë dispozitat e këtyre marrëveshjeve kanë të njëjtin efekt, si e drejta vendase, si dhe shkelja e dispozitave të tyre mund të pretendohet nga individët në të njëjtin mënyrë si edhe për ligjet e brendshme. Ky rregullim konsiderohet si arritje e rëndësishme në lidhje me sistemin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirisë në përgjithësi dhe të drejtës së pronës në veçanti. Në këtë mënyrë individët kanë edhe mjete të tjera për të pretenduar rivendosjen në vend të së drejtës së pronës të garantuar nga traktatet ndërkombëtare. Kështu një vend të rëndësishëm dhe kryesor zënë nën të K.D.Nj<sup>44</sup>, kjo jo vetëm për faktin e gjithë përfshirjes së lirisë dhe të drejtave në dispozitat e sajë, por edhe të mekanizmave mbrojtës të vendosura në Strazburg për të hetuar gjyqësisht shkeljet e raportuara dhe për të respektuar detyrimet që rrjedhin nga Konventa, por edhe

---

<sup>44</sup> Konventa e të drejtave të njeriut.

per faktin tjeter se ne hierarkine e normave ligjore te zbatueshme ne sistemin Ligjor te Shqiperise Konventa kosiderohet ne majen e hierarkise se normes se bashku me Kushtetuten.

Perc statusit te brendshem Kushtetuta garanton zbatimin ne menyre te drejtperdrejt te ketyre marreveshjeve nga ana e gjykatave Shqiptare. Pavaresisht se kjo eshte nje zgjedhje e pelqyeshme ne teori, le vend per te deshiruar ne praktik sepse rrallehere gjejm vendime te gjykatave tona te cilat t'i referohen ne menyre te drejtpersdrejte marreveshjeve nderkombetare.

## **5.2. NACIONALIZIMI DHE DENACIONALIZIMI I PRONES DHE TE DREJTES SE PRONESISE.**

Ne historine e njerezimit po ashtu edhe ne historine tone gjenden te trajtuara keto dy koncepte tashme te se drejtes.

E thene ndryshe jemi perpara nacionalizimit te prones dhe te drejtes se pronesise aq here sa shteti me format e tij sekuestron, konfiskon apo merr nepermjete reformave te ndryshme pronen private dhe e kthen ate ne prone shteterore apo publike per interesa te caktuara shteterore duke zgjeruar keshtu pronen dhe te drejten e pronesise publike dhe asaj shteterore.

### **Paradigmat juridike ne pronesine shqiptare**

Pra pike se pari jemi perpara nje paradigme juridike ne formen e modelit dhe shembullit nepermjet te ciles vihet ne dukje veprimi i shtetit per te formuar pasuri

shteterore, duke i dhene ne kete menure perparesi prones shteterore dhe asaj publike karshi prones private.

A contrario, pra nga e kunderta jemi perpara denacionalizimit te prones aq here sa shteti shet apo jep nepermjet reformave te ndryshme pronen shteterore personave fizik te ndryshem, pra shtetasve te tij apo te huaj.

Pra pike se dyti jemi perpara nje paradigme referimi ndaj praktikave te caktuara qe dallojne veprimet e shtetit per te kufizuar pronen dhe te drejten e pronesise shteterore apo publike inverso shtetasve te saj apo shtetasve te huaj duke i dhene ne kete menyre perparesi prones private karshi asaj shteterore dhe publike.

Por paradigma tjeter juridike mund te shfaqet edhe ne trajten e asaj qe quhet "paradigm dominuese" e cila eshte nje paradigme qe i referohet vlerave dhe sistemeve ne nje shoqeri me standarte te caktuara

Pra jane disa kushte apo rrethana qe e bejne nje paradigme te tille dominuese me synimin e fokusimit te "fakteve sociale", "percaktimeve sociale" dhe "sjelljeve sociale" te konvertuara mepas ne "fakte juridike", "percaktime juridike" dhe "sjellje juridike".

Nisur nga fakti se shteti eshte burimi I se drejtes atehere kjo paradigme dominuese i perket shtetit sa here qe ai eshte ne nje situatë te caktuar perpara paradigmes se pare apo paradigmes se dyte.

Do ta krahasoja ne kete menyre paradigmen dominuese duke thene vec te tjerash se ajo i ngjan detit i cili sa here e gjen te mundur te krijojë baticat i merr toke bregut te detit dhe sa here gjen te mundur qe te krijojë zbaticat e tij duke i dhene toke bregut te detit.

Sovrani nepermjete ligjvenesit ka parashikuar ne nenin 11 te Kushtetute<sup>45</sup> se:-

Sistemi ekonomik i Republikes se Shqiperise bazohet ne pronen private e publike, si dhe ne ekonomine e tregut dhe ne lirine e veprimtarise ekonomike .

Prona private dhe publike mbrohet njelloj me ligj .

Kufizime te lirise se veprimtarise ekonomike mund te vendosen vetem me ligj dhe vetem per arsye te rendesishme publike.

Pra ne kete menyre nisur nga shkrimi ligjor qe i eshte bere struktures se Kushtetutes del e qarte se neni 11 nuk eshte parashikuar ne grupin e te drejtave dhe lirive te tjera,por ne pjesen ku parashikohen parimet themelore mbi te cilat mbeshtetet organizimi dhe funksionimi i shtetit.Pra ne kete menyre e thene ndryshe ligjvenesit i ka dhene preference kesaj dispozite qe t'a konsideroje lirine e veprimtarise ekonomike dhe pronen private si parim baze te sistemit ekonomik te Republikes se Shqiperise.

Ne jurisprudencen e saj, Gjykata Kushtetuese e ka interpretuar gjeresisht konceptin e lirise se veprimtarise ekonomike dhe te drejten e prones private te garantuar ne nenin 11 te Kushtetutes.

Kjo detyre taksative e ligjvenesit nder te tjera duhet te gjeje konkretizim ne nxjerrjen e normave te tjera konkrete juridike qe nepermjet te cilave te synohet disiplinimi i veprimtarise se lire ekonomike te personave fizik apo juridik vendas apo te huaj ne perputhje kjo edhe me dispozitat e tjera Kushtetuese te neneve 17-18-41-181<sup>46</sup>ne koherence me parimet themelore te saksionuara ne K.E.D.Nj.

---

<sup>45</sup> Neni 11 Kushtetuta e republikes se shqiperise

<sup>46</sup> Nenet 17-18-41-181 Kushtetuta e Republikes se shqiperise.



Ne rastin konkret ne i referohemi nenit 18 te Kushtetutes ne aspektin e mbrojtjes se barabarte te dy llojeve te pronave, pra te asaj publike dhe te asaj private ku subjektet e ketyre te drejtave si shteti dhe individi kane akses te njejt dhe te barabarte ne lidhje me konstituimin e ketyre te drejtave te sanksionuara si ne K.E.D.Nj<sup>47</sup> dhe ne Kushtetute.

Ne kete kontekst formulimi i nenit 41 te Kushtetutes te con tek kufizimi i te drejtes se pronesise. Gjuha juridike qe perdoret ne kete dispozite eshte se e drejta e pronesise eshte e garantuar, por jo e paprekshme. Jo vetem kaq por kjo e drejte eshte e garantuar nese, ne rast te kufizimit te pronesise private nepermjet shpronесimit apo kufizimit qe barazohet ne shpronесimin, ku shteti merr persiper qe te respektoje kufizimin ne permbushje te nje interesi public, kundrejt nje shperblimi te drejte dhe ne respektim te se drejtes se ankimit te individit, personit fizik apo juridik te cenuar per masen e shperblimit

Ne vijim dua te theksoj se nepermjet nenit 41 te Kushtetutes kerkohet nje shperblim i drejte ne rastin e shpronесimit te prones private, por kjo dispozite nuk ben fjale per kriteret qe mund te zbatohen, per tregun konkret per te vleresuar demin e shkaktuar, apo per ndonje mekanizem te zbatueshem ne kete rast<sup>48</sup>. Per te garantuar kete shprehje juridike pra ate te shperblimit te drejte ligjvenesit nuk e ka vendosur te kete zbatim te drejteperdrejte kjo dispozite por qe ne funksion dhe ne zbatim te saj te kete norma te tjera juridike te cilat te percaktojne ne menyre te detajuar kete shperblim te drejte ne kohet dhe ne vendin e duhur.

Qe te kemi proporcionalitet midis shpronесimit dhe shperblimit te drejt duhet krijuar ekuivalenca midis vleres se shpronесimit me vleren e shperblimit.

---

<sup>47</sup> Konventa Europiane e te drejtave te njeriut

<sup>48</sup> Neni 41 Kushtetuta e Shqiperise

Nisur nga ky si fakt ne nenin 17 te Kushtetutes ligjvenesit ka percaktuar kufizimin e cdo ligji persa i perket kufizimeve qe vendosen mbi te drejatat dhe lirite themelore te individit<sup>49</sup>.

Sidoqofte, per te konsideruar kushtetuese nje nderhyrje te tille ne te drejten e pronesise nuk eshte e mjaftueshme vetem ekzistenca e nje qellimi te ligjshem ne interesin e pergjithshem, por duhet te kete edhe marredhenie te arsyeshme propocionale ndermjet masave te marra dhe synimit qe kerkohet te realizohet me privimin e personit nga prona e tij. Kjo pikpamje kerkon nje shperndarje te drejte te detyrimeve sociale dhe financiare, te cilat nuk mund t'i caktohen nje individi apo nje grupi te vacant si dhe nje komuniteti ne teresi. Pra duhet qe te shqyrtohet hap pas hapi nese ashpersia dhe nevoja e masave te marra per problemet social-ekonomike justifikojne humbjen e pronesise nga personi fizik apo juridik.

Ne kete fryme kushtetuese ligjvenesit ne nenin 181 te Kushtetutes<sup>50</sup> ka vendosur se:-

Kuvendi, brenda dy deri ne tre vjeteve nga hyrja ne fuqi e kesaj Kushtetuese, nxjerre ligje per rregullimin e drejte te ceshtjeve te ndryshme qe lidhen me shpronесimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit te kesaj Kushtetute, duke u udhehequr nga kriteret e nenit 41.

Ligji dhe aktet e tjera normative te miratuara para dates se hyrjes ne fuqi te kesaj Kushtetute dhe qe kane te bejne me shpronесimet dhe konfiskimet do te zbatohen kur nuk vijne ne kundёrshtim me te.

---

<sup>49</sup> Neni 17 Kushtetuta e Shqiperise

<sup>50</sup> Neni 181 Kushtetuta e Shqiperise

Por vlen te permenden krahasime permes ketyre dispozitave Kushtetuese si dhe nenit 1 Protokollit nr.1 te K.E.D.Nj<sup>51</sup> duke konkluduar nepermjet interpretimit te synimit dhe dimensionit qe eshte elaburuar ne kete dispozite te K.E.D.Nj se:-Aseti pasuror apo e drejta e prones do te konsiderohet aset i ekzistues apo pretendime mbi nje aset te tille pasuror, mbi te cilen ka baza te mjaftueshme objektive per te krijuar nje pritshmeri te ligjshme per te pasur nje shfrytezim efektiv dhe pushtet disponimi mbi ate te drejte.

Nese neni 181 i Kushtetutes mbron te drejten dhe pritshmerine e ligjshme te personave per te fituar pronen ,neni 1 i K.E.D.Nj<sup>52</sup> nuk mbron te drejtat dhe pritshmerite e ligjshme te personave per te fituar pronen, por vetem pritshmerine ekzistuese per asetet pasurore qe ekzistojne.

### **Rregullat e jurisprudences se GJ.E. D.Nj mbi pronesine**

Sipas jurisprudences se krijuar nga Gj.E.D.Nj<sup>53</sup> jane evidentuar dhe identifikuar tre rregulat e ndara te kesaj te drejte, sipas te ciles

Rregulli i pare i vendosur ne fjaline e pare te paragrafit te pare te ketij neni afirmon parimin e pergjithshem te gezimit te qete te pasurise per cdo person fizik apo juridik qe eshte titullar i prones.

Rregulli i dyte i pasqyruar ne fjaline e dyte te paragrafit te pare te ketij neni, mbulon shpronasimin ligjor dhe faktik te pronarit mbi pasurine duke parashikuar edhe kushtet se kur nje mase e tille eshte e pergjigjur.

---

<sup>51</sup> Neni 1 Protokollit nr.1 K.E.D.NJ

<sup>52</sup> Neni 1 Konventa Europiane e te Drejtave te Njeriut.

<sup>53</sup> GJ.E.D.Nj

Rregulli i trete, vendosur ne paragrafin e dyte te ketij neni, njeh te drejten e shtetit per te kontrolluar perdorimin e pasurise ne perputhje me interesin e pergjithshem te shtetit dhe shoqerise.

Te tria keto rregulla te ketij neni nuk duhet te konsiderohen te ndara ne kuptimin qe ato jane te palidhura me njera-tjetren. Vlersoj me tej se rregulli i dyte dhe i trete jane te lidhura vecanerisht me te drejten e kujtdo per te gezuar ne menyre te qete pasurine, dhe se masat nen keto rregulla duhet te merren nga shteti duke patur parasysh gjithnje rregullin e pare. Gjithashtu kjo jurisprudence ka pranuar se, ne menyre qe nderhyrjet nga shteti ne te drejten per te gezuar qetesisht pasurine te jene ne perputhje me kete dispozite konventore, duket qe nderhyrja te siguroje nje balance te drejte ndermjet kerkesave dhe nevojës per te mbrojtur interesin publik te shoqerise dhe shtetit dhe nevojës per te mbrojtur te drejtat themelore te individit.

### **Jurisprudenca e Gj.E.D.Nj ne shpronësimin faktik dhe ligjor nga e drejta e prones**

Ne kete kuptim kjo jurisprudence e Gj.E.D.Nj ka konstatuar se shpronësimi faktik dhe ligjor i nje subjekti nga e drejta e prones sipase paragrafit te dyte te nenit 1 te protokollit pa akorduar nje shume ekuivalente te arsyeshme me pronen e marre ndaj subjektit te shpronësuar do te perbje normalisht shkelje te paragrafit te pare te nenit 1. Nese jemi perpara kesaj shkelje jemi perpara kualifikimit te nje nderhyrje joproportionale te shtetit ne te drejten themelore te individit per te gezuar qetesisht pasurine dhe si e tille e pajustificueshme sipas nenit 1. Gjithashtu eshte pranuar njekoheisht se e drejta per t'u kompesuar njekoheisht lidhur me humbjen e pronesise si pasoje e masave shteterore ligjore apo nenligjore nuk nenkupton te drejten per nje

kompesim te reduktuar nga sa eshte vlera e tregut e pronës. Gjithsesi kjo jurisprudencë kurre nuk ka pranuar se pronarit titullar te pronësise mund t'i nihilizohet per shkak dhe arsye te nenit 1 cdo interes pasuror nga politika sociale apo ekonomike qe ndjek shteti per te kontrolluar perdorimin e pronës dhe pasurise ne vecanti.<sup>54</sup>

Duke pasur parasysh sa mesiper mbi legjitimitetin e masave legislative te shtetit sipase optikes juridike dhe kriterëve te se drejtes nderkombetare te Keshillit te Evropës, vleresoj se moskordinimi dhe mosnjohja nga ligji civil material shqiptar i se drejtes subjektive te ishpronarit per t'u kompesuar lidhur me humbjen e pasurise per shkak te vet ligjit civil perben nje zgjidhje ligjore jopropocionale, e cila vendos vetem barre eksesive mbi te drejtat subjektive te humbesit te se drejtes se pronësise dhe vetem privilegjon fituesin e ri te se drejtes se pronësise. Ne vijim theksoj se ligji material civil paraqet mangesi ne rregullimin e tij dhe se duhet qe Gjykata Kushtetuese te nderhyje per shfuqizimin e pjeses qe vjen ne kundërshtim me Kushtetuten dhe te drejten nderkombetare te detyrueshme per Republikën e Shqiperise nen frymen kushtetuese te neneve 5-17-122 te Kushtetutes<sup>55</sup>.

E drjta e ishpronarit per t'u kompesuar, pavaresisht se nuk parashikohet si e drejte subjektive nga ligji material civil, perben dhe permbush te gjitha kushtet dhe kerkesat konventore dhe jurisprudenciale per t'u konsideruar si aset pasuror dhe pritshmeri e ligjshme e ishpronarit qe sapo humbi pasurine e tij si pasoje e vertetimit objektivisht te disa fakteve juridike qe sebashku ligji civil material i kualifikon si nje menyre fitimi apo humbje te se drejtes se pronësise.

---

<sup>54</sup> Neni 1 Protoklli nr1 Konventa per te mbrojtjen e te njeriut.

<sup>55</sup> Nenet 5-17-122 Kushtetuta e Republikës se shqiperise.

E drejta e kompesimit te ishpronarit i ka bazat pikerisht ne pronen qe ai humbi per efekt te veprimit te ligjit dhe kundra vullnetit te shprehur te tij,por nen nje vullnet te prezumuar deri diku nga e drejta pozitive dhe i imponuar ligjerisht si nje situate fakti.Vleresoj se pikerisht per kete arsye, qe ligji i imponon vullnetin ne menyre te njeanshme per humbjen e pronesise, nuk mund te nihilizohet teresisht edhe e drejta e personit fizik apo juridik tashme te ndeshkuar civilisht me humbjen e pronesise dhe me humbjen e cdo te drejte pasurore, sipas parimit se asgje qe ndodhet ne qarkullimin civil nuk humbet por transferohet, transformohet nga nje gjendje ne nje gjendje tjeter.

Per pos kesaj del qartazi edhe njehere se legjislacioni dhe vullneti i shtetit kontrakutes i shprehur nepermjet formave urdheruese dhe dispositive duket sikur ne kete moment mes ketyre paradigmave te larte permendura midis nacionalizimit dhe denacionalizimit te prones dhe te drejtes se pronesise nis kriza juridike midis Konventes dhe Kushtetutes,pasi nderhyrja me ligj e shtetit per te kontrolluar burimet pasurore te kufizuara dhe te shterueshme mbi te drejtat subjective te individve te ndryshem,persona fizik apo juridik qofshin, nuk pershkrohet nga balanca e premtuar nga paragrafi i pare dhe i dyte i nenit 1 te Protokollit nr.1 i K.E.D.Nj<sup>56</sup>.

Mosnjohja e se drejtes se ishpronarit per t'u kompensuar me kundervleften e prones se humbur per shkak te ligjit vendos nje barre ekstremisht eksesive vetem mbi palen humbese, duke mos e kompesuar humbjen e tij te pavullnetshme te pronesise me nje te drejte tjeter pasurore ekuivalente korrektuese apo reabilituese.Pikerisht te kunderten e detyrimit te shtetit qe artikulon jurisprudenca e Gj.E.D.Nj<sup>57</sup>.

---

<sup>56</sup> Neni 1 I Protokollit 1 K.E.D.NJ

<sup>57</sup> GJ.E.NJ.

Ne kete kuptim vleresoj se mjetet juridike te perdorura dhe ato te pa perdorura nga ligjvenesit ne dispozitat e lartpermendura nuk bazojne interesat pasurore te paleve, nuk trajtojne pasurine e subjektve dhe personave njelloj, megjithese legjislacioni Kushtetues mbron interesat e pergjithshme te shtetit dhe te shoqerise.

Ne kete kuader definoj se nihilizmi ekstrem deri ne asgjesisim te cdo pritshmerie te ligjshme te personit qe humbet pasurine nepermjet veprimit te ligjit ne kohe, duke mosnjohur ne te njejten kohe te drejten subjektive te kompesimit ekuivalent me vleren e prones se humbur per shkak te ligjit, perben shkelje te nenit 1 te protokollit nr.1 te K.E.D.Nj.

**Zhvillimet historike te institucionit te nacionalizimit dhe denacionalizimit te proner dhe te drejtes se pronesis.**

Ne dinamiken e zhvillimeve historike te ketij institucioni pra te nacionalizimit dhe denacionalizimit te proner dhe te drejtes se pronesis vem re se sa mesiper i perket dispozitave Kushtetuese dhe konsituimit te lirive dhe te drejtave te njeriut te sanksionuar nepermjet K.E.D.Nj.

Kjo shtate vjen adeguate dhe koherente qe me miratimin e Kushtetutes permes referendumit te dt.22.11.1998.

Por po ti referohemi ndryshimeve Kushtetuese qe nga vitet 1944 e deri ne vitin 1990 do te verejme se shteti i ri qe u krijua pas vitit 1944 kishte premtuar per ndryshime themelore ekonomike e shoqerore te cilat domozdoshmerishte do te preknin dhe pronen

dhe maredheniet me pronesine duke eleminuar keshtu maredheniet e vjetra te subjekteve te ndryshme pra te personave fizike apo juridike vendase apo te huaja<sup>58</sup>.

Duke theksuar se raportet me pronen dhe maredheniet me pronesine kishin filluar te ndryshonin ne kahe positive qe ne krijimin e shtetit Shqiptar ne vitin 1912, por keto maredhenie shfaqnin nevojën e nje ndryshimi te metejshme per vet faktin se tashme ne vinim nga lufta dhe cdo pushtet i dale ne ate kohe pra pas vitit 1944 i perkiste mentalitetit te kohes pra mentalitetit te luftes. Kjo gjendje u transferua tek masat e gjera te popullit dhe ne kete forme mori nje hop si nacionalizimi dhe denacionalizimi i prones dhe te se drejtes se pronesise. Keto veprime u sanksionuan ne kryerjen e reformes agrare te vitit 1945 e cila u realizua nepermjet nje urdherese te posacme qe mban dt.21.06.1945 ku Qeveria e asaj kohe vendosi te krijonte nga nje komitet fshataresh per cdo nenprefektore. Po ashtu nen kete fryme u krijuan edhe ne cdo krahine apo fshat komitete te tilla me funksione te tilla<sup>59</sup>.

Pasi mori te gjitha masat paraprake, shteti ne dt.29.08.1945 shpalli ligjin “mbi reformen agrare”. Mbi bazen e ketij ligji shpronosoheshin detyrimisht te ashtuquajturit ne ate kohe cifligaret, cifliqet e shtetit, pronat bujqesore private dhe te enteve private dhe fetare, tokat e te instaluarve nga reforma agrare e shtetit monarkist, ulla te ulinjtë e konfiskuar, vreshtat dhe pemishtet e konfiskuara, godinat bujqesore, pendet e punes dhe veglat e bujqesore qe ndodheshin ne posejdim te fshatareve ne tokat qe shpronosoheshin.

---

<sup>58</sup> Kushtetuta e shqiperise (1944-1990)

<sup>59</sup> Ligji mbi Reformen Agrare



Ky ligj perjashtonte nga shpronesimi i detyruar, ne masen e caktuar nje kategori te caktuar pronash bujqesore private e fetare, po ashtu prona bujqesore private te personave qe nukereshin me bujqesi etj.

Pronat qe perjashtoheshin nga shpronesimi i detyrueshem ne masen qe ju caktonte ligji, por qe kishin toka me siperfaqe me te madhe nga ajo qe mbetej pashpronesuar, detyroheshin qe brenda nje muaji pas shpalljes se ligjit mbi reformen agrare, te deklaroinin para organeve te pushtetit popullor pronat qe kishin dhe pjesen qe ju takonte te mbanin<sup>60</sup>.

Nisur nga ku si fakt ju ishte lene ne menyre deklarative pershkak se kujtdo qe vepronte ne kundërshtim me kete kerkese te ligjit, shpronesohej e gjithë toka.

Gjithashtu ligji ndaloi qe te tjetërsohej dhe te hipotekohej ose te jepeshin me qira pronat private te pashpronesuara. nje gje e tille lejohej vetem me vendim te komitetit ekzekutiv te nenprefektures dhe me miratim te zyres se Reformes Agrare.

Ne te gjithë kete shtrirje qe pati ky ligj vem re se jemi perpara nje nacionalizimi po thuajse ekstrem, apo ne kufi te ekstremitetit te prones dhe te se drejtes se pronesise, ku shteti nepermjete forces se ligjit beri te mundur nje reforme te tille e cila preku cdo person si dhe cdo prone te tyre duke e bere dhe kthyer ate shteterore<sup>61</sup>.

Nga kjo pikpamje del me se e qarte se jo vetem qe burimi i se drejtes eshte shteti, por kjo natyre shtetesh ben ate qe te mos respektohet prona dhe te denatyroje te drejten e pronesise.

---

<sup>60</sup> Ligji mbi Reformen Agrare

<sup>61</sup> Ligji mbi Reformen Agrare

Por kjo reforme nuk mbaron ketu pra ne afersi te ketij ekstremiteti te nacionalizimit, por duhet qe te kalonte tashme ne ekstremet e tjera te denacionalizimit dhe me konkretisht ne dispozitat e ketij ligji ligjvenesit kishte percaktuar se nga tokat e shpronesuara perfitonin bujqit qe ndodheshin ne keto toka, bujqit qe do te shpernguleshin nga zonat e demtuara nga lufta dhe nga ato ku mungonte toka, bujqit qe nuk kishin toke ose nuk kishin toke te mjaftueshme, ata qe kishin mbaruar nje shkolle bujqesore dhe qe ishin ne gjendje qe ta punonin vete token, si dhe ata qe merreshin me profesionin e kopshtarise<sup>62</sup>.

Preferoheshin ne ndarjen e tokave familjaret e deshmoreve te luftes dhe familjet e atyre qe kishin qene ne radhet e ushtrise Nacionalclirimitare.

Po te shikojme se kush subjekte begatohen nga kjo reforme dhe cilat subjekte humbasin pronen dhe te drejten e pronesise do te verejme se kemi te bejme me shkaqe sociale, ekonomike dhe politike te tipizuara pasi prona ju merrej personave qe kane qene kunder sistemit dhe ju eshte dhene peronave qe kane qene pro sistemit.

Kuptimi i natyres juridike te shpronesimit te tokes sipas ligjit “Mbi Reformen Agrare” ishte teper i dukshem per vet qellimin qe ka pasur ligjvenesit ne miratimin e tij.

Ne literaturen tone juridike eshte shfaqur mendimi se ligjvenesit ne hartimin e ligjit mbi reformen agrare ka lejuar pervec te tjerash nje gabim tekniko – ligjor ne ceshtjen e shpronesimit te tokes.

Ne nenin 1 te Ligjit<sup>63</sup> thuhet se:- Me shpalljen e ketij ligji shpronesohen detyrimisht dhe u ndahen fshatareve, nenshtetas shqiptare qe nuk kane toka te tyre ose qe nuk i

---

<sup>62</sup> Ligji mbi Reformen Agrare

<sup>63</sup> Neni 1 I Ligjit mbi reformes Agrare viti 1945

mjaftone toka. Kjo pikpamje nuk eshte e drejte. Ligjvenesit i ka percaktuar termat perkatese dhe vecanerisht termin e shpronесimit te tokes ne menyre te sakte.

Po ne kete dispozite pra te nenit 1 te ligjit te larte permendur eshte percaktuar se toka shpronесohet duke percaktuar detyrimisht se cilat toka duhet te shpronесohen nga njera ane dhe ndarjen e ketyre tokave fshatareве qe s'kane toke te tyre, ose nuk mjafton toka, nga ana tjetere jane dy momente juridike qe nuk perputhen me kohen.

Termi shpronесohen detyrimisht tokat qe permenden ne kete ligj ka kuptimin e shpronесimit te menjehershem d.m.th ne daten e hyrjes ne fuqi te ligjit ,subjektet e permendura nuk jane me pronare te tokave te tyre. Ndersa kalimin e pronesis se tokes se fshatareве ose te subjekteve te tjera, ligji e kushtezon me nje seri veprimesh dhe, ne menyre te vecante per fshataret, me leshimin e titullit te zoterimit te ashtuquajtur tapise nga organi kompetent shtetere dhe regjistrimit te tokes ne zyren e kadaster.

### **Mosperputhja e shpronесimit dhe kalimit te pronesis**

Mosperputhja e ketyre dy momenteve: a- shpronесimit dhe b- kalimit te pronesis se tokes fshatareве, percaktohet nga natyra e vecante e ketyre insituteve. Tokat e shpronесuara qe percakton ligji kaluan ne fondin shtetere te tokes dhe caktoheshin per realizimin e qellimeve te Reformes Agrare, fond i cili administrohej nga organet shtetere<sup>64</sup>. Prandaj pronaret e shpronесuar e humben pronesine e tyre qe ne shpalljen e ligjit.

Gjithe permbajtja dhe fryma e ligjit mbi Reformen Agrare nuk le asnje shteg per te mos pranuar shpronесimin e menjehershem te tokes. Ligji duke qene konseguent ne kete drejtim pervec te tjerave, shtriu ndalimin e tjetersimit ne te gjitha tokat private te pa

---

<sup>64</sup> Ligji mbi reformen Agrare

shpronuesuara dhe sanksioni se me hyrjen ne fuqi te ligjit, ndalohej krejtesisht tjetersimi me cdo titull, hipotekimi ose leshimi me qira i tokave edhe sikur te ishin nga ato qe kishin mbetur te pashpronuesuara.

Ne zbatim te Reformes Agrare ligjvenesit miratoi nje seri aktesh normative te tjera duke kerijuar vec te tjerash fondin shteteror te tokes per qellime te caktuara te reformes dhe ne te njejten kohe edhe ne shtetezimin e pjesshem te tokes qe ne prespektive erdhi duke u rritur dhe qe se bashku me kolektivizimin e pjeses tjeter te tokes shpuri ne shtetezimin e plote te saj.

Ligji vec sa mesiper shtetezoi te gjitha pyjet, kullotat, mocalet, zhurishtet dhe gjolet private, me perjashtim te atyre qe perjashtoheshin ne siperfaqen e pergjithshme te pronave qe meten te pashpronuesuara. Pyjet dhe kullotat kolektive te katundeve te ndryshme, cifligut ose ten je grupi katundesh, shfrytezoheshin nga fshataret sipase zakonit te vendit. Pavaresisht nxjerjes se ketij ligji persa i perket kullotave nuk ju dha nje zgjidhje perfundimtare pasi pronareve te tyre ju ishin lene ende pozita mbi token. Me pas ligjvenesit miratoi nje shtojce te ligjit kryesor dhe keshtu i dha fund kesaj reforme duke bere shtetezimin e plote te tyre<sup>65</sup>.

Ligji mbi Reformen Agrare, ne teresi, pranoi ne parim shpronесimin e pronareve pa shperblim dhe vetem ne disa raste te vecanta te percaktuara me ligj, pranonte nje shperblim simbolik me te holla qe nuk rendonte mbi fshataret.

Ne kete faze per te ruajtur kete familje te re bujqesore ligjvenesit ndaloi pjestimin e tokes permes bashkepronareve te kesaj familje bujqesore.

---

<sup>65</sup> Ligji mbi reformen Agrare

Nje vecori tjeter tregohet ne kete ligj ku ligjvenes i njihte te drejten shtetit qe te kryente shtetezimin nepermjet shpronesimit ose kembimit te pasurive private qe ndodheshin brenda ose afer rrethit te tokave apo te cifliqeve te shpronesuara, kur e kerkonin interesat e bujqesise. Jo vetem kaq ligjvenes i rezervonte te drejten shtetit te caktonte ne tokat qe shpronesonte nje siperfaqe te mjaftueshme per te krijuar nepermjet saj nje ndermarje shteterore bujqesore<sup>66</sup>.

Ne kete periudhe vazhdon nacionalizimi i prones dhe te drejtes se pronesise ne ekstremet e saj duke bere keshtu rrugetime te pa kthyeshme per te realizuar ate qe ligjvenes te tille te cojne ne fund qellimin kryesor per te shpronesuar keto dhe gjithcka. Pikerisht per te realizuar kete u miratua ligji nr.175<sup>67</sup> dt.26.11.1945 ku u shoqeruan nje seri dispozitash te ligjit mbi Reformen Agrare, duke shtrire shpronesimin edhe ne pronat qe ndodheshin ne periferi te qyteteve. Po ashtu nepermjet ketij ligji u kufizua prona ne familjen bujqesore duke i hequr cdo kurore nje siperfaqe te caktuar nga 3 ha ne 2.5 ha.

Pra me hyrjen ne fuqi te ketij ligji perfundonte dhe faza e pare e shpronesimeve per ti hapur rruge miratimit te ligjit nr.200 ne dt.04.02.1946<sup>68</sup> nepermjet te cilit shpronesoheshin edhe tokat e atyre pronareve qe nuk e punonin ose nuk e administronin vete, duke i lene vetem pjesen qe punonin vete. Po me kete ligj u ul norma persa i perket kullotave dhe krereve te bagetise.

Me pas statuti qe u miratua nga Asambleja Kushtetuese ne 14.03.1946 shpalli ne pronesi eskuzive te shtetit , krahas minierave,ujrave etj si dhe pyjet dhe kullotat. Pra ne

---

<sup>66</sup> Ligji mbi reformen Agrare

<sup>67</sup> Ligji 175 mbi Reformen Agrare viti 1945

<sup>68</sup> Ligji 200 mbi Reformen Agrare viti 1946

kete menyre dispozitat e ligjit per Reformen Agrare qe rregullonin ceshtjen e pyjeve dhe te kullotave u shfuqizuan.

Ne vijim te objektit dhe qellimit qe shteti i asaj kohe kishte per nacionalizimin e prones dhe te drejtes se pronesise pervec ketyre dispozitave nepermjet te cilave shpronesoi gjithcka, nuk ndali ketu por miratoi dhe dekret ligjin “Mbi denoncimin e tokave te tjetersuara” pas dt.19.01.1945, pronaret u detyruan qe tokat e tjetersuara me cdo titull ti denonconin ne zyrat e Reformes Agrare ose ne seksionet e bujqesise. Ata qe nuk zbatonin kete kerkese te ligjit gjykoheshin si sabotator te pushtetit. Por ne baze te ketij dekreti ndalohej krejtesisht tjetersimi me cdo titull, hiptekimi ose leshimi me qira i tokave edhe sikur ato te ishin nga ato qe mbeteshin te shpronesuara, ne kete menyre shfuqizohej neni 7 i ligjit per Reformen Agrare<sup>69</sup>. Po me ligjin 253 dt.27.05.1946 u bene disa ndryshime. Ne baze te ketij ligji shpronesoheshin tokat bujqesore, vreshtat, ullishtet, pemishtet, bashke me godinat e pajisjet e tyre te zoterueshme prej privateve qe nuk i punonin vete.

Pra i gjithë ky legjislacion si dhe ndryshimet dhe shfuqizimet e tyre ne dinamike kane qene per zgjerimin e reformes agrare ne funksion te qenrimeve politike te shtetit, pra sa here kemi pasur gjendje te tilla juridike kemi pasur te bejme me zgjerimin e nacionalizimit te prones dhe te se drejtes se pronesise.

Pas perfundimit te Reformes Agrare u moren nje sere masash me karakter juridik per te cuar deri ne fund rezultatet e saj. Ne fillim te vitit 1947 prane Komiteteve Ekzekutive te Prefekturave, ne baze te dekretit te ligjit<sup>70</sup> nr.403 dt.07.02.1947 u krijuan komisionet e posacme per shqyrtimin e veprimeve te Reformes Agrare, te cilat kishin

---

<sup>69</sup> Neni 7 i Ligjit mbi Reformen Agrare viti 1946

<sup>70</sup> Neni 403 i Ligjit mbi Reformen Agrare viti 1947

per detyre te zbulonin te gjitha te metat qe verenin me rastin e zbatimit te kesaj reforme dhe te procedonin te gjithe ata persona qe kishin vepruar ne kundersizim me ligjin.

Ne vijim te kesaje reforme te thelle ne vitin 1955 jane miratuar nje seri ligjesh dhe konkretisht Kodi Civil <sup>71</sup>(pjesa e pergjithshme), dekreti mbi pronesine dhe ai mbi sistemin agrar te tokave dhe regjistrimit te tyre etj.

Ligji mbi pronesine percaktoi llojet, format, objektet, subjektet, kufizimet, fitimin dhe humbjen e proneses, mjetet e mbrojtjes se saj. Ky ishte nje ligj i plote lidhur me rregullimin juridik te prones, ligj i cili do te perbente nje nga pjeset e Kodit Civil.

Ne baze te dekretit mbi pronesine, pronesia e tokes mund te ishte shteterore, kooperativiste, vetiake dhe private. Pronesia shteterore lindi menjehere pas vendosjes se shtetit monist. Ajo ka ardhur vazhdimisht duke u zgjeruar. Toka shteterore nuk mund te tjetersohet me perjashtim te asaj qe jepet per ndertim. Toka bujqesore mund t'u jepej ne pronesi vetem atyre qe punonin dhe gjithmone pa shperblim. Toka mund te kalonte pa shperblim nga nje organ shteteror ne tjetrin, ne pronesine e nje organizate kooperativiste ose shteterore<sup>72</sup>.

Duke percaktuar se toka mund te jete objekt edhe ne pronesine e kooperativave, dekreti ndaloi tjetersimin dhe dhenien me qira te saj dhe lejonte vetem shkembimin ne kushtet e parashikuara nga ligji, si dhe tjetersimin e tokes vetem per ndertimin. Toka ne pronesi te kooperativave nuk mund te sekuestrohej per pagimin e borxheve te kooperativave ose te organizatave. Ky qendrim i ligjvenesit perbente nje risi persa i perket menyrove te shtetezimit permes sekuestrimit. Pra kemi te bejme me nje marsh pas ne praktiken e krijuar persa i perket nacionalizimit te prones dhe te drejtes se

---

<sup>71</sup> Kodi civil (pjesa e pergjithshme)

<sup>72</sup> Kodi civil (pjesa e pergjithshme)

pronesise. Pra ky veprim eshte nje veprim i cili i pakeson shtetit kreditet e tij ne lidhje me shpronisimet duke ia kaluar ne favor ketyre subjekteve pra kooperativave edhe pse ato mund te ishin ne borxh financiar.

Dekreti mbi pronesine pervec pronesise shteterore dhe kooperativiste, rregullonte edhe pronen vetjake dhe ate private. Qureshin prone vetjake sipase dekretit te ardhurat dhe kursimet nga puna, ndertesat per banim, sendet e nevojshme per ekonomine shtepiake dhe cdo send tjetet qe sherbente per perdorim personal ose familjar<sup>73</sup>.

Ne dekret ishte percaktuar dhe se ceshte pronesia private duke definuar se:

-Jane prone private pasurite qe perdoren si mjete prodhimi ose si mallra. Tokat bujqesore qe ishin prone private, sipas dekretit, nuk mund te tjetersoheshin, as te shiteshin ne ankand per pagimin e borxhit as te jepeshin me qira, keto toka i kalonin shtetit kur tjetersoheshin, jepeshin me qira ose nuk punoheshin per dy vjet.

Dispozitat e dekretit lidhur me ndalimin e cdo lloj tjetersimi te tokes bujqesore ,qofte kjo shteterore ,kooperativiste,apo private,ishin ne permbajtje te qarta dhe pamedyshje. Ne Shqiperi, ndryshe sa ndodhi ne vendet e Lindjes, toka bujqesore u perjashtua qysh ne ligjet e para nga qarkullimi civil<sup>74</sup>.

Dekreti, duke sanksionuar kater forma pronesie, nenkuptonte se toka bujqesore mund te ishte edhe vetjake, por praktikisht ajo nuk mund te ishte e tille. Kjo permbajtje del nga perkufizimi qe vete dekreti i ka bere prones personale, te cilen e perbenin te ardhurat nga kursimet , nga puna, ndertesat per banim, sendet e nevojshme per ekonomine bujqesore dhe cdo send qe sherben per perdorim personal ose familjar. Per

---

<sup>73</sup> Kodi civil (pjesa e pergjitheshme)

<sup>74</sup> Kodi civil (pjesa e pergjitheshme)



token si subjekt personal, nuk permendet fare pasi ajo mund te ishte e till vetem ne qytet.

Gjithe legjislacioni i larte permendur i krijuar dhe zbatuar ne kete periudhe kishte per detyre qe nepermjet autoriteteve shterore te formezonte reformat me karakter shpronues dhe shtrengues duke i hapur rruge keshtu nacionalizimit ekstrem te prones dhe te se drejtes se pronesise.

Me kete definicion dhe ne keto kushte social- ekonomike, politike e juridike erdhi <sup>75</sup>shoqeria Shqiptare dhe shteti Shqiptar ne vitin 1976, kohe kur u hodhen baza te reja social ekonomike dhe politiko juridike. Pra i gjithe ky legjislacion ndihmoi shtetin qe te krijonte diktaturen e proletariatit dhe ne kete menyre u miratua Kushtetuta e re e vitit 1976, nepermjet te ciles u shtetezua gjithcka dhe perfundimisht ju dha fund prones private duke bere keshtu nacionalizimin perfundimtar te te gjithe prones dhe te drejtes se pronesise.

Zbatimi dhe ekzekutimi i kesaj Kushtetute solli nje situatë ekstra, ekstra large (XXL) tashme te ekstremizuar, veten nga njera ane, pra nga ana e pasurise shteterore dhe asaj publike ku pronar i vetem ishte Shteti i diktatures se proletariatit.

### **Marrdhenia me pronen dhe pronesine pas viteve 1990**

Me dryshimet demokratike te vitit 1990 ligjvenesit miratoi paketën Kushtetuese nepermjet te ciles u shfuqizua Kushtetuta e vitit 1976 dhe ju hap rruga rreformave te reja mbi pronen dhe te drejtes se pronesise.

---

<sup>75</sup> Kushtetuta e shqiperise 1976

Ne kete kuader ligjvenesit nepermjet ligjeve te reja i dha mundesi shoqerise te merte nga prona shtetere.Pra ne kete rast kemi te bejme nje klime te re social ekonomike, politiko juridike e cila u misherua ne ligjet e para qe Parlamenti miratoi.

Konkretisht reforma ne kete drejtim nga ana e ligjvenesit filloi me nxjerjen e ligjit nr.7501 dt.10.08.1991”Per Token”, nepermjet te cilit sheti ju jepte toke ne poronesi dhe ne perdoreim ish punonjesve te kooperativave bujqesore dhe ish punonjesve te Ndermarjeve Bujqesore.

Pra nepermjete fillimit te kesaje reforme kemi te bejme me fillimin e denacionalizimit te prones dhe te se drejtes se pronesise duke kaluar keshtu nga nje prone teresisht shtetere ne nje prone tashme edhe private, nga nje subjekt i se drejtes qe ishte vetem shteti, tashme ne kalimin edhe te prones nen subjektet e tjera fizike etj.

Nen frymen e denacionalizimit te prones dhe te se drejtes se pronesise pas miratimit te ligjit nr.7501<sup>76</sup>, u miratua dhe ligji 7512<sup>77</sup> dispozitat e te cilit konsistonin ne reformen e privatizimit te ndermarejeve shtetere duke i hapur rruge keshtu ndermarjeve private dhe iniciatives se lire.

Kjo reforme nuk ndali ketu por ligjvenesit miratoi dhe ligjin nr.7652<sup>78</sup> “Per privatizimin e banesave shtetere” nepermjet te cilit personat fizik te cilet kishin qene me pare qiramares tek shteti per keto banesa beheshin pronare te tyre.

Nje hap tjeter i rendesishem eshte dhe miratimi i ligjit 7698 dt.15.04.1993”Per K.K.P”<sup>79</sup> pasi nepermjete dispozitave te ketij ligji ish pronareve apo trashegimtareve te

---

<sup>76</sup> Ligji per token 7501

<sup>77</sup> Ligji 7512 per privatizimin e ndermarjeve shtetere

<sup>78</sup> Ligji 7635 per privatizimin e banesave shtetere

<sup>79</sup> Ligji 7698 dt 15.4.1993 per K.K.P

tyre te cileve ju ishte marre prona private nepermjete shtetezimit apo sekuestrimit dhe menyrove te tjera nga shteti, ju kthehej kjo prone dhe te drejtat reale mbi te sipase akteve nenligjore te dala per zbatimin e ketij ligji.

Me pas me miratimin e Kodit Civil ne vitin 1994 u shfuqizuan dhe Kodi Civil i vjeter dhe gjithë legjislacioni civil qe i perkiste perjudhes nga viti 1945-1994 dhe qe kishte te bente me pronen dhe me marredheniet e pronesise deri ne ate kohe.

Pra u krijua tashme nje rend i ri juridik me nje legjislacion demokrtatik, pra ne fund te fundit u demokratizua i gjithë legjislacioni dhe aq me teper ai civil.

Nepermjet kesaj fryme te re qe u krijua jemi perpara denacionalizimit te prones dhe te se drejtes se pronesise. Ky denacionalizim u be perkrah nacionalizimit dhe ne kete kohe perparesi kishte prona private dhe e drejta private dhe jo prona shteterore dhe ajo publike si dhe e drejta publike. Raporti mes tyre ishte se mazhorancen e kesaj te drejte e kishte prona private, pra kesisoj edhe denacionalizimi ishte ne mazhorance karshi nacionalizimit.

Dhe pikerisht kjo situatë ekzistoi e pranueshme deri ne vitin 1998 kur u miratua Kushtetuta e re. Ne kete kushtetute u percaktua perfundimisht se ligji eshte i barabarte per te gjithë dhe se te gjithë jane te barabarte perpara ligjit, keshtu qe te dyja pronat si ajo publike dhe ajo private gezonin te njejten mbrojtje nga ligji pasi ne Kushtetute tashme ishin sanksionuar edhe lirite dhe te drejtat e njeriut.

**Nacionalizimi dhe denacionalizimi I prones dhe te drejtes se pronesise gjate rrugetimit ne formimin e shtetit te se drejtes**

Te ardhur enkas ne kete paradigme juridike te kohes na eshte dashur qe te rrugetojme gjate ne formimin e shtetit te se dretes. Nese do te kthehemi ne nje restropektive te larget perseri gjendet lidhja kauzale pra lidhja shkakesore, shkak pasoje, duke na dhene mundesi te kuptojme se nacionalizimi dhe denacionalizimi i prones dhe te se drejtes se pronesise ka ekzistuar, ekziston dhe do te ekzistojte ne te gjitha kohrat. Nderkohe ne rrjedhen e viteve struktura e shoqerise se bashkesise primitive do te shthurej duke ia lene vendin nje rendi te ri shoqeror ku familja patriarkale kishte filluar te krijonte pronat e saj nga pronat ne pergjithesi te fisit, pra gradualisht linden marredheniet skllavopronare dhe e drejta skllavopronare e cila sanksionoi pronesine e skllavopronareve mbi mjetet e prodhimit dhe ne rradhe te pare pronesine mbi token si mjetin kryesor. Ne kete periudhe ne vendin tone ishim perpara dy te drejtave asaj skllavopronare dhe te drejtes zakonore sepse ekzistonin si prona fisnore ne te drejten zakonore si dhe prona e familjes patriarkale sepse edhe shoqeria ishte e organizuar ne kete menyre ku ne zona te caktuara kemi organizimin permes fisit, pra te nje familje me te zgjeruar dhe ne zona te tjera kemi organizimin permes familjes patriarkale, pra ate te nje familjeje me te kufizuar. Keshtu nisur nga fakti se shoqeria ishte e organizuar ne kete menyre, po ashtu edhe prona dhe e drejta e pronesise do te kishte kete zhvillim. Dale nga dale kemi te bejme me pas me shthurjen e rendit fisnor ne shume krahina te vendit dhe kryesisht ne zonat e veriut ku kjo gjendje i`a la vendin nje situatë kalimtare per te kaluar ne feudalizem i cili si rend shoqeror kishte karakteristikat e tij dhe vecanerisht ato shpreheshin edhe persa i perket vendit qe zinte prona dhe e drejta e pronesise ne menyre te posacme.

Me sundimin romak qe u vendos me pas ne shekullin e trete ne vendin tone perseri kishim dy te drejta ate zakonore dhe te drejten romake pervet faktin se sundimi romak

nuk u shtri ne te gjithë teritorin e vendit tone dhe se nje pjese e mire e veriut u la jashte kesaj influence dhe pikerisht ne keto zona vepronte e drejta zakonore. Pra nje pjese e marredhenieve shoqerore rregulloheshin permes te drejtes romake dhe nje pjese tjeter e marredhenieve shoqerore rregulloheshin sipase te drejtes zakonore.

Perandoria Romake <sup>80</sup>ndermori nje sere reformash ne fushen e marredhenieve agrare duke vendosur keshtu marredhenie te reja pronesore ne lidhje me token. Toka ne perandorine Romake paraqitej ne dy kategori themelore dhe konkretisht ne toke domenika, ku punohej drejtperdrejt nen regjimin e feudalit, si dhe ne toke colonica qe u ndahej fshatareve per te punuar me detyrime te ndryshme qe kapercenin keto marredhenie.

Pra pervec sundimit faktik te romakeve kemi dhe sundimin juridik te se drejtes romake dhe konkretisht mbi organizimin dhe funksionimin e shoqerise si dhe prones dhe marredhenieve te pronesise duke u bere njekohesiht dhe nacionalizimi i se drejtes romake si dhe ne minorance denacionalizimi i kesaj se drejte, e shprehur kjo ne reformat e Perandorise Romake persa i perket prones dhe te drejtes se pronesise.

Pas ndarjes se Perandorise Romake, vendi yne mbeti nen sundimin Bizantin. Nen kete sundim struktura e shoqerise u ndertua mbi parime te reja tashme jo ne ato romake por ne ato bizante. Dhe ne kete rast konflikti kryesor nuk ishte e te drejtes bizantine me te drejten zakonore, por mes te drejtes bizantine dhe asaj romake. Pervet kete fakt Perandoria Bizante permes sundimit te saj te gjate mundi te transformonte pjeserisht te drejten romake dhe vecanerisht ne strukturen ekonomike u vendosen parime te reja dhe sidomos ne rolin e rendesishem te fshataresise se lire dhe sistemit te pronesise. Kjo u pa

---

<sup>80</sup> E drejta agrare e SHqiperise .(Paskal Haxhi)Tirane 2008

ne te gjithë veprimtarine legislative dhe ne veprimtari te tjera juridike ku u perpoqen per rregullimin e marredhenieve agrare mbi token dhe sidomos kjo reforme u sanksionua nga fundi i shekullit te shtate ne Ligjin e quajtur Agrar qe i atribuosh Justinianit<sup>81</sup>.

Ky ligj ishte nje pasqyrim i pergjithshem i kushteve te fshataresiuse ne te gjitha territoret e sunduara nga perandoria bizante. Ai ishte nje permbledhje dispozitash qe rregullonin marredhenien midis fshatareve te vegjel qe kishin pronat e tyre te ngarkuara me detyrime ndaj shtetit. Jo vetem kaq por ne kete ligj ishin te sanksionuara dhe rregullat mbi bashkepronesine e tokes, parate prones se perbashket e cila kishte nje pozite mazhoritare, pra sunduese, por mepas vendin e saje e zuri prona individuale.

Me reformat e mepasme ne periudhen e bizantit u vendos nje regjim i forte juridik lidhur me shitblerjen e tokes ku njihej me ligj insituti i parapelqimit ne ceshtjet e shitblerjes. Ne kete moment pra ka lindur ajo qe ne sot e quajme te drejte te parablerjes ne te kundert veprimi juridik eshte i pavlefshem nese nuk respektohet kjo dispozite<sup>82</sup>. Ky institut pra i parablerjes ishte i njohur ne vendin tone edhe perpara bizantit .Po ashtu perandoria romake shfuqizoi me ligj te drejten e parablerjes mbi token.

Pra sipas ketyre ligjeve te shkruara pra si atij romak dhe atij bizant del e qarte se insituti i parablerjes nuk ka qene nje institut as i te drejtes romake dhe as i te drejtes se bizantit, por insitut i se drejtes zakonore shqiptare te cilen me vone e njohu edhe e drejta kanunore permes kanuneve shqiptare.

Ndersa ne kete perjudhe vlen per tu permendur se insitut me rendesi historike i se drejtes bizante qe sherbeu si nje nga rruget per formimin e sistemit feudal bizantin ka

---

<sup>81</sup> E drejta agrare e shqiperise (Paskal Haxhi)Tirane 2008

<sup>82</sup> E drejta agrare e shqiperise (Paskal Haxhi)Tirane 2008

qene emfiteoza i cili eshte nje insitut qe e ka zanafillen ne qiramarjen e pronave agrare publike qe fillimisht lidheshin per nje afat prej 5 vitesh<sup>83</sup>.Me vone shteti i asaj kohe dhe pronaret e medhenj, per te siguruar shfrytezimin e vazhdueshem te tokave dhe per te mos patur siperfaqe tokash te papunuara, perserisnin kontraten duke u shnderruar keshtu ne marredhenie te perhershme juridike.Nga natyra e saj juridike vlen te permendet se kjo kontrate nuk ishte as shitje as qiramarje, por e drejte tjetersuese dhe e trashegueshme, ne baze te se ciles qiramarresi kishte te drejten e ushtrimit te plote te attributeve te pronarit dhe merrte persiper te gjitha barrat dhe rreziqet, ndersa pronari gezonte vetem perfitimet.

Ne te gjithë kete aspekt gjithperfires gjejme si nga pikpamja formale dhe ajo materiale element thelbesor te nacionalizimit dhe denacionalizimit te prones dhe te se drejtes se pronesise te asaj bizante ne vecanti.

Legjislacioni bizant i kesaj kohe, me ndryshimet e bera ne ligjin agrar permes reformave favorizoi pronen e madhe private qe ishte formuar ne gjirin e bashkesise, po ashtu ky legjislacion i dha mundesi dhe krijoje klimen juridike te formimit te Prionarit feudal mbi proniet ku bashkejetonin dhjetra apo qindra familje fshatare .Ne rastet kur prionari feudal mirte zoterimin e nje prone te tille vilte edhe te ardhurat nga kjo prone.Pra jemi tashme ne hapat e par ate lindjes se feudalizmit ne vendin tone sipase ketyre sjelljeve sociale,ekonomike dhe politio juridike te shoqerise dhe konkretisht ne sjelljen e tipizuar mbi pronen dhe maredheniet me pronesine.

Marredheniet feudale ne shekullin e 14 te ndonese u zhvilluan ne thellesi e ne gjeresi nuk preken ne te njejten kohe dhe ne te njejten shkalle te gjitha krahinat e vendit

---

<sup>83</sup> E drejta agrare ne Shqiperi (Paskal Haxhi)Tirane 2008

tone. Kjo lloje prekje u pa dhe u konstatua vetem ne krahinat bregdetare dhe ne vendet e ulta si dhe ne luginat e brendeshme pasi marredheniet feudale u bene te sundueshme.

Ashtu si perandoria romake dhe ajo bizante qe gjate sundimit te saj kerkuan qe te zbatonin legjislacionin e tyre, po ashtu vendi yne edhe nen sundimin e perandorise Osmane i`u neneshtua ne mazhorance te vendit zbatimit te legjislacionit ottoman i cili ishte i bazuar kryesisht ne pronesine feudale ushtarake mbi token.

Forma kryesore juridike qe u perdor per rregullimin e marredhenieve agrare ishin kanunamete qe i kishin burimet tek Kurani dhe tek kodet e sulltanit<sup>84</sup>. Nisur nga sa mesiper kemi te bejme ne thonjeza me Kuranin ne formen e nje kushtetute nga i cili rjdhin ligjet e tjera, si dhe sistemi i zgjedhur eshte ne kutpimin e atije presidencial ne thonjeza pasi kemi te bejme me pushtetin e sulltanit i cili e ushtronte kete pushtet permes kodeve te tija, pra kemi nje system te centralizuar tek kjo figure shteterore.

Ne keto kanunamete per vendin tone sanksiononin gjendjen e prones dhe te pronesise mbi token, poziten feudale te spahijeve dhe te pronareve te tokave, marredhenien e spahijeve dhe rajave, detyrimet e feudaleve dhe detyrimet e tjera feudale te popullsise se nenshtuar duke pasur si qellim mbrojtjen e prones feudale ushtarake mbi token.

Nje situatë e tille persa i perket regjimit ushtrak mbi token e gjejme vec kesaje periudhe ne vendin tone edhe ne periudhat e sundimit romak dhe atij bizant pervet faktit dhe qellimit pushtues dhe sundimtar qe kishin keto tri perandori si ajo romake, ajo bizante dhe kjo e fundit osmane. Nisur nga sa mesiper jemi perpara te njejtave fakte por ne kohra te ndryshme dhe ne gjendje te ndryshme shoqerore te zhvillimit te vendit tone. Ne kete aspekt gjendemi ne tri bashkesi te ndryshme juridike por qe priten mes

---

<sup>84</sup> E drejta Agrare e Shqiperise (Paskal Haxhi) Tirane 2008



njera tjetres dhe qe krijojne nje bashkesi te re me elemente te perbashket te cilat per kete fakt u asimiluan me shume dhe me mire nga popullsia jone, aq me teper persa i perket prones ushtarake mbi token.

Por ka nje ndryshim persa i perket zhvillimit juridik te prones dhe te marredhenieve mbi pronesine sepse nese nen sundimin romak normat juridike te se drejtes romake krijuan nje pozitivitet drejt denacionalizimit te prones dhe te drejtes se pronesise, po ashtu nen sundimin bizant kemi nje zgjerim te kesaj te drejte ne drejtim te liberalizimit per te krijuar sa me shume prone dhe marredhenie me pronesine private<sup>85</sup>. Ndersa nen sundimin e perandorise osamane kemi te kunderten pasi ajo kerkonte shtetezimin e te gjitha tokave duke i shpallur ato prone shteterore nepermjete regjistrimit te tokave ne formen kadastrale.

E drejta e feudaleve mbi token qe jepej nga sulltani nuk ishte e drejte pronesie, mbasi shteti e ruante te derejten e pronesise, ndersa feudali ushtronte atributet e nevojshme per shfrytezimin e timarit si prone feudale, por gjithmone me autorizim te shtetit dhe brenda kufijve te percaktuara ne kanunet perkatese.

Feudalet ose funksionaret si administrator, kishin te drejte t'ua jepnin token me tapi fshatareve per t'i perdorur e shfrytezuat si dhe t'ua hiqnin ketyre kur nuk plotesonin detyrimet ose kerkesat e tjera sic ishin punimi i tokes dhe moslargimit prej saj etj.

Gjithcka sa mesiper e ka bazueshmerine tek kodet e sulltanit pasi ai kishte te drejte qe tu jepte feudaleve ushtarak dhe funksionareve dhe funksionareve te administrates civile, fetare dhe gjyqesore me kusht qe keta te fundit te paguanin taksat dhe te merrnin pjese ne luften kunder njerezve te tyre.

---

<sup>85</sup> E drejta agrare e shqiperise (Paskal Haxhi) Tirane 2008

Meqenese tokat mirie u ndane d i'u dhane ne zoterim feudaleve te ndryshem, shteti otoman mbeti gjithnje pronar i vertete i ketyre tokave.

Ne kete kuader kemi nje gjendje familjare dhe sociale tejet te tensionuar pasi ne keto kushte u zhvillua perhere te pare lufta mes llojit ne familje, e nxitur kjo lufte nga politika e sulltanit. Po ashtu perhere te pare lindi lufta e klasave te krijuara ne menyre fiktive nga kjo politike perca e sundo qe hapi sulltani per te ushtruar pushtetin e tije gjate sundimit ne vendin tone.

Po ne keto kushte kemi te bejme me nacionalizimin e prones dhe te se drejtes se pronesise osmane dhe nje hapje e perqasje me denacionalizimin e prones dhe kesaj te drejte te pronesise osmane e cila u kushtezua sa mesiper ne funksion te politikës se sulltanit, Dividjus Dimperjus.

Ne fushen e rregullimit juridik te tokes, reformat e viteve 1832-1834 <sup>86</sup>zene nje vend te dukshem. Ne vitin 1800 doli nje ferman i sulltanit, sipas te cilit tokat e tij kalonin me fondin shteteror<sup>87</sup>. Zoterimi tokesor i spahijeve u kufizua metej me ligje te reja, derisa ne vitin 1812 u ndalua krijimi i timareve dhe i zeameteve te reja. Ne keto kushte dhe ne keto raste kur shume spahij kishin mundur te shnderonin ne rruge te ndryshme timare ose zemate ne cifligje duke siguruar tapite perkatese, shteti ua njihte ato si zoterime private. Kjo dukuri u vu re deri ne vitet 1864 qe njihet si viti i likujdimit te plote te timareve, kur perandoria Osmane u riorganizua perfundimisht sipase sistemit administrative francez. Fshataret qe kishin mundur te ruanin tapite per ngastren e tokes ku punonin, njiheshin juridikisht si zoterues te tokes, por jo ne kuptimin e vertete te

---

<sup>86</sup> E drejta agrare e shqiperise (Paskal Haxhi) Tirane 2008

<sup>87</sup> E drejta agrare e shqiperise (Paskal Haxhi) Tirane 2008

pronesise borgjeze, per shkak te kufizimeve qe permbante ende ende legjislacioni i ri agrar osman.

Ne fiset malore u ruajt bashkesia familiare. Ruajtja e bashkesise famijare (bashkepronesia), edhe gjate kohes se feudalizmit osman, i deryrohet ne redhe te pare faktit se ky institut i se drejtes tokesore shqiptare i pershtatej mire maredhenieve pak te zhvilluara, qe ishin karakteristike per ekonomine e mbyllur gjysme natyrore te asaj epoke.

Kanuni i Lek Dukagjinit njihete edhe pronen private mbi token<sup>88</sup>. Nje sere urdherimesh te vecanta, si ato mbi trashegimine, kujdestarine e vertetojne kete. Pra keto urdherime pasqyrojne kushtet e reja ekonomike-shoqerore qe kishin filluar te krijoheshin edhe ne malesi. Kishte filluar edhe atje shturja e familjes se madhe dhe krijimi i familjeve te vogla, te cilat perbeheshin nga prinderit dhe femijet e tyre qe bashkejetonin me te atin gjersa ai jetonte.

Udhezimet e qarta te ketij kanuni<sup>89</sup> deshmojne per kalimin e pronesise se perbashkt (kurie) ne pronesi private te personave te vecante. Ne kushtet e regjimit feudal ushtarak osman, ku fshatari vinte token e vet garanci per borxhin, kapitali fajde filloi te lidhej me pronesine tokesore dhe te ndihmonte ne shturjen e sistemit feudal ushtarak.

Heqja me ligj e sistemit feudal ushtarak ne vitin 1831-1834 nuk shenonte ende zhdukjen e prones feudale<sup>90</sup>. Keto ligje i njihnin feudaleve cifligare pronesine e plote mbi cifliqjet qe kishin krijuar ne kushtet e regjimit feudal ushtarak, si edh te drejten e shfrytezimit te bujqve ciflinj qe punonin ne ciflig.

---

<sup>88</sup> Kanuni i Leke Dugagjinit

<sup>89</sup> Kanuni i Leke Dukagjinit

<sup>90</sup> E drejta agrare e shqiperise (Paskal Haxhi) Tirane 2008

Ne vitin 1832 Porta e Larte shfuqizoi me ligj timarin feudal<sup>91</sup>, por feudalit spahi nuk e preku. Spahijtë e viteve 40 nuk u ngjasonin spahijëve të shekujve të kaluar, mbasi tani nuk e gëzonin tesarufin mbi tokën e fshatit, si rrjedhim e humbën pronën feudale mbi tokën.

Perandoria osmane, bile Porta e Larte, shumicën e ciftliqëve që ua kishte konfiskuar feudaleve të dënuar si kryengritës, i ktheu në pronë private e shtetërore, duke e kthyer kështu vetë Perandorinë Osmane në një pronar të madh ciftliqës. Të drejtën e pronës ciftliqës e fituan edhe institucionet fetare islamike e të krishtera.

Krahas rritjes së pronës ciftliqës u duk njëkohësisht edhe procesi i deciftligimit, e kthimit të saj në pronë të vogël fshatare, në zotërim të prodhuesit të drejtëperdrejtë bujqësor. Ky proces u krye në anën e blerjes së tokave ciftliqës ose nga ana e fshatareve të vegjël që nuk kishin toka të mjaftueshme ose nga vetë bujqit ciftliqës të cilët me sakrificë të mëdha u kthyen në pronar të vegjël. Megjithatë, rastet e deciftligimit vetëm pjesërisht e ulën sipërfaqen e pronës ciftliqës si teresi.

Popullsia e malesive të Shqipërisë gjendej në kushte më të prapambetura se popullsia e pjesës tjetër të saj. Megjithatë baza ekonomike –shoqërore e rendit fisnor që zhdukur prej kohësh në ato krahina. Prona private mbi mjedin kryesor të prodhimit, sic ishte toka, atje ishte stabilizuar prej kohësh, ajo ishte sanksionuar në mënyrë të theksuar edhe në të drejtën zakonore me të gjitha tiparet e saj kryesore, sic janë: shitja, blerja e çdo lloji tjetër tjetërsimi. Në Kanunin e Leke Dukagjinit pronë ishte shpallur e shenjtë dhe e paprekshme. Gjurmët e pronës së përbashkët të fisit mbi tokën e bukës dhe shenjat e ndarjes përiodike të tokave midis anëtarëve të fisit, qëne zhdukur krejtësisht.

---

<sup>91</sup> E drejta agrare e shqipërisë (Paskal Haxhi) Tirane 2008

Prapambetja e theksuar ekonomike-shoqerore e perandorise feudale osmane, e cila po thellohej gjithmone e me shume, ne nje kohe kur ne vendet e Europes Perendimore po zhvillohej revolucioni industrial si dhe kryengritjet e vazhdueshme te popujve te nenshtruar, e dobesuan se tepermi Turqine<sup>92</sup>.Ne keto rrethana Porta e Larte ndermori nje seri reformash qe njiheshin me emrin tanzimat.

Ne vazhdim te reformave te ndermara, me 21 prill te vitit 1858 doli nje ligj i vacante agrar, ligji i tokes.Ligji formulonte juridikisht heqien e sistemit feudal-ushtarak te timareve dhe pergjithesonte ndryshimet ne legjislacionin agrar ne vitin 1858<sup>93</sup>.

Por ne ate ligj u pasqyryan edhe parimet e legjislacionit agrar te vjeter osman.Ai e forconte dhe e zgjeronte edhe me teper pronesine private mbi token, duke i hequr pengesat e fundit qe nxirren akoma .Porta me shit blerjen dhe trashegimine e atyre personave qe nuk kishin trashegimtar te drejt perdrejte dhe duke lehtyesuar venien ne qarkullim te nje pjese te fondit te pergjithshem te tokes.

Sipas ligjit mbi token, bujku i vendosur ne cifliqet e bejlereve, cifciu, konsiderohej si qiramarres i thjeshte, mbasi ai kishte te drejte te largohej nga toka.Marredheniet midis pronarit dhe cifciut rregulloheshin sipas nje marreveshjeje te mbeshtetur ne traditen. Por kur nje pjese e madhe e fshatareve ishte pa toke ose me toke te pamjaftueshme, pronari cifligar u diktonte cifcinjeve kushtet qe deshironte.Pra ligji nuk preku pronen cifligare.

Ligji<sup>94</sup> mbi token i ndante tokat ne 5 kategori dhe konkretisht:-

-1-Ne tokat e pronesise se plote (toka mylk);

---

<sup>92</sup> E drejta agrare e shqiperise (Paskal Haxhi) Tirane 2008

<sup>93</sup> E drejta agrare e shqiperise (Paskal Haxhi) Tirane 2008

<sup>94</sup> E drejta Agrare e Shqiperise (Paskal Haxhi) Tirane 2008

-2-Ne toka shteterore (eraz-imirie);

-3-Ne toka vakefe-eraz-mefkufe

-4-Ne toka te lena ne perdorim te bashkesive (eraz-i-metruqe)

-5-Tokat e braktisura (eraz-i Mevat)

Pra ky ligj i tokes i vitit 1858 dhe ligjet e tjera agrare qe dolen ne vitet e mevonshme preknin edhe marredheniet midis zoteruesve te cifligjeve dhe fshatareve cificinj qe punonin ne to.

Ne thelb ky ligj sanksiononte pronesine private mbi token, garantonte shitblerjen e saj te lire.Ai kenaqte interesat e feudaleve cifligar dhe te institucioneve fetare, mbasi i jepte fund pronesise feudale ushtarake, lehtesonte shitjen e tokave nga ana e fshatareve dhe favorizonte grumbullimin e tyre ne duart e pronareve te fuqishem.Legjislacioni i mevonshem e thelloi me tej procesin, keshtu ne vitin 1857 ne disa kushte lejonte shitjen e tokes shteterore e te vakefeve dhe njihte te drejten e plote te shitblerjes se tokes.Ne kete menyre, krahas feudaleve cifligare,filloi te rritej nje shtrese cifligaresh te vegjel qe po hynte ne fshat duke blere toka.Kjo tregonte qart se ne fshatin tone te asaj kohe po zhvilloheshin elementet capitalist.

Zhvillimi i marredhenieve te tregetise ne shekullin XIX<sup>95</sup> –te ndikoi edhe ne vete marredheniet agrare.Si rrjedhim, ndryshoi struktura private e tokave,e cifligareve dhe e fshatareve.Vendin e pronesive te dikurshme feudale, qe nuk mundet t’u pershtateshin kushteve te reja qe u krijuan edhe ne zgjerimin e ekonomise se mallrave e zune cifligaret e rinj te lidhur me ekonomine kapitaliste.

---

<sup>95</sup> E drejta Agrare e Shqiperise (Paskal Haxhi) Tirane 2008

Ne kete periudhe shikojme se si nacionalizimi dhe denacionalizimi i prones dhe se drejtes se pronesise krijonte nje gjendje te tille ku here-here kishim levizje me reforma ne funksion te nacionalizimit dhe here here kishim reforma ne funksion te denacionalizimit, por ne te dyja rastet vlen per tu permendur fakti se kemi pasur kufizime nga te dyja anet por gjithmone perparesi ka pasur prona shteterore dhe me pas kemi nje zhvillim te prones private e cila u be ne funksion te politikës se sulltanit per te zgjatur pushtetin e tij si sundimtar ne vendin tone.

Shpallja e Pavaresise e gjeti Shqiperine nje vend bujqesor te prapambetur. Afro 90% e popullsisë merrej me bujqesi. Cifliqet zinin siperfaqet me te medha te tokes bujqesore. Pronare te ketyre cifliqeve ishin shteti ,vakefet dhe feudalet e cifligaret private. Ne krahinat malore, ku banonte me teper se gjysma e popullsisë, familjet fshatare zoterinin ekonomi te vogla individuale. Tokat e bukes, bagetia, kullotat, mullinjtë dhe vijat e ujit ne pergjithesi ishin prone e perbashket e gjithe banoreve te fshatit.

Shteti i ri shqiptar ne pergjithesi vazhdoi te zbatoje te drejten qe kishte qene ne fuqi ne Shqiperi gjate sundimit turk, pra te drejten osmane. Keshtu, bashke me marredheniet ekonomike feudale te sundimit turk, shteti i ri shqiptar trashегоi edhe legjislacionin turk. Kjo u njoh edhe ne rruge ligjvenese ne vendimin e Qeverise se Perkohshme te Vlores ne dt.06.06.1912, ne te cilen thuhej:-

“Mbeten ne fuqi derisa te behen te tjera kanune te drejtesise.”<sup>96</sup>”

Shteti i ri shqiptar menjehere pas Shpalljes se Pavaresise, konfiskoje 173 cifliqe qe shteti turk dhe vete sulltani kishin prona te tyre ne vendin tone. Ne te njejten kohe u

---

<sup>96</sup> E drejta agrare e shqiperise (Paskal Haxhi) Tirane 2008

shpall ligji per kontrollin e te gjitha dokumenteve te pronareve te tokes. Cifligaret te gjithë sebashku zoteronin me teper cifliqe se sa shteti. Përvec cifligareve te medhenj, kishte edhe te mesem qe zoteronin 100-1000 hektar sejcili. Toka zoteronin gjithashtu edhe tregetaret fajdexhinj dhe disa institucione fetare. Konfiskimi i cifliqeve nga shteti i ri shqiptar, nga pikpamja juridike shenonte ndryshimin e subjekteve te pronesise, kalimi i saj nga ish-pushtuesit turq ne cifliqe te shtetit shqiptar<sup>97</sup>. Por ky kalim nuk ndryshoi permbajtjen e pronesise se tokes.

Edhe Pas Luftes se Pare Boterore ishte pothuajse e njejta gjendje shoqerore dhe ekonomike dhe ne baze te vendimeve te Kongresit te Kushnjes midis problemeve te rendesishme, primar dilte dhe problemi i tokes dhe me doemos i nje reforme agrare. Por Cifligaret ishin kunder cdo reforme agrare dhe nuk pranonin as cenimin me te vogel nga ana e shtetit, apo te kujtdo tjeter te pronesise dhe regjimit cifligar.

Ne parlamentin e asaj kohe diskutohej persa i perket ketij problemi, po ashtu edhe jashte ketij institucioni individe te caktuar i jepnin nje kuptim te ngushte reformes agrare qe pretendohesh te behej. Reforma qe u pretendua te kryhej ishte nje reforme<sup>98</sup> duke dashur te "pajtonin" interesat e bujkut me parimet e pronesise. Ne kete rast qellimi ishte qe tokat e teperta te cifligareve te shfrytezoheshin me shperblim te cilin buqit do ta paguanin brenda afatit te percaktuar me ligj.

Te ndodhur ne kete fryme ne vitin 1923 Keshilli Kombetar miratoi ligjin "Mbi vendosjen e emigranteve e te bujqeve ne tokat e shtetit."

Siapas ketij ligji, qeveria detyrohej qe t'i jepte falas gjysme hektar toke nga pasuria e shtetit cdo familje emigrante, cdo familje bujqish pa toke te cifligareve te shtetit dhe te

---

<sup>97</sup> E drejta agrare e shqiperise (Paskal Haxhi) Tirane 2008

<sup>98</sup> E drejta agrare e shqiperise (Paskal Haxhi) Tirane 2008



cifligareve private dhe cdo familje tjeter pa toke qe kerkohej te merrej me bujqesi. Bujqve te mbetur pa toke shteti u vinte ne dispozicion dy hektare nga toka shterore per te punuar si ciflij, por duke iua falur detyrimet per nje perjudhe te caktuar. Tokat trojet dhe shtepite qe i`u dhane familjeve ishin te trashgueshme por jot e transferueshme.

Pra ne kete kuader del qarte denacionalizimi i prones dhe i se drejtes se pronesise pasi me keto menyra shtei jepte nga toka e tije subjekteve te tjera.

Ligji parashikonte gjithashtu se, ne qofte se tokat qe i`u jepeshin familjeve pa toke nuk punoheshin per tre vjete rresht, merreshin perseri nga shteti. Ai ndalonte shitjen e tyre ne kete rast<sup>99</sup>.

Ne nje kendveshtrim tjeter e shikonte reformen mbi token qeveria e vitit 1924 e cila kerkonte qe te bente kete reforme ne favor te fshatareve, pasi kjo qeveri kishte ne programin e saj ndryshimin e sistemit te taksave nemenyre qe te lehtesonte keto marredhenie te bujkut dhe te behej emancipimi ekonomik te tij. Pra nepermjete kesaj reforme qeveria kerkonte vec te tjerash qe te kenaqte cifligaret te cileve nuk i prekeshin tokat e tyre, borgjezine sepse rritja e prodhimit bujqesor do te conte ne zgjerimin e tregut te brendshem si dhe fshataresise qe do merrte nje pjese toke.

Nisur nga sa mesiper kemi te bejme me nje rruge te mesme te Qeverise se Fan Nolit midis nacionalizimit dhe denacionalizimit te prones dhe te se drejtes se pronesise<sup>100</sup>. Por me vone kete faze e shoqeroi kalimi ne denacionalizimi perfaktin se projekti mbi reformen agrare u emerua” Mbi shpronесimin e pasurive shteterore. ”Sipas tij shpronесimit i nenshtroheshin te gjitha tokat e pasurise se shtetit, tokat e papunuara dhe

---

<sup>99</sup> E drejta agrare e shqiperise (Paskal Haxhi) Tirane 2008

<sup>100</sup> E drejta agrare e shqiperise (Paskal Haxhi) Tirane 2008

te punuara, kullotat, pyjet, livadhet, kopshtet, stanet, mullinjte dhe cdo pasuri tjeter e luajtshme dhe e paluajtshme. Perjashtoheshin nga shpronesimi pyjet dhe kullotat qe kishin siperfaqe me te madhe se sa duhej per te plotesuar nevojat e fshatareve, cifliqet qe kishin ne nentoken e tre minerale bakri, hekuri, qymyri, kripe, ujra minerale, tokat dhe godinat e rezervuareve per vepra publike ose ndertime qeveritare etj.

Tokat e shpronesuara u jepeshin se pari; fshatareve qe nuk kishin toke te tyre dhe qe banonin e punonin ne tokat e shpronesuara, se dyti; fshataret qe merreshin me bujqesi dhe qe nuk kishin toka te tyre, se treti; proletareve shqiptar, se katerti; fshatareve qe nuk kishin me teper se 4-6 hektar toke te cileve ju jepej si sasi, sasia suplementare dhe se fundi; zejtareve dhe profesionisteve te ndryshem qe banonin ne tokat e shpronesuara<sup>101</sup>.

Nuk perfitonin nga tokat e shpronesuara te arratisurit, te denuarit nga gjyqet per vjedhje e per vrasje, ata qe kishin token e tyre pas shpalljes se ketij projekti dhe ata qe kishin toke te mjaftueshme per mbajtjen e familjeve te tyre.

Siperfaqja e tokes qe u jepesh fshatareve caktohej ne pershtatje me kushtet e vecanta te vendit, si dhe duke pasur parasysh perberjen e familjes dhe prodhimtarine e tokes.

Cdo familjeje qe vendosej ne tokat e shpronesuara i jepej, pervec gjysme hektari toke per ndertimin e shtepise dhe godinave bujqesore edhe nje siperfaqe e punueshme deri ne 6 hektare. Kurse familjeve te bujkut qe kishin meteper se tre djem, i jepej edhe nje sasi toke suplementare pra 1/3 e siperfaqes e caktuar. Pleqeve mbi 58 vjec dhe te paafteve per pune qe banonin ne tokat e shpronesuara u jepeshin nga dy hektare

---

<sup>101</sup> E drejta agrare e shqiperise (Paskal Haxhi) Tirane 2008

toke. Zejtareve dhe profesionisteve, pervec tokes se nevojshme per truall, u jepej edhe nga nje hektar toke. Grave te veja, qe banonin ne tokat e shpronesuara dhe qe nuk kishin djem, u jepej vetem gjysma e siperfaqes se caktuar.

Nga tokat e shpronesuara u jepeshin fshtareve per vetplotesimin e nevojave te tyre te perbashketa(komunale) nje siperfaqe e mjaftueshme toke per rruge, per varreza, per ngritjen e godinave shkollore, per kullotat, kopshte dhe pyje. Siperfaqia e kullotave caktohej per cdo fshat ne baze te numrit te bagetive qe kishin fshataret, duke vene si kufi per cdo familje bujqesore. Pervec kesaj cdo fshatari qe te mos mbante me shume se 25 bageti te imta dhe 10 krere bageti te trashe si dhe qete e punes. Siperfaqia e pyjeve caktohej ne nje mase te tille sa te plotesonte nevojat e domozdoshme te fshatareve. Pervec ketyre cdo fshatari i jepej edhe nje siperfaqet toke per mbjelljen e pemeve. Punimi i kesaj siperfaqeje dhe perfitimi prej saj ishte i perbashket per fshatin. Kjo siperfaqe caktohej sipas numrit te familjeve qe kishte fshti dhe nuk duhej te kalonte 1/10 hektar per cdo familje.

Ne projektligj nuk percaktohej qarte nese toka u jepej fshatareve falas apo me pagese. Por nga permbajtja e tij del se tokat qe u shperndaheshin fshatareve ndaheshin ne dy grupe, ne tokat qe u jepeshin falas fshatareve dhe ne toka qe u shiteshin fshatareve.<sup>102</sup> Projekt ligji vinte nje sere kufizimesh qe sunonin mbrojtjen e prones se vogel mbi token. Fshataret e e vendosur ne tokat e shpronesuara detyroheshin te punonin vete token. Perjashtoheshin nga ky detyrim vetem agrononet. Ndalohej dhenia e tokes me qira, me perjashtim te rastit kur fshatari i vendosur ne te per aresye semundje, pra shendetesore, apo te ndonje aresye tjeter te jashtzakonshme, nuk mund ta punonte vete, fshatari nuk kishte te drejte as ta transferonte, as ta shiste token e dhene falas nga

---

<sup>102</sup> E drejta agrare e shqiperise (Paskal Haxhi & Edvin Haxhi)

shteti, kurse token qe e blinte me ankand ose pa ankand, ai mund ta shiste vetem pasi te kishin kaluar 10 vjet.

Per te ruajtur pronen e vogel te tokes nga copetimi i metejshem projekt ligji percaktonte si trashegimtar te tokes vetem djalin e madh te fshatarit. Kur fshatari nuk kishte djem token e trashegonin vajzat deri sa ato te martoheshin, pas kesaj prona shkonte perseri e behej prone shteterore<sup>103</sup>.

Sipas projekt ligjit, te gjitha ata qe merrnin toke shteterore dhe qe me perjashtim te shkaqeve te jashtzakonshme brenda tre vjeteve nuk i punonin, humbisnin te drejten e fituar. Toka i`u jepej bujqeve te tjere nevojtare ose shitej ne ankand.

Porjektligji parashikonte edhe nje sere masash favorizuese per fshataret. Me krijimin e Bankes Bujqesore, bujqit e vendosur ne tokat e shpronesuara kishin te drejte te merrnin me kredi deri ne 600 franga ari per te blere vegla bujqesore dhe per te ndertuar shtepi<sup>104</sup>.

Pra per here te pare u vendos qe kjo lloj pasurie te vendosej si kolateral ne funksion te marrjes se kresise. Por per te realizuar nga ana ligjore gjith kete ndermarrje duhej qe pronat e tilla duhej qe te ishin ne qarkullim civil per te permbushur me pas detyrimet ligjore persa i perket kredimarrjes dhe kontrates se huas nga njera ane dhe kontrates se hipotekes nga ana tjeter.

Kjo kredi jepej per nje afat 10 vjecar. Shtepia e bujkut dhe dy hektare toke nuk mund te shpronesoheshin ose te shiteshin per te shlyer detyrimin qe ai i kishte shtetit ose personave te tjere.

---

<sup>103</sup> E drejta agrare e shqiperise (Paskal Haxhi&Edvin Haxhi)

<sup>104</sup> E drejta agrare e shqiperise (Paskal Haxhi&Edvin Haxhi)

Lenda e drurit qe i nevojitej bujkut te vendosur ne tokat e shpronesuara per ndertimin e shtepise dhe godinave te tjera bujqesore, ne qofte se nuk mund te sigurohej nga pyjet e katundit te tij i jepej falas nga pylli me i afert i shtetit.

Per shpronesimin e pasurise shteterore dhe per shperndarjen e saj fshatareve ne cdo prefektore formohej nje komision i posacem. Komisioni maste tokat qe shpronesoheshin dhe i klasifikonte, caktonte personat qe kishin te drejte te perfitonin nga tokat e shpronesuara, si dhe sasine e tokes qe do t'i jepej cdo fshatari.

Ky projekt ligj u paraqit per studim ne Tetor te vitit 1924 Ministrise se Drejtesise ku u pa e nevojshme per nje sere propozimesh e ndryshimesh dhe pikerisht u ndal ne dhenien e siperfaqes suplementare te familjeve te medha, te mos merreshin parasysh vetem djemte por edhe vajzat<sup>105</sup>.

Projekt ligji ne fjale permbante ne vetvete nje demokratizim te prones dhe te marredhenieve te pronesise dhe per pos kesaj ishte nje hap i rensesishem per regullimin juridik te pronesise tokesore. Edhe pse ngeli pa u ekzekutuar per shkak te levizjeve politike te kohes, ai mbeti ne vetvete nje dokument me nje rendesi te vecante politike e juridike.

Nje tjetër panoramë do të kishim për këto marrëdhënie përsa i përket reformave që u bënë nga Qeveria tjetër e cila në dt.23.02.1926 nxori dekretin sipas të cilit shfuqizohej ligji i mëparshëm i dt.11.04.1925, që çlironte nga pagimi i taksave të bagetisë së himet dhe u vu në fuqi ligji i dt.17.01.1923 i cili ngarkonte me 0.5 franga ari takes vjetore për çdo koke bageti të imet. Tre muaj më vonë në dt.03.06.1926 doli një dekret ligj tjetër sipas të cilit taksa e bagetisë ngrihej në një frange ari për koke në vit. Po

---

<sup>105</sup> E drejta agrare e shqiperise (Paskal Haxhi & Edvin Haxhi)

ne kete vit sipase udhezimeve te qeverise, filloi mbledhja e taksave te prapambetura qe prej vitit 1918 deri ne 30.09.1926.

Kjo beri qe te vinim ne nje regjim te ri juridik mbi token pasi ai deri ne vitin 1925 vazhdoi te jete ai i perandorise osmane, qe regullojne me ligjin e tokave te vitit 1856.

Ne vitin 1925 ne Statutin e Republikes Shqiptare dhe ne vitin 1928 ne ate te Mbreterise Shqiptare, u shpall regjimi juridik i ri i tokes. Sipas statutit, toka nuk ndahej ne 5 kategori, sic ishte me pare, por te gjitha tokat brenda territorit te shtetit shqiptar shpalleshin prona te thjeshta (mulq) ne pronesi te shtetit, te personave juridik dhe te personave fizike<sup>106</sup>.

Megjithate rregullimi i ri e thjeshtezoi regjimin juridik te tokes, ne fakt, ashtu si dhe me pare pronesia tokesore ne fshat ishte heterogjene. Vepronin njekohesisht prona cifligare kapitaliste dhe prona e vogel. Ne te njejten kohe ne fshat kishte nje numer te madh fshataresh me pak toke ose pa toke.

Sipas te dhenave, ne fund te vitit 1928, ne pragun e miratimit te Kodit Civil cifligjet zinin nje siperfaqe rreth 200.000 hektar toke, nga te cilat ato private zinin 100.000 hektar, po dhe aq zinin dhe ato shteterore. Pra ne kete rast kishim nje barazi nga pikpamja materiale si objekt, si pasuria shteterore apo publike dhe ajo private. Ne kete rast jemi perpara edhe nje ekuilibri te arritur nga pikpamja e nacionalizimit dhe denacionalizimit te prones dhe te se drejtes se pronesise ku vlen te permendet se kjo shtate e ekuilibruar u arrit pas nje perpjekje politike juridike e ekonomike e cila shtyti institucionet shteterore , qe nisur nga gjendja shoqerore e vendit i cili kishte dale nga

---

<sup>106</sup> E drejta agrare e shqiperise (Paskal Haxhi & Edvin Haxhi)

marredhenie te tjera shoqerore dhe po futej tashme ne marredhenie te tjera shoqerore te forconin kete ekuilibër.

Por dua te theksoj se cifligu, si institut i pronesise tokesore zinte ende pozita sunduese ne Shqiperi.

Kjo tregon dhe anen tjetër te medaljes se ky institut po pesonte dale ngadale ndryshim dhe po pesonte rënie ne raport me te kaluaren.Kjo do te tregohet hap pas hapi edhe ne ndryshimin dhe miratimin e ligjit civil dhe konkretisht te Kodit Civil te vitit 1929 i cili parashikonte perkrah ketij instituti edhe institute te tjera me mjaft rendesi per zhvillimin e vendit.

Per te arritur tek Kodi Civil I vitit 1929<sup>107</sup> qeveria u perpoq te kryente disa reforma ne fushen e legjislacionit duke huazuar te drejten franceze dhe ate italiane.Hapi u pare u be me miratimin e Statutit te republikes, por ne fushen e pronesise e te marredhenieve civile ne pergjithesi kete hap e beri me miratimin e Kodit Civil te Mbreterise se Shqiperise.

Ky Kod Civil<sup>108</sup> qe hyri ne fuqi ne dt.01.04.1929 percaktoi parimet kapitaliste mbi pronesine,duke e shpallur pronen private sit e shenje e te paprekshme.keshtu ne baze te nenit 794 te Kodit Civil ,”Zoterimi eshte e drejta me gezue e me disponue sende ne menyre me absolute,me kondite qe most e behej nje ushtrim i ndalum prej ligjeve ose rregulloreve”,ndersa ne nenin 798 permendet se”ai qe ka zoterimin e tokes ka edhe ate te hapesires qe eshte mbi te, si dhe ate c’ka ndodhet nen siperfaqe, pervec kur me ligj caktohet ndryshe”.

---

<sup>107</sup> Kodi civil 1929

<sup>108</sup> Kodi civil i mbreterise se shqiperise 1929

Baze e Kodit Civil ishte pronesia e pakufizuar private, e cila mbeshetej ne nje te drejte per te zoteruar sendet pa asnje kufizim. Pronari i tokes e bente te veten gjithcka qe prodhohej nga ajo si dhe cdo gje qe bashkohej me te.

Kodi Civil pervec pronesise njihte dhe disa te drejta mbi sendet qe ndodheshin ne pronesine e te tjereve, sic ishin servitutet personale (uzurfruktet, perdorja dhe bajtjet), servitutet tokesore (pengu, hipoteka dhe e drejta e parablerjes midis bashkepronareve). Ai njihte gjithashtu nendoresine (posejdimin) e nje sendi ose gezimin e nje te drejte qe personi (nendoresi) kishte vene vet ose me anen e nje tjetri e dorembante ate ose e ushtronte te drejten ne emer te nendoresit. Per mbrojtjen e saj, pavaresisht nga fakti se nuk ekzistonte e drejta korrespoduese. Kodi Civil<sup>109</sup> i jepte nendoresi te drejten e padise te dorembajtjes dhe te padise se rivenies.

Pas hyrjes ne fuqi te Kodit Civil u miratua edhe ligji "Mbi zyrat e hipotekes dhe mbi taksat e tyre". Ligji permbante nje sere dispozitash te huazuara nga ligjet otomane mbi tapine duke ua pershtatur kerkesave te kohes.

Sipas ketij ligji, hipotekat merreshin merreshin vetem me transkriptimin e akteve te shitblerjes, te dhurimit etj, si dhe me inskriptimin e hipotekave ose te te drejtave, realale. Karakteristike eshte fakti se zyrat e hipotekave nuk merreshin aspak me regjistrimin e pronesise, per shkak se kerkoheshin te kryheshin matje gjeodezike. Kur pronari i ndonje toke ose ndertese te paregjistruar kerkonte te shiste ose te hipotekonte ate detyrohej qe ta regjistronte.

Pikerisht ne vitin 1932 ne parlament u paraqit projektligji per marrjen e masave te perkohshme mbi padite e nedoresise. Ligji kishte karakter thjesht procedural, ku pronaret

---

<sup>109</sup> Kodi civil 1929



e tokave gjeten rastin qe te siguronin fitime te tjera te paligjshme ne kurriz te bujqeve te varfer.

Sipas ketij ligji, edhe ne qofte se bujku nendores kishte fituar pronesine sipas ligjit, mjaftonte qe pronari te kishte titull pronesie (tapi), qe te nxirte ate nga toka.

Kjo u dha mundesine shume feudaleve qe te ngrene padine ne gjykate duke pretenduar se ishin pronare te disa tokave te braktisura qe ne kohën e Turqise, te cilat ishin zene prej kohesh prej fshatareve te varfer. Keta fshatare sipas ligjeve ne fuqi ishin bere pronare me parashkrimin fitues dhe nuk mund t'i luante askush nga tokat e shtepite e tyre.

Ne kete periudhe nuk munguan perpjekjet e rretheve te ndryshme qe synonin me mendimet e tyre ne permiresimin e ekonomise bujqesore, vecanerisht per te perballuar krizen e kohe e cila ishte shtrine ne krizen e bukes. Pra shoqeria po kalonte ankthe jetesore dhe per te perballuar kete situatë duheshin bere reforma te karakterit emerxhent. Pra ishin keto kushte qe e detyruan qeverine e kohes qe te bente nje reforme ku ne qender te saj te kishte si objekt ate qe bujku te behej pronar i tokes dhe te ndihmohej me kredi.

Ashtu si ne vitet 1920-1924 qe u shfaqen mendime dhe pikpamje te ndryshme ne lidhje me menyren e zbatimit te reformes<sup>110</sup> edhe ne kete rast, krahas kerkesave per nje shpronësim me pagese te tokave te teperta te pronareve cifligar, dolen edhe kerkesat qe perfaqesonin interesat e masave fshatare, per nje shpronësim pa pagese dhe per ndarjen e tokave ne dobi te bujqeve pa asnje shperblim.

---

<sup>110</sup> E drejta agrare e shqiperise (Paskal Haxhi)

Ne pergatitjen e projekt ligjit u caktua nje komision dhe ne ndihme te tij u vendosen ekspert te fushes. Per kete shkak u desh studimi i te gjitha zonave te vendit qe nga veriu ne jug si dhe ne zonat malore, bregdetare dhe vendeve te ulta. Ky studim u be enkas per te pare nga afer dhe per te shkelur cdo pjese te tokes qe ne fund te fundit reforma te ishte sa me praktike per tu afruar me kerkesat e kohes dhe per te shuar disi krizen si dhe shkaqet qe cuan ne kete krize. Jo vetem kaq por u studjuan kushtet e bujqesise dhe ne menyre te vecante pronesine mbi token.

Ne krye per te ndihmuar u vendos profesori italian Xhovani Lorenconi i cili ne librin e tij ai flet per parimet e reformes agrare nepermjet te cilave del qarte karakteri i kesaj reforme agrare te propozuar prej tij. Ai deklaroi hapur se reforma agrare ne Shqiperi nuk mund te jete revolucionare si ajo e tipit rus, pasi Shqiperia eshte nje vend europian i organizuar me se miri, qe nuk mund te pranonte grabitje te asnje klase tjetere.

Parlamenti shqiptar ne 13.04.1930 dekretoi rregulloren "Mbi aplikimin e reformes agrare".

Sipas ligjit mbi reformen agrare, nuk u neneshtroheshin shpronesimit te detyrueshem tokat<sup>111</sup>, siperfaqet e te cilave nuk i kapercenin te 40 hektaret, duke u shtuar edhe 5 hektare per cdo femije te ligjshem, kur numri i anetareve te familjes i kalonte te pese frymet, kullotat qe ishin nen 10 hektar dhe qe u perkisnin pronareve qe kishin toka rurale te shpronesuara ose kullota nen 40 hektare, kur pronaret e tyre nuk kishin ne pronesi toka te tjera rurale te shpronesuara, pyjet sado qe te ishte siperfaqia e tyre, kur keto nuk ndodheshin brenda tokes se shpronesueshme ose pyjet gjer ne 10 hektare, kur keto ndodheshin brenda tokes se shpronesueshme, vrehta, ullishtet,

---

<sup>111</sup> E drejta agrare e shqiperise (Paskal Haxhi)

kopshtet dhe pemishtet, sado qe te ishte siperfaqia e tyre, kullotat e pronarit ne ciflig me gjithë vartësit e saj.

Tokat ose kullotat qe kapercenin siperfaqet e lartpermendura sipas ligjit i neneshtrheshin si prone e kushtezuar.Por pjesen prone e kushtezuar, pronari ishte i detyruar te bente disi permiresime dhe ne rast se brenda pese vjeteve nuk i bente, keto toka shpronesoheshin.Personat te cilet do te perfitonin nga reforma agrare mund te mernin vetem 5 hektare toke.

Fitimi i pronesise behej me shperblim.Fshatari duhet te paguante 20 franga ari per cdo hektare toke.

Kjo fryme konsiderohej, pra shperblimi si kusht te domosdoshem.Atehere u shtrua pyetja per zgjidhje se:-Cdo te ndodhte po t'i merrej tka dhe t'u jepej fshatareve pa shperblim? dhe pergjigjia ishte po thuaj e gatshme dhe konkretisht:-Do te ngjante qe fshataret qe beheshin pronare falas, do te ndjeheshin te liruar nga kujdesi per te prodhuar me teper per te paguar detyrimet, pra do te punonin me pak se me pare se te ndodhte ky si fakt, do te konsumonin me teper dhe keshtu te gjithë do te pesonin nje rendiment me te ulet te jetes.Po ashtu do te krijoheshin pakenaqesi te medha nga ana e pronareve dhe keshtu do te kishim problematika renduese si persa i perket shoqerise por dhe ne qeverisje pasi zemerimet e popullit do te transmetoheshin ne parlamen dhe ne qeverisje dhe keshtu do te binte kjo reforme agrare mbi token.

Ne vijim dua te theksoj se sipas kesaj suate ishte e nevojshme qe rrethe te ndryshme te krijonin mundesine qe te mos kryhej nje reforme agrare me remuja dhe trubullira por te behej nje reforme e ekuilibruar po ashtu ne reforme duhej pasur parasysh jo vetem rendi ekonomik, por edhe politik.

Koha e gjate qe kaloi per pergatitjen e projekt ligjit u dha mundesi pronareve qe te benin copezimin e tokave te tyre duke i shperndare ato ne rendin e trashegimise, nje pjese i dhuronin, nje pjese i shishnin tek te afermit etj. Kjo behej per shkakun qe te mos i sekuestrohej pjesa e tepert dhe me arsyen tjeter qe te kishin mundesine perseri qe t'i rimernin nga keta persona keto toka.

Nga ana tjeter cifligaret nuk pushuan se nderhyri ne qeveri dhe ne parlament per te ndikuar qe kjo rreforme te behej sa me shpejte te ishte e mundur si dhe te mbeteshin vetem nen nje reforme te kufizuar.

Bashke me ligjin e reformes agrare u shpall nje moratorium<sup>112</sup>, pra nje shtytje e afatit per pagimin e borxheve te marra deri atehere nga ana e fshatareve. Moratoiumi ishte per nje perjudhe prej pese vitesh. Njekohesisht u dekretua krijimi i Bankes Bujqesore te Shtetit, si dhe nje kontrate tip sipas se ciles do te rregulloheshin marredheniet midis bujqeve qe nuk do te perfitonin dot nga reforma agrare dhe pronareve, cifligare qe do te vazhdonin t'i jepnin me qira tokat qe ju mbeteshin.

Ne baze te kontrates tip, pronari i jepte me qira bujku nje sasi toke te punueshme per ta shfrytezuar sipas zakoneve te vendit dhe sipas udhezimeve teknike agrare. Bujku qiramarres detyrohej t'i dorerzonte pronarit ne depot e tij gjithë pjesen e prodhimit te mbledhur ose te vjelur qe i perkiste atij ne baze te kontrates. Pa lejen e pronarit bujku nuk kishte te drejte t'ia jepte me qira token nje personi tjeter. Ligji i reformes agrare kufizonte deri diku cifligjet e medha dhe krijonte mundesi per nje rritje me te shpejte te elementeve capitaliste ne fshat.

---

<sup>112112</sup> E drejta agrare e shqiperise (Paskal Haxhi)

Ligji parashikonte qe pronaret e medhenj te mund te shisnin tokat e tyre dhe pas hyrjes se tij ne fuqi, me lejen e zyres se reformes agrare, leje te cilen pronaret e medhenje e merrnin pa veshtriyesi.

Ne Qershor te vitit 1932 u miratuan nje sere ndryshimesh ne ligjin e vitit 1930. Sipas ketij ligji, pronat rurale qe i nenshtroheshin shpronesimit te detyruar mund te btjetersoheshin dhe te viheshin ne hipoteke teresisht ose pjesisht, pa ndonje formalitet, mbi nje person tjeter, duke vene ca kufizime te tjera. Me kete ligj u shfuqizua moratorjumi qe parashikonte ligji mbi reformen agrare.

Ligji preku vetem 8109,5 hektar toke, prej te cilave 3411,5 hektare u morren nga cifligjet private. Keto toka iu dhane 1888 familjeve. Nga zbatimi ne teresi i ligjit statistikat thone se ne favor te fshatareve te varfer u ndane 8109.5 hektar. Nga ky total 3411.5 hektar u morren nga tokat shteterore dhe 4698 dhe 4698 hektar u moren nga cifligjet private.

Per te rregulluar marredheniet ne vazhdimesi midis cifligareve dhe bujqeve u miratua nje kontrate tip ku pershkrueshin te drejtat dhe detyrimet respektive te paleve. Ashtu si edhe vete ligji i reformes agrare edhe kjo kontrate e vinte ne pozita diskriminuese bujkun fshatar ne rapor me cifligarin.

Permbajtja ne teresi e kontrates tip kishte nje shmangje te dukshme nga parimet themelore te kontrate te kesaj natyre. Tipik ketu do te permendim nenin 10 dhe 11 te kesaje kontrate dhe qe benin fjale per drejtimin teknik e administrative te prones tokesore dhe dhene me qira .Sipas kesaj kontrate e drejta e drejtimit teknik dhe administrative i perkiste pronarit te tokes dhe jo bujkut qiramares, i cili i sherbente tokes. Krejt i pakuptimte ishte edhe neni 8 i kontrates. Ne kete dispozite ishte percaktuar

se ne rastet kur bujku qiramarres cel nje toke te re dhe te papunueshme me pare,kjo prone e kalonte pronarit dhe vetem vitin e pare ajo do ti perkiste bujku.Duke analizuar nga kendveshtrimi formal-juridik, kushtet dhe rrethanat ekonomike shoqerore qe cuan ne miratimin e ligjit per reformen agrare duhet thene se deri ne ardhje ne pushtet te mbretit Zog, ne strukturen e se drejtes se pronesis mbi token kishin ndodhur shume ndryshime.Pavaresisht nga keto ndryshime Shqiperia vazhdonte te ishte nje vend agrar i prapambetur.Mardheniet agrare ekzistuese gjysmefeudale nuk ishin ne gjendje te nxisnin zoteruesin e tokave per te cuar perpara prodhimin dhe teknologjine bujqesore.Qarqet drejtuese e shikonin qe Shqiperia ashtu si me pare edhe shume kohe ne te ardhmen do te ishte nje vend ku te ardhurat kryesore te ekonomise do te siguroheshin nepermjet prodhimit bujqesor.Gjendja ekonomike e prapambetur diktonte qe zgjidhjet do te arriheshin duke reformuar sektorin agrar, nepermjete rritjes se numrit te pronareve real te tokave dhe rritjes se nivelit ekonomik te jeteses ekonomike.Pikerisht duke ndjere kete nevojë u be e mundur nga shteti i kohes se monarkise qe te nxitej per nje reforme agrare e cila u materializua ne ligjin per reformen agrare.

E rendesishme eshte te thuhet se ky ligj doli dhe u miratua ne nje kohe kur edhe ne shume vende te tjera ishin realizuar ose ishin ne proces realizimi i nje reforme te tille te kesaj natyre.Fatkeqesisht duhet pranuar se ligji nga vete ndertimi tij nuk synonte ne te vertete ne reforme agrare.Edhe nese ligji do te zbatohet ne perputhje te plote me brendesine e tij, do te vazhdonin te ruheshin diferencimet ne te drejten e pronesis qe mund te zoteronin pronaret e medhenj dhe fshataret e varfer.Kjo del ne menyre te kuptueshme nga fakti qe per cdo familje fshatare nuk mund te tejkalohet pronesia per mbi 5 hektar toke,ne nje kohe qe per shtresat e pasur ishin shume me teper.Sidoqofte

duhet thene se ligji per reformen agrare ne nje fare mase arriti te kufizonte cifiqet e medha dhe te krijonte hapësira per futjen dhe zhvillimin e elementeve capitalist.

Perfundimisht ve ne dukje se reforma agrare e shtetit monark edhe pse ne dukje te krijonte pershtypjen e nje reforme te vertete, realisht nuk arriti te bente nje gje te tille. Ajo pergjithesisht pati tipare gjysmefeudale. Shtojme gjithashtu se edhe me ate permbajtja, pavaresisht nga te metat themelore, per shkak te perpjekjeve te pakta, nuk arriti te gjente zbatim si ne thellesi ashtu edhe ne gjeresi.

### **5.3. Mbrojtja e te drejtave te njeriut ne fushen e internetit.**

**-Mbrojtja e prones perballe kriminaliteti kompjuterik-**

**-Ipsa Jure-**

**-Nga vete natyra e ligjit.**

**- Non in legendo sed intelligendo leges consistant-**

**- Ligjet kane vlere jo ne leximin por ne kuptimin e tyre-**

Te drejtat dhe lirite themelore te njeriut jane te pandashme, te patjetersueshme e te padhunueshme dhe qendrojne ne temel te te gjithe rendit juridik.

Organet e pushtetit publik, ne permbushje te detyrave te tyre, duhet te respektojne te drejtat dhe lirite themelore te njeriut, si dhe te kontribuojne ne realizimin e tyre.

Nisur nga fakti se zhvillimi i teknologjise kompjuterike ne fushen e internetit ka percaktuar edhe vendin dhe rolin qe ze ne kete globalizem informatik kompjuteri, i cili e ka zhvilluar akoma me shume funksionin e tij ne perqasje me shoqerine bashkekohore si dhe varesine e saj nga teknologjia e rjeteve sociale per te bere sa me evidente ate ne kete globalizem dhe duke i sjelle njekohesisht te mira produktive sasiore dhe cilesore kesaje shoqerie, kjo e fundit per pos kesaje perballet dhe me negativitetin qe percjell kjo teknologji nga subjekte fizike, juridike dhe grupe te caktuara kriminale ne keqperdorimin dhe keqtrajtimin qe i behet kompjuterit si mjet per realizimin e kriminalitetit kompjuterik dhe kibernetik. Ne kete pikpamje nje rendesi te posacme ze optika juridike e edukimit neprmjete ligjit persa i perkete mbrojtjes se te drjtave themelore te njeriut ne fushen e internetit ku vec te tjerash nje mbrojte e posacme i behet prones perballe krimit kompjuterik ne lidhje me cenimin e te dhenave private, diskriminimin me motive raciste e ksenofobiste duke u shperndar keto ne nje sistem kompjuterik duke fallesifikuar dhe denatruar edhe pronen dhe ne vecanti ate intelektuale dhe te drejten e autorit ne pergjithesi.

### **Kuptimi i konceptit ligj**

Koncepti ligj eshte teper i veshtire per tu kuptuar. Kjo per arsye se ligji mund te shihet ne kendveshtrime te ndryshme dhe nga secili kendveshtrim mund te nxirret nje kuptim i ndryshem mbi konceptin ligj. Veshtiresite mbi kuptimin e konceptit ligj linden pikesepari sepse jurisprudenca qe merret me studimin e ketij koncepti e studion ate ne dy kuptime:

-1- Ne kuptimin analitik

-2- Ne kuptimin normativ



Duke u nisur nga sa mesiper kemi ndarjen ne jurisprudence normative dhe jurisprudence analitike.

Jurisprudenca analitike merret me studimin analitik te strukturave dhe koncepteve ligjore, me shpjegimin e elementeve thelbesor ligjor qe perben te drejten ne teresi, apo ne sisteme ligjore te vecanta. Jurisprudenca normative merret me studimin dhe vleresimin e rregullave dhe strukturave ligjore duke u bazuar ne disa standarde ideale dhe percakton kriteret lidhur me ate se cfare perfaqson nje e drejte e mire. Me pak fjale jurisprudenca analitike nenkupton te drejten sic eshte, ndersa jurisprudenca normative nenkupton te drejten sic duhet te jete.

Nga ky kendveshtrim do te trajtohet vendi qe ze prona dhe pronesia ne mendimin juridik shqiptar mes lirive themelore te njeriut si dhe sigurise e garancise kushtetuese, pra permes dy ligjeve kryesore. Duke analizuar ne vecanti mbrojtjen e prones ne sistemin juridiko-civil, juridiko-administrativ, juridiko-gjyqesor, juridiko-familiar, juridiko-penal, juridiko-materjal, juridiko-procedural.

Nisur nga fakti se zhvillimi i teknologjise kompjuterike ne fushen e internetit ka percaktuar edhe vendin dhe rolin qe ze ne kete globalizem informatik kompjuteri, i cili e ka zhvilluar akoma me shume funksionin e tij ne perqasje me shoqerine bashkekohore si dhe varesine e saj nga teknologjia e rjeteve sociale per te bere sa me evidente ate ne kete globalizem dhe duke i sjelle njekohesisht te mira produktive sasiore dhe cilesore kesaj shoqerie, kjo e fundit per pos kesaje perballet dhe me negativitetin qe percjell kjo teknologji nga subjekte fizike, juridike dhe grupe te caktuara kriminale ne keqperdorimin dhe keqtrajtimin qe i behet kompjuterit si mjet per realizimin e kriminalitetit kompjuterik dhe kibernetik. Ne kete pikpamje nje rendesi te posacme ze

optika juridike e edukimit neprmjete ligjit persa i perkete mbrojtjes se te drjtave themelore te njeriut ne fushen e internetit ku vec te tjerash nje mbrojte e posacme i behet prones perballe kimit kompjuterik ne lidhje me cenimin e te dhenave private, diskriminimin me motive raciste e ksenofobiste duke u shperndar keto ne nje sistem kompjuterik duke fallesifikuar dhe denaturuar edhe pronen dhe ne vecanti ate intelektuale dhe te drejten e autorit ne pergjithesi.

Ne perputhje me ndarjen e mesiperme edhe koncepti i ligjit perdoret ne dy kuptime, duke i kuptuar ligjet si deskriptive ose pershkruese dhe preskriptive ose urdheruese. Ligjet descriptive jane pohime qe tregojne se si ndodhin ne fakt gjerat si rregull p.sh.ligjet e fizikes dhe natyres. Ligjet prescriptive jane pohime autoritare per ato gjera qe duhej te ndodhnin p.sh.neni 21 dhe 22 i Kushtetutes se Republikes se Shqiperise<sup>113</sup>. Keto jane ligje te qarta urdheruese qe kane te bejne me miratimin e ligjeve te tjera urdheruese. Ato paraqesin qarte ate ne lidhje me cka Kuvendi duke miratuar ligje te tjera urdheruese lejohet ose jo te beje. Keto lloj ligjesh urdheruese jane objekt studimi ne filozofine e se drejtes, ndersa ligjet pershkruese studiohen nga filozofia e shkences.

Dallimi midis ligjeve urdheruese dhe pershkruese eshte ndonjehere i veshtire dhe kjo eshte nje arsye tjeter pse studimi i konceptit ligj eshte i veshtire. Autore te ndryshem e shikojne konceptin e ligjit ne elemente te ndryshem duke e ngaterruar ate, apo me keq akoma duke e barazuar me moralin, dhunen apo rregullin. Nje nga keta autore (Harti),<sup>114</sup> shprehet se ligji nuk eshte gje tjeter vecse nje mjet per realizimin e kontrollit shoqeror duke i detyruar njerezit te benin disa gjera qe nuk do ti benin po ti lije ne vullnetin e tyre te lire.

---

<sup>113</sup> Kushtetuta e Republikes se Shqiperise.

<sup>114</sup> Filozofia se Drejtes Xhefri G.Merfi Xhuls L.Kolman.

Vertet mund te ngaterrohen konceptet moral dhe ligj, por ndonjehere te dy keto koncepte rregullojne te drejten, pergjegjesite etj. Ka shume detyrime ligjore qe nuk jane morale apo anasjelltas p.sh.lidhja e kontrates se huas mbi 50 mije leke me shkrese, apo mos ecja me shpejtesi me te madhe se 25 km/ore ne qendrat e banuara, jane detyrime ligjore por jo morale, ashtu si edhe disa detyrime te miresjelljes, sinqeritetit dhe dashurise jane detyrime morale por jo ligjore. Dallimi thelbesor midis detyrimit moral dhe atij ligjor qendron ne faktin se detyrimi moral zbatohet vet ne ndergjegje dhe nuk sjell ndonje pasoje negative ne rast mos zbatimi, ndersa detyrimi ligjor zbatohet edhe pa ndergjegjen e personit dhe moszbatimi i tij sjell pasoja ose sanksione negative te cilat mund te jene ndeshkuese ne rastin e te drejtes penale dhe privuese ne rastet e ligjeve civile, ne kuptimin qe personi nuk do te realizonte qellimin per te cilin ai kryen veprimin e caktuar. Vec kesaj detyrimi ligjor nuk duhet te ngaterrohet me dhunen, pasi eshte e vertete qe nje sistem ligjor eshte i bazuar mbi dhunen, sidomos kur behet fjale per ligjet penale. Mirepo ka nje dallim thelbesore midis dhunes se ushtruar ne nje sistem ligjor me ate te ushtruar ne menyre te jashteligjshme p.sh.ne qofte se nje person vret nje tjetër dhe denohet me vendim te formes se prere nga gjykata me burgim dhe policia gjyqesore e zbaton me force kete vendim, ku personi i denuar e kundërshton po me force policine, atehere eshte e qarte se jemi para perdorimit te ligjshem te dhunes, pasi nje nga deryrat e policise gjyqesore eshte zbatimi dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqesore. Nga ana tjetër kur nje person te del perpara me maske dhe te kerkon parate duke te kercenuar me arme eshte e qarte se ai po ushtron mbi ju dhune, por kjo dhune ndryshon nga ajo qe perdor policia gjyqesore.Dhuna qe ushtron polici eshte e ligjshme, ndersa dhuna qe ushtron personi i armatosur eshte e paligjshme.

Nje aspekt tjetër që e bën të vështirë kuptimin e natyrës së ligjit është edhe fakti se koncepti i ligjit ndeshet me disa raste të diskutueshme praktikash ose institucionesh që kanë tipare të përbashkëta me raste të qarta ligjore sa na shtyjne të quajmë ligje, por nga ana tjetër kanë aq shumë ndryshime sa mund të mos quhen të tilla. Kështu është e diskutueshme nëse e drejta nderkombetare apo e drejta primitive përbejnë apo jo ligje. Nëse i quajmë të atilla pra ligje, mund të pyesim se cili kuvend i ka miratuar, cili trup gjykues i interpreton dhe cilet organe ndëshkimore i mbështesin ato me forcë. Nëse i qëndrojmë strikt konceptit të ligjit, sidomos në fushën penale është e vështirë të pranohet se të drejta të tilla janë ligje. Por po të shohim problemin në një aspekt më të gjerë, në kuptimin që një normë mund të jetë shndërruar në ligj pa u miratuar nga një trup ligjvënës, por thjesht për efekt zakoni sic janë shumë norma të së drejtës nderkombetare, atëherë mund të themi se e drejta nderkombetare dhe e drejta primitive përbejnë raste të diskutueshme praktikash ligjore.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i jurisprudencës që merret me natyrën e studimit të ligjit është të bëjë dallimin midis koncepteve ligj dhe rregull. Koncepti i ligjit kërkon një analizë nëpërmjet elementeve të cilet në vetvete paraqesin çështje filozofike të rëndësishme. Disa ligje ngjajnë ose lidhen ose mund të jenë vetë rregulla. Rregullat nuk janë objekte materiale që mund të shihen, që mund të preken, megjithatë nuk është e pavërtetë të thuash se në shoqëri të një rregull që ndalon vrasjen apo vjedhjen. Po ashtu është e vërtetë që nuk ka një rregull që të detyron që të jesh i sinqertë.

Në këndvështrimin midis koncepteve rregull dhe ligj, mund të them se koncepti rregull është më i gjërë. Koncepti rregull përfshin një koncept më të gjërë se ai i ligjit dhe mund të themi pohimin se çdo ligj mund të jetë një rregull, por jo anasjelltas, jo çdo rregull mund të jetë ligj. Në aspektin e zbatimit të rregullit dhe ligjit mund të bëjmë

dallimin qe rregulli nenkupton zbatimin e tij nga personi pa u shoqeruar nga sanksioni ndersa nje rregull i shnderuar ne ligj nenkupton zbatimin e tij, dhe papelqimin e personit duke u shoqeruar me sanksion. Do me thene nese nje person nuk zbaton nje ligj ai do te vuaje sanksion privues ne rastet e te drejtes civile dhe nje sanksion ndeshkues ne rastet e te drejtes penale.

Problemi i fundit i objektit te filozofise dhe natyres se ligjit eshte problemi i kuptimit dhe interpretimit te ligjit ne nje rast konkret. Ata qe pergjithesisht nuk kane njohuri per natyren e ligjit mendojne se eshte e lehte te gjejne ligjin qe duhet zbatuar, por shpesh here ne te vertete procesi i kuptimit te ligjit nuk eshte i thjeshte. Mundet qe ligji ti thote gjerat ne menyre te mjegullt pjeserisht apo te mos i parashikojte fare. Ne keto kushte interpretimi dhe gjetja e normes nga zbatuesi i se drejtes nuk eshte nje gje mekanike, por nje pune krijuese sidomos ne sistemin common law, ku gjyqtari me shume se interpreton nje norme konkrete, bazohet ne precedentin e meparshem gjyqesor. Veshtiresia ne interpretimin dhe zbatimin e ligjeve ne nje rast te dhene eshte nje arsye tjeter praktike pse studimi i konceptit ligj dhe natyres se tij eshte e rendesishme si objekt i filozofise.

Merite ne kete duhet te kete konstitucionalizimi i gjuhes juridike, e cila duhet qe te kete termat dhe fjalorin e saj dhe menyren e vecante te shprehjeve, ku brenda shkrimit te gjuhes letrare te ligjit te gjejne vendin e tyre te duhur shprehjet juridike .

Ky imperativ duhet te ekzistoje ne shkrimin ligjor nepermjet teknikes legislative si dhe te frymezuar nga shkrimi akademik.

Nga sa mesiper lind pyetja se kush mund ta beje kete?

Pike separi kete mund ta bej ai qe ka titullin “JURIST” i cili mund te jete pjesmarres ne disa institucione si ate legjislativ, ekzekutiv apo gjyqesor etj dhe perfundimisht mund te behet nga kontrolli kushtetues qe i bene Gjykata Kushtetuese ligjeve ne funksion te Kushtetutes.

Pra norma juridike, ligji apo dispozitat ligjore qe te krijohen, te miratohen dhe te zbatohen duhet qe te kalojne neper nje infrastrukture juridike te qarte dhe kompetente.

Suksesi i vertet ne kete rast varet shume prej dijeve ligjore dhe aftesive per ti konkretizuar keto dije ne aspektin teorik dhe ate praktik te se drejtes. P.sh. nepermjet paligjshmerise dhe antikushtetueshmerise duhet te kete nderprerje dhe kufiri i nderprerjes duhet te jete ligji si akt me konkret se kushtetuta. Aty ku paligjshmeria eshte e kontestueshme aty do do te kemi vetem kontroll ligjshmerie nga Gjykata Kushtetuese<sup>115</sup>. Kurse cenimet e se drejtave te personave nga akti normativ do te interpretohen, arsyetohen dhe analizohen nga gjykatat e zakonshme te cilat kane te drejte te vendosin ne baze te ligjit. Pra ne kete rast kemi te bejme me dy aspekte. Aspekti i pare eshte pakushtetushmeria dhe aspekti i dyte eshte paligjshmeria. Ne lidhje me aspektin e pare gjejmë te sanksionuar se eshte Gjykata Kushtetuese<sup>116</sup> ajo qe perben garantin kushtetues nepermjet interpretimit kushtetues dhe koncepteve lendore. Ne lidhje me aspektin e dyte gjejmë te sanksionuar se jane gjykatat e zakonshme ato qe interpretojne ligjin dhe vleresojne nese faktet jane ne perputhje me ligjin (nga de fakto ne de jure).

---

<sup>115</sup> Neni 132 i kushtetutes se Republikes se Shqiperise.

<sup>116</sup> Neni 124 i kushtetutes se Republikes se Shqiperise.

Pra e para tregon qarte se ceshtjet kushtetuese nuk mund te bien ne nje gjuhe te ngushte teknike te ndonje dege te se drejtes por ka per qellim qe te gjykoje nese ligji bie ndesh apo jo me Kushtetuten.

Kurse e dyta tregon qart se ceshtjet e vecanta qe i perkasin nje dege te se drejtes vleresojne nese nje fakt eshte i ligjshem apo jo.

Pra ne gjuhen juridike qe perdoret ne gjykatën e zakonshme trajtohet fakti sipas ligjit, ndersa ne gjuhen kushtetuese diskutohet pikerisht ligji, eshte apo nuk eshte kushtetues.

Por edhe ne ratet kur kemi te bejme me ceshtjet te cilat i neneshtrohen juridiksionit te gjykatave te zakonshme, eshte sanksionuar tashme nga neni 6<sup>117</sup> i KDDNj dhe ne Kushtetute, procesi i rregullt ligjor ku cdo subjekt fizik apo juridik i drejtohet Gjykares Kushtetuese te marre ne shqyrtim shkeljet qe i jane bere nga gjykatat e zakonshme nga nje proces i pa rregullt ligjor<sup>118</sup>, ku hyjne interpretimi kushtetues dhe kopetencat lendore mbi gjykimin e ketyre ceshtjeve.

Lind pyetja, me kaq sa mesiper a mund te identifikojme te drejten?

Une them se jo, pasi kemi pare vetem disa pika referimi nga ana e brendeshme e ligjit dhe se drejtes. Por ekzistenca dhe permbajtja e se drejtes mund te identifikohet duke ju referuar burimeve shoqerore te se drejtes, si legjislacioni, vendimet e gjyqesorit ose zakonet shoqerore, pa ju referuar moiralit, me perjashtim te rasteve kur e drejta qe identifikohet keshtu i ka ne perberjen e vet kriteret morale per identifikimin e saj.

---

<sup>117</sup> Neni 6 KDDNJ.

<sup>118</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë neni 42

## **Zhvillimi i mendimit juridik shqiptar ne perputhje me kushtet social-ekonomike**

Ne kete kontekst mendimi juridik ashtu si edhe shteti dhe e drejta ka lindur ne kushte historike te caktuara. Procesi i formimit te tij ka qene i gjate e i nderlikuar. Ai ka kaluar neper stade te ndryshme te zhvillimit te shoqerise. Mendimi juridik, kultura juridike ne pergjithesi eshte zhvilluar ne rende te ndryshme ekonomiko-shoqerore, si dhe ne kushtet e pushtimeve te huaja, te cilat ka perjetuar Shqiperia. Per shkak te pozites se saj gjeografike dhe gjeopolitike midis lindjes dhe perendimit, kane qene te pashmangshme ndikimet e kultures te popujve te vendeve lindore dhe te vendeve perendimore mbi kulturen juridike shqiptareve dhe anasjelltas.

Por, megjithate, ajo ne rrjedhen e shekujve ruajti identitetin e saj. Kultura juridike tradicionale e popullit shqiptar ka lidhje te ngushte me kulturen materiale e shpirtore te tij, me shtetin, filozofine, fene, moralin, psikologjine, ideologjine, e politiken qe ushtrojne ndikim te fuqishem mbi te, pavaresisht se ne analize te fundit, percaktohen nga nevojat materiale te njerezve ne etapa te ndryshme te zhvillimit te shoqerise shqiptare.

Mendimi juridik, ashtu si e drejta, ka pesuar evolucionin e tij historik. Fillimisht ai shprehej ne format me te thjeshta empirike, ne normat e sjelljes se njerezve, te cilat buronin nga filozofia popullore ne qendrim ndaj drejtesise e padrejtesise, ndaj te mires dhe te keqes, e pastaj, ne normat e se drejtes zakonore. Ai tani ka arritur nivele te larta, te sintetizuara ne ligjet pozitive dhe vecanerisht ne Kushtetuten e re te shtetit demokratik.



Kushtetuta, si ligj themeltar i shtetit<sup>119</sup>, eshte baze per te relizuar plotesisht reformen ligjore dhe institucionale, sipas mendimit juridik bashkekohor si dhe vepra shkencore te autoreve shqiptar.

Mendimi juridik, e drejta pozitive dhe shteti bashkeveprojne ne jeten e shoqerise dhe se asnjeri pa tjetrin nuk mund ta bejne.Realizimi i funksioneve te shtetit behet neprmjete normave juridike, ne te cilat sintetizohet mendimi juridik, kurse shpjegimi dhe interpretimi shkencor i tyre behet nga shkenca juridike.

Pikerisht se ekziston kjo lidhje dhe varesi e ndersjellte midis tyre, mendimi juridik luan rol te madh ne ndergjegjshmerine e njerezve ne qendrimin e tyre korrekt ndaj shtetit dhe per respektimin dhe zbatimin e ligjeve te tij.

Pervoja jetesore e popullit tone perfshire vitet e tranzicionit paskomunist, ka treguar se mungesa e kultures juridike ndikon negativisht deri ne paralizen e shtetit, shkeljen e ligjeve, dhe ne anarki dhe ne vetegjyqesi.

Kuptohet se per shkak te kushteve historike te Shqiperise deri ne gjysmen e dyte te shk.XIX nuk mund te pretendohet qe mendimi juridik shqiptar te shprehej ne vepra shkencore juridike te shkruara.Mendimtaret e medhenj te Rilindjes sone kombetare (shek.XIX) kane dhene kontributin e tyre per problemet e shtetit dhe te se drejtes. Pas tyre duken juriste te mirefillte, te paret e mendimit juridik shqiptar (1912) e ne vazhdimesi shkuan duke u bere gjithnje e me shume vepra shkencore.

Pa e njohur procesin e lindjes e te formimit te mendimit juridik, nuk mund te njihet sa duhet as historia e shtetit dhe e se drejtes, e anasjelltas. Ne keto kushte, per

---

<sup>119</sup> Kushtetuta e Republikes se Shqiperise neni 4

paraqitjen e mendimit juridik nga Iliria deri ne shekullin XIX<sup>120</sup>, ka rendesi te madhe te mbahen parasysh disa vecori kryesore dhe rrethana historike mbi frymen e ligjit ku lozin rol faktoret objektiv, kerkesat e praktikes. Kjo dikton nevojne qe njererzit te mendojne dhe te kerkojne pikpamje, koncepte e norma sjelljeje, te cilat fillimisht, kane karakter moral, gradualisht kthehen ne shprehi zakonore qe perseriten vazhdimisht dhe me krijimin e shtetit, shnderohen ne norma te se drejtes zakonore, qe pasqyrojne pikpamjet e shtresave e klasave te ndryshme. Po ashtu duhet te mbahen parasysh edhe faktoret subjektiv dhe konkretisht te autoreve anonime, pikpamjet e tyre per te drejten dhe te padrejten. Keto pikepamje juridike u shfaqen ne vendosien e normave zakonore te pashkruara.

Vecoria e shtetit Ilir<sup>121</sup> qendron ne faktin se, mendimi juridik ashtu sikurse krijuesit e se drejtes mbeten anonim, ndryshe nga Roma e vjeter apo Greqia e lashte, ku e drejta u shkrua dhe mendimi juridik i shkruar kane ardhur deri ne kohet tona.

Nga pikpamja antropologjike, mendimi juridik ne shtetin Ilir e kishte bazen filozofike ne mencurine popullore, bazuar ne botkuptime pagane, fetare, empirike, idealiste.

Sigurisht mungesa e veprave te shkruara me permbajtje juridike e veshtireson, por nuk e ben te pamundur, argumentimin e ekzistences dhe te zhvillimit te mendimit juridik, sado ne formen embrionale e empirike. Por pa nje mendim juridik nuk mund te konceptohej se si mund te arrihej ne organizimin e shtetit Ilir, ne percaktimin e kompetencave te organeve te tij, dhe te ekzistonte dhe te vepronte e drejta per rregullimin e marredhenieve juridike. Po ne baze te ketyre pikpamjeve eshte bere

---

<sup>120</sup> Historia e Shtetit dhe e se Drejtes botimi i 3-te. L.omari A.anastasi.

<sup>121</sup> Historia e Shtetit dhe e se Drejtes botimi i 3-te. L.omari A.anastasi.

organizimi i shtetit te Arbrit(Shek.XII)<sup>122</sup> i principatave feudale shqiptare gjate shek.XII-XV, para pushtimit osman, e aq me shume, organizimi e funksionimi i shtetit te pavarur nen udheheqien e Skenderbeut(shek.XV),<sup>123</sup> i cili realizonte funksionet e brendeshme e te jashtme per gati 25 vjet, duke qene ne lufte kunder pushtuesve osmane.

Mjafton te kemi parasysh vepren e kronistit Marlin Barletit e te Dhimiter Frankut per te krijuar nje perfytyrim per shtetin nen udheheqien e Skenderbeut, pavaresisht se nuk ishte botuar ndonje monografi juridike, ndryshe nga gjuhesia ku njihet vepra e Buzukut, Budit, Bogdanit, etj.

Argument tjetër për sa mesipër është se evolucioni i mendimit juridik mund të kalojë nga normat e së drejtës zakonore të pashkruara, në sanksionimin e Kushtetutës së shtetit të Epirit në Ilirine e Jugut në kohën e sundimit të Pirros së Epirit (297-262) para erës së re e të ligjeve të tjera. Pikerisht nga evolucioni i mendimit juridik mund të ndërtohet sistemi i së drejtës me deget e saj në shtetin e pavarur të Skenderbeut e deri në kanunet e mesjetare shqiptare, ku sintetizohen zakonet e traditat e popullit shqiptar dhe përvoja shekullore në zgjidhjen e konflikteve. Ndonese ende nuk është provuar që këto kanune të kënaqëne të shkruara, dihet me siguri se ato u trasmentuan në gojdhënat popullore brez pas brezi deri në kohën tonë, sa u mblodhën e u kodifikuan nga fillimi i këtij shekulli e ketëj.

Nuk mund të mohohet se në zhvillimin e mendimit juridik shqiptar gjatë këtyre shekujve ka vepruar e ndikuar fuqimisht qyteterimi greko-romak e bizantin, ligjet dhe kultura juridike e tyre që kishte nivel të lartë. Ky proces filloi që nga pushtimi i Ilirise

---

<sup>122</sup> Historia e Shtetit dhe e së Drejtës botimi i 3-te. L.omari A.anastasi.

<sup>123</sup> Historia e Shtetit dhe e së Drejtës botimi i 3-te. L.omari A.anastasi.

nga Roma<sup>124</sup> (V.167 para eres se re), ku dihet qe shteti dhe e drejta romake ishin mbi baza te forta filozofike e juridike. Pas pushtimit bizantin qe zgjati rreth 1000 vjet, ndikimet e legjislacionit (ndikimet e Kodit te Justinianit) dhe te mendimit juridik u thelluan edhe me tej.

Po me pushtimin e Shqiperise nga perandoria Osmane qe zgjati gati 470 vjet, krahas ndikimit te mendimit juridik greko-romako-bizantine u shtua dhe ajo osmane, bazuar ne ideologjine fetare te islamit (shariatit etj).

E megjithate kultura juridike, si pjese perberese e kultures popullore nuk u asimilua, ajo u skalit ne te drejten zakonore te zakoneve te mira e ne ate kanunore nga jugu ne veri ne Kanunet e Laberise, te Lek Dugagjinit, te Skenderbeut, Statuti i Scutarit etj. Edhe mendimi juridik anonim ruajti ne masa te ndryshme origjinalitetin e tij.

Pa perjashtuar zigzaket ne labirinthet e kohes ne procesin e zhvillimit te mendimit juridik shqiptar e ndryshimet qe pesoi gjate rrethanave te rrjedhes se shekujve, ai mbijetoi dhe mori trajta te qendrueshme ne veprat e mendimtareve te shquar te Rilindjes sone Kombetare.

Nga vete natyra e ligjit per pos sa mesiper duke u nisur nga karakteri tipizues dhe karakteri pergjithesuse, nje rendesi te madhe dhe kryesore mendimi juridik shqiptar ze permes lirive dhe te drejtave te njeriut si dhe sigurise e garancise Kushtetuese.

### **Edrejta e pronesise ne themel te mendimit juridik shqiptar**

Nisur nga fakti se, te drejtat dhe lirite themelore te njeriut jane te pandashme, te patjetersueshme e te padhunueshme dhe qendrojne ne themel te te gjithe rendit

---

<sup>124</sup> Historia e Shtetit dhe e se Drejtes botimi i 3-te. L.omari A.anastasi.

juridik<sup>125</sup>, nje nga te drejttat kryesore dhe themelore eshte ajo e te drejtes se pronesise e cila madje eshte nje e drejte absolute dhe e garantuar me ligj.

Te drejttat e njeriut jane parime baze pa te cilat njerezit s'mund te jetojne si qenie njerezore me dinjitet dhe si rrjedhoje respektimi i tyre ben te mundur progresin, prosperitetin dhe integrimin e individit dhe te shoqerise.

E drejta dhe liria shnderohen ne koncepte themelore ne momentin qe sanksionohen nga Kushtetuta si dhe nga traktate te rendesishme nderkombetare si konventat te cilat zen vend ne te drejten e brendeshme nepermjet radifikimit te tyre nga ligjvenesit .

Pronesia eshte nje institut juridik dhe e drejta e pronesise megjithese eshte “nje e drejte”, ajo nuk eshte nje entitet abstrakt dhe ideal, por imazhi i nje realiteti te caktuar shoqeror, ku ne rende te ndryshme juridike ka pasur mbrojtje te ndryshme.

Ne rendin demokratik dhe shtetin e se drejtes, mbrojtjes se saj i jepet nje rendesi e vecante pasi kosiderohet si kushti themelor per zhvillimin e prones dhe marredhenieve me pronesine qe kane personat fizik e juridik vendas e te huaj.

Pikerisht ligjvenesit yne duke u nisur nga fakti se prona<sup>126</sup> eshte nje e drejte vetiake, e ka sanksionuar ate ne Kushtetute dhe konkretisht ne nenin 41 te saj, ku eshte percaktuar menyra e fitimit te pronesise private nepermjet trashegimise, dhurimit, blerjes si dhe cdo menyre tjeter klasike te parashikuar ne K.C sipase neneve 149 e vijues te tij.<sup>127</sup>

---

<sup>125</sup> Kushtetuta e Republikes se Shqiperise neni 15

<sup>126</sup> Kushtetuta e Republikes se Shqiperise neni 41

<sup>127</sup> Kodi Civil neni 149

Përveç garantimit që Kushtetuta i bën të drejtës së pronësive nëpërmjet nenit 41 dhe të drejtës subjektive për një proces të rregullt ligjor parashikuar nga nenet 42 e 43 të saj parashikohet edhe e drejta e ankimit në gjykate. Kjo dispozitë kushtetuese, pra neni 43, zbatohet drejtpërdrejt duke qenë se në legjislativin tonë parashikohen edhe mjete të tjera për të bërë të mundur garantimin e të drejtës së pronësive.

Kështu në pjesën e përgjithshme dhe të posaçme të K.Pr.C të miratuar me ligjin nr.8116 dt.29.03.1996, zërthehen normat e të drejtës së pronësive që garanton Kushtetuta. Kështu në nenin 31 K.Pr.C<sup>128</sup>, individit i njihet e drejta për të bërë padi si një e drejtë e personit për tu degjuar, në mënyrë që gjykata të shpallë një vendim të bazuar në fakte dhe në ligj ose jo. Po ashtu ky akses gjendet edhe në dispozitat e posaçme të neneve 369 e vijues të K.Pr.C<sup>129</sup> përsa i përket pjestimit të pasurisë së përbashkët si dhe dispozitave të K.Familiar për regjimin ligjor apo kontraktor të pasurisë bashkeshortore.

Përveç këtij aksesit që i ka dhënë individit Kushtetuta dhe legjislativi civil material dhe procedural apo ai penal përsa i përket mbrojtjes së pronësive në nenet 134-140; 141-147; 148-159; 199-200:205-206 të K.P<sup>130</sup>, po ashtu edhe dispozitat procedurale të neneve 61 e vijues të K.Pr.P<sup>131</sup> përsa i përket padisë civile në procesin penal etj, Shqipëria ratifikoi dhe K.E.D.N j në vitin 1996<sup>132</sup> dhe e përfshiu atë në sistemin ligjor të saj. Këtu e drejta e pronësive ka një raport të drejtë me këto konvente, pasi këto konvente ju ngarkojnë të gjitha shtetet detyrimin pozitiv për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të parashikuara në dispozitat e saj.

---

<sup>128</sup> Kodi i Procedurës Civile neni 31

<sup>129</sup> Kodi i Procedurës Civile neni 369

<sup>130</sup> Kodi Penal

<sup>131</sup> Kodi i Procedurës Penale neni 61

<sup>132</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Nje nga keto te drejta qe shteti Shqiptar eshte angazhuar te mbroje eshte edhe e drejta e pronesise dhe per kete fakt ai ka radifikuar dhe miratuar neprmjete parlamentit ligje, konventa dhe protokolle mbi krimin kibernetik me qellimin e krijimit te nje pakete juridike te pershtatshme dhe gjithepershiresse per parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik duke percaktuar tashme infrastrukturen ligjore per parandalimin dhe sanksionet e posaceme te shkeljeve te bera nga shkelesit e ligjit permes kompjuterit dhe sistemeve kompjuterike duke ofruar keshtu mekanizmat juridike te brendeshme dhe nderkombetare ne mbrojtje te respektimit te te drejtave te njeriut dhe mbrotjes se te dhenave personale te tyre. Kjo aureole mbrojtese vjene neprmjete masave te ndermara nga shteti yne qe kjo fushe te mbulohet tashme edhe me mbrojtjen e posacme qe i behet prones duke i marre sebashku nga pikpamja e interpretimit dhe zbatimit te nocionit ligj dispozitat e nenit 1 te Protokollit nr.1 te KEDNJ qe i prkete “Mbrojtjes se prones” dhe ato te nenit 14<sup>133</sup> te Konventes persa i perkete “Ndalimit te diskriminit” ne koereence dhe ne lidhje analitike te pandashme per te zgjidhur rast pas rasti kur kemi te bejme me shkeljen e ketyre te drejtave dhe lirive nga individ apo grupe te caktuara si dhe ente publike apo jo publike duke zbatuar ne kete menyre nga vete natyra e ligjit dhe fryma ligjore edhe ligjet, konventat dhe protokollet e miratuara dhe te radifikuara ne fushen e krimit kompjuterik dhe konkretisht dispozitat e ligjit nr.8888 dt.25.04.2002”Per ratifikimin e Konventes per krimin ne fushen e kibernetikes” ku spikat ligji penal lendor ne seksionin 1i cili percakton si vepra penale, kryerjen me qellim te hyrjes ne nje pjese apo ne teresi te nje sistemi kompjuterik pa te drejte, keqperdorimin e paisjeve, krimet e lidhura me kompjuterat, falesifikimet e lidhura me kompjuterat, mashtrimet e lidhura me kompjuterat, veprat penale te lidhura me dhunimin e te drejtave te autorit dhe te

---

<sup>133</sup> Neni 14 K.E.D.NJ

drejtave te tjera te lidhura me te. Po ashtu ne seksionin 2 spikat ligji procedural ku percaktone sferen e zbatimit te dispozitave procedurale si dhe kushtet dhe garancite e tyre. Nje vend te vecante ze dhe juridiksioni, kopetencat dhe bashkepunimi nderkombetar ne lidhje edhe me ekstradimin dhe ndihmen e ndersjelle juridike ne marreveshjet nderkombetare te zbatueshme ne kopetencat e hetimit dhe marrjen e masave provizore ne efektet qe ka konventa.

Dispozitat e ligjit 9262 dt.29.07.2004”Per radifikimin e protokollit shtes te konventes per krimin kibernetik, per parandalimin e akteve me natyre raciste dhe ksenofobiste te kryera nepermjet sistemeve kompjuterike” i cili ka per qellim penalizimin e akteve te natyres raciste dhe ksenofobiste te kryera nepermjet sistemeve kompjuterike si dhe masave qe duhen marre ne nivel kombetar ne parandalimin dhe percaktimin e ketyre veprave penale, sipase ligjit te brendshem, sjelljen e meposhtme, ku kryhen me qellim dhe pa te drejte shperndarjen ose ndryshe berjen publike nepermjet nje sistemi kompjuterik te materjaleve raciste dhe ksenofobike per kercenime dhe fyerje me motive raciste dhe ksenofobie. Ne kete protokoll sipikat vec te tjerash edhe ndihma dhe shtytja e cdo shteti pale per te marre masa ligjislative, si dhe masa te tjera, te nevojshme per te percaktuar si veper penale sipase ligjit te brendshem edhe dhenien e ndihmes ose shtytjen ne kryerjen e njerës prej veprave penale te parashikuara ne kete protokoll, me synimin qe nje veper e tille te kryhet nga keto motive ne kuadrin e bashkepunimit te rolit te shtytesis organizatorit dhe ekzekutuesit te subjekteve kriminale. Kjo ne raport nepermjet konventes dhe ketij protokollit ne zbatimin “mutatis mutandis” ne kete protokoll te neneve 1,12,13,41,44,45,46 te Konventes<sup>134</sup>, duke i

---

<sup>134</sup> K.E.D.NJ



dhene te drejte paleve ne zgjerimin e sferes te zbatimit te masave te percaktuara ne nenet 14 -21 dhe nenet 23-35 te Konventes me nenet 2-7 te ketij protokolli.<sup>135</sup>

Dispozitat e ligjit nr.9887 dt.10.03.2008”Per mbrojtjen e te dhenave personale” ku si obejkt ky ligj ka percaktimin e rregullave per mbrojtjen dhe perpunimin e ligjshem te te dhenave personale i cili behet duke respektuar dhe garantuar te drejtat dhe lirit themelore te njeriut dhe ne vecanti, te drejten e ruajtjes se jetes private.Ne keto dispozita spikasin masat per sigurine e te dhenave personale ne ruajtjen e konfidencialitetin dhe besueshmerine e te dhenave te cilat nuk mund te perhapen, pervec rasteve te parashikuara me ligj. Te dhenat e dokumentuara nuk perdoren per qellime te tjera qe nuk jane ne perputhje me qellimin e grumbullimit. Po ashtu ndalohet njohja ose cdo perpunim i te dhenave te regjistruara ne dosje per nje qellim te ndryshem nga e drejta per te hedhur te dhena. Nga ky rregull perjashtohet rasti kur te dhenat perdoren per parandalimin ose ndjekjen e nje vepre penale.Ky dokumentacion i te dhenave mbahet per aq kohe sa eshte i nevojshem per qellimin, per te cilin eshte grumbulluar edhe ne konteksin e nivelit te sigurise i cili duhet te jete i pershtatshem me natyren e perpunimit te te dhenave personale ku per kete qellim miratohen rregulla te hollesishme per sigurimin e te dhenave nga autoriteti ligjor i percaktuar nga komisioneri i cili eshte pergjegjes per sa mesiper.

Sa mesiper sjell ne menyre te jashte ligjshme nga kryerja e ketyre veprave penale uljen e cilesise se jetes persa i perket subjekteve te prekura dhe te demtuara nga keto vepra penale, zhvleresimin e prones se tyre, pakesimin e vlerave te rendit moral dhe material persa i perket gezimit disponimit posejdimit te prones dhe te drejtes se pronesise dhe per vjeljen e fruteve juridike te saje dhe trashegimise se ketyre vlerave .

---

<sup>135</sup> K.E.D.NJ

## **Detyrimet dhe funksionet qe sjell e drejta ne mendimin juridik shqiptar ne mbrojtjen e prones perballe krimit kompjuterik**

Te drejtat sjellin dhe detyrime dhe ne kete rast mund te zberthehen ne tri drejtime kryesore:

-1-Detyrimi per te respektuar te drejten e pronesise ku do te kuptohet detyrimi i shtetit per te mos nderhyre ne te drejten e pronesise se individit, te personave fizike, apo juridike vendas e te huaj.

-2-Detyrimin e mbrojtjes se saj ku do te kuptohet mbrojtja e prones se personit fizik apo juridik nga nderhyrjet e personave qe pretendojne se kane nje te drejte pronesie.

-3-Detyrimi i shtetit per te krijuar kushtet e nevojshme qe kjo e drejte pronesie te ushtrohet efektivisht dhe ne menyre te qete.

Sipase jurisprudences se Gjykates Evropiane per te Drejtat e Njeriut<sup>136</sup>, e drejta e pronesise ka dy funksione:-

-a-Fuksioni privat i cili sjell ndikimin e vet ne gezimin normal te lirive dhe te drejtave te individit. Kuptimi historik dhe ai i perditesuar i garancise se prones eshte kuptimi i nje te drejte themelore qe lidhet pazgjithshmerisht me lirine individuale.

-b-Funksioni shoqeror ku prona ka njekohesisht edhe funksion te dallueshem shoqeror, pasi perdorimi i saj duhet t'i sherbeje vec te tjerash edhe mireqenies publike. Persa kohe funksioni i prones eshte nje mjet per ruajtjen e lirise vetiake, prona gezon nje mbrojtje te vecante. Nga ana tjeter, ligjvenesi mund te vendose kufizime ndaj prones sa me i madh te jete fuksioni social i saj.Sidoqofte “garancia Kushtetuese e pronesise” nuk

---

<sup>136</sup> KEDDNJ neni 46

mund te pranoje kufizime jo propocionale, d.m.th.kufizime qe nuk justifikohen me konsiderata sociale.

Funksionet e mesiperme nuk cenojne te drejten e shteteve qe te vene ne fuqi ligjet qe ato i quajne te domozdoshme per te rregulluar perdorimin e prones ne perputhje me interesin e pergjithshem ose per te siguruar shlyerjen e taksave, tatimeve, te detyrimeve te tjera apo gjobave te ndryshme.

Ne kete menyre garancia qe i japin individit normat Kushtetuese i bashkengjiten edhe normat e te drejtes nderkombetare te cilat nepermjete marreveshjeve nderkombetare te radifikuara ne Shqiperi behet pjese e se drejtes se brendshme pas publikimit ne fletoren zyrtare e ne gjuhen shqipe.

Per rrjedhoje dispozitat e ketyre marreveshjeve kane te njejten efekt, si e drejta vendase, si dhe shkelja e dispozitave te tyre mund te pretendohet nga individet ne te njejten menyre si edhe per ligjet e brendshme. Ky rregullim konsiderohet si arritje e rendesishme ne lidhje me sistemin e mbrojtjes se te drejtave dhe lirive ne pergjithesi dhe te drejtes se pronesise ne vecanti. Ne kete menyre individet kane edhe mjete te tjera per te pretenduar rivendosjen ne vend te se drejtes se pronesise te garantuar nga traktaktet nderkombetare. Keshtu nje vend te rendesishem dhe kryesor zene nenet e K.D.Nj, kjo jo vetem per faktin e gjithe perfshirjes se lirive dhe te drejtave ne dispozitat e saje, por edhe te mekanizmave mbrojtjes te vendosura ne Strasburg per te hetuar gjyqesisht shkeljet e raportuara dhe per te respektuar detyrimet qe rrjedhin nga Konventa, por edhe per faktin tjeter se ne hierarkine e normave ligjore te zbatueshme ne sistemin Ligjor te Shqiperise Konventa kosiderohet ne majen e hierarkise se normes se bashku me Kushtetuten.

Pervec statusit te brendshem Kushtetuta garanton zbatimin ne menyre te drejtperdrejte te ketyre marreveshjeve nga ana e gjykatave Shqiptare. Pavaresisht se kjo eshte nje zgjedhje e pelqyeshme ne teori, le vend per te deshiruar ne praktike sepse rrallehere gjejme vendime te gjykatave tona te cilat t'i referohen ne menyre te drejtpersdrejte marreveshjeve nderkombetare.

Ne perfundim dua te theksoj se gjithcka do te arihet permes clirimit tone, te energjive pozitive nepermjet punes, dijes, emancipimit qytetar dhe edukimit nepermjet ligjit, kultures juridike, politike e ekonomike, sociale, kukturor, historik, filozofik e psikologjik te cilat zhvillohen ne nje sistem vlerash demokratike te nje shoqeri te hapur ku prevalojne dhe kane perparesi lirite dhe te drejtat e njeriut te sanksionuara dhe te mbrojuta nga Kushtetuta ne nje shtet juridik te se drejtes.

#### **5.4. Mbrojtja e interesave me te larta te femijes permes Lirive dhe te Drejtave te Njeriut dhe Shtetit te se Drejtes**

##### **Patria potestas &-Pater familias**

Prinderit, organet kompetente dhe gjykatat, ne vendimet dhe veprimtarine e tyre, duhet te kene si konsiderate paresore interesin me te larte te femijes. Eshte ky mot a mo neni 2 i Kodit te Familjes<sup>137</sup>, ne te cilin ligjvenesit ka pershkruar edhe ne kuptim te neneve 116- 122 te Kushtetutes<sup>138</sup>, cdo marreveshje nderkombetare te ratifikuar, e cila perben pjese te sistemit te brendshem pasi botohet ne Fletoren Zyrtare te Republikes se Shqiperise, duke i dhene keshtu nje epersi mbi ligjet e vendit qe nuk pajtohen me te.

---

<sup>137</sup> Neni 2 Kodi I familjes

<sup>138</sup> Nenet 116-122 te Kushtetutes

Kuptimi i marrëdhënieve ndërmjet prindërve dhe fëmijëve përmes përgjegjësisë prindërore; si dhe parimet që qendrojnë në themel të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, kanë si qëllim: *Mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës!*

**Evolimi dhe ndryshimi i konceptit “Patria potestas & Pater familias” dhe pushteti prindëror në të drejtën moderne.**

Ka pasur një evolucion në aspektin antropologjik dhe historik të mendimit juridik,<sup>139</sup> duke u dalluar qartazi ndryshimi rrethues ndërmjet konceptit “patria potestas” të së Drejtës Romake dhe pushtetit prindëror të konceptuar nga e Drejta Moderne. E para përfaqëson një institut i cili kryesisht mbron interesat e “pater familias”, pra të kryetarit të çdo familjeje, që gjatë ushtrimit të detyrave në familje kishte nevojë për një autoritet të tillë, në funksion të mbarevajtjes së aktivitetit të familjes që drejtonte. Në të dytën, në konceptin modern, në themel të pushtetit prindëror nuk qëndron më kjo ide, por ky pushtet konceptohet në interesin më të lartë të fëmijës, duke pasur në themel qëllimin e idesë që prindërit, organet kompetente dhe gjykatat në vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës.

Kjo frymë ligjore e së Drejtës të Fëmijëve jo vetëm në këto dispozita të lartepërmendura, por edhe në dispozitat e tjera të Kushtetutit<sup>140</sup>, dhe konkretisht në nenet 52-53-54 të saj, gjen përparësi dhe prevalon mbi të gjitha të drejtat e tjera konkurruese në aspektin shterues të së drejtës në lidhje me të drejtat e tjera. Dhe në këtë aspekt, gjejmë vend të krahasojmë dispozitat e vecanta të së Drejtës Zakonore, të Kodifikimit të së Drejtës Familjare, të së Drejtës Kushtetuese, të Konventës Europiane

---

<sup>139</sup> E drejta Familjare (ARTA Mandro-Balili) Tirane 2006

<sup>140</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

te se Drejtave te Njeriut, me Konventen e te Drejtave te Femijeve, me Konventen e Hages”Per Mbrojtjen e Femijeve dhe Bashkepunimit per Biresimin Jashte Vendit”.

Pavaresisht nga emertimi konvente, akord, marreveshje nderkombetare, pakt, apo ndonje tjeter akt nderkombetar ne kontestin e lartepemendur, keto perbejne burime te se Drejtes Familjare ne Republikën e Shqiperise, duke i dhene keshtu nje konfiguracion te plote interesit me te larte te femijeve dhe mbrojtjes se interesit me te larte te femijeve ne nje shoqeri demokratike, ku sundon ligji, e drejta dhe drejtësia.

Ne kete kontekst fryma ligjore qe pershkruan marredheniet ndermjet prinderve dhe femijeve nga fillimi, kohe zgjatja, deri ne perfundimin e pergjegjesise prinderore dhe te drejtave dhe detyrimeve te femijeve, atyre personale jopasurore dhe pasurore te prinderve ndaj femijeve si kryefjale kane gjithmone “Mbrojtjen e Interesit me te Larte e Femijeve”.

Ky koncept pra marredhenia ndermjet prinderve dhe femijeve ka vijuar neper labirinhet e kohes nga e Drejta Romake, e Drejta Kanunore dhe Zakonore Shqiptare, ne te Drejten Zakonore te te Drejtave te Njeriut, ne Konventen Eropiane te te Drejtave te Njeriut, ne Konventen e te Drejtave te Femijeve, ne Konventen e Mbrojtjes se te Drejtes Familjare, te Kodifikimit te saje si dhe te Drejtes Kushtetuese dhe Kushtetutes te nje Shteti Modern, pra te se Drejtes Moderne.

Pra ne vijim duke u njohur katerciperisht se cilat jane burimet e se Drejtes Familjare, cfare eshte marredhenia familjare, vendi qe ze ajo ne raport me te drejtat e tjera, konstatojme se te gjitha faktet juridike, provat dhe ligji i aplikushem ne kohe dhe hapësire kane per tendece marredheniet ndermjet prinderve dhe femijeve ku trendi i

koheve moderne favorit ben gjithmone dhe pergjithmone “Mbrojtjen e Interesit me te Larte te Femijeve”.

E pare kjo edhe ne aspektin biologjik do te vem re se njeriu lind pervec te tjerash dhe me dy reflekse te pakushtezuara te cilat jane riprodhimi dhe mbrojtja te cilat konsistojne jo vetem ne marredheniet seksuale per nevoja biologjike, por edhe riprodhuese per dhenien dhe vazhdimin e jetes njerezore te cilat nuk do te kishin kuptim dhe zhvillim nese nuk do te kishim sistemin imunitar per te mbrojtur dhe ruajtur cka ne riprodhojme per trashegimine te cilet jane femijet tane qe do te jene jo vetem trashegimtare te rendit material por dhe atij moral, tradicional, kulturor intelektual, qytetar, european e global.

Ne kete kontekst duke krijuar gjithe infrastrukturen e nevojshme dhe te domozdoshme per kete trashegimi ne na nevoitet ne marredhenien prind, femije dhe shoqeri qe ne prinderit te jemi harku, ndersa femijet shigjeta jone e cila kerkoet gjithmone qe te godasi ne dhjeteshe, por nje rendesi po aq te madhe ka dhe klima shoqerore qe duhet te drejtohet nga elitat e saj qe te krijoje mundesi nepermjete energjive pozitive dhe prosperitetit qe kjo shigjete tashme qe po udhetone drejte dhjeteshes te mbrije ne destinacion dhe jo te deformohet rrugetimi i saj nga atavizmat dhe rudimentet e sjelljeve dhe mosrespektimit te te drejtave te femijeve.

### **Pergjegjesia prinderore ne mendimin juridik shqiptar.**

Ne fondin teoriko-juridik te zhvillimit te mendimit juridik shqiptar nje vend te rendesishem ze dhe pergjegjesia prinderore e cila ne koherence nga pikpamja e te drejtes pozitive ka burime formale te cilat rjedhin nga sjellje te ndryshme sociale, familjare dhe personale dhe i formezojne ato ne normen juridike duke i dhene njekohesisht edhe

kuptimin subjektiv kesaj norme juridike per te ndihmuar zberthimin e kuptimit te vertete te normes juridike e cila luan nje rol te rendesishem ne zbatimin korrekt te ligjit.

Ne kete aspekt titulli pergjegjesia prinderore duhet te filloje me konceptin e pergjegjesise prinderore e te vazhdoj me tej me kohezgjatjen e pergjegjesise prinderore dhe ushtrimin e pergjegjesise prinderore.

Konceptin e pergjegjesise prinderore ligjvenesit e ka misheruuar ne nenin 215 te K.Familjes<sup>141</sup> ku ne menyre taksative ai ka vendosur se:-“Pergjegjesia prinderore perfshin teresine e te drejtave dhe detyrimeve qe kane per qellim te sigurojne mirqenien emocionale, sociale dhe materiale te femijes, duke u kujdesur per te, duke mbajtur raporte vetjake me te duke i siguruar atij mirerritjen, edukimin, arsimimin, perfaqesimin ligjor dhe administrimin e pasurive te tij”.

Nga interpretimi literal e doktrinal si dhe krahasimor i kesaj dispozite perfitojme te konfirmojme se pergjegjesia prinderore do te konsiderohet insituti me i rendesishem ligjor per mbrojtjen e interesit me te larte te femijeve.

Si cdo marredhenie dhe norme tjeter juridike ne aspektin e parimit te pergjithshem jane dy ane te peshores te cilat jane te drejtat dhe detyrimet. Po ashtu edhe ne marredheniet prind femije ka ne vetvete te drejta dhe detyrime te cilat qendrojne ne kete peshore te mbrojtura nga insituti ligjor i pergjegjesise prinderore .

Mirpo keto marredhenie te posacme mes prinderve dhe femijeve zhvillohen permes dashurise pasi edhe ne nenin 1 te *Konventes Nderkombetare per te Drejtat e Femijeve* eshte sanksionuar vec te tjerash se :-“Femijet kane te drejte qe te jetojne, te rriten te

---

<sup>141</sup> Neni 215 Kodi I Familjes



edukohen e te mesojne ne nje bote te mbushur plote me dashuri<sup>142</sup>”. Pra ky eshte mjedisi i pare qe ne duhet ti japim femijeve, eshte ky ushqimi baze qe ne duhet ti japim femijeve, pra eshte kjo toka, uji, ajri, zjari, buka, kripa, streha, shkolla, edukata, kultura qe ne duhet ti japim femijeve ne jeten e tyre te perditeshme pra “DASHURIA”.

Po ashtu ne nenin 12 te *Konventes Nderkombetare per te Drejtat e Femijeve*<sup>143</sup> eshte garantuar e drejta e tyre qe ata te shprehin lirisht pikepamjet e tyre per cdo ceshtje qe ka te beje me ta duke i vleresuar ne perputhje me moshen dhe shkallen e pjekurise se femijes<sup>144</sup>. Ky vlersim nga ana e prindit duhet qe te vije ne cdo rast permes nje vendimi i cilit duhet te merret duke respektuar aspiratat e personalitetit te femijes ne zhvillimin dhe sigurimin e mirerritjes se femijes, sigurimin e mireqenies materiale, kujdesit ndaj shendetit, zhvillimit fizik e psikik te femijes, te mireqenies emocionale e sociale, nepermjet ruajtjes dhe mbikqyrjes se femijes duke marre masa me karakter edukues dhe shkollues per te, si dhe permes mbajtjes se nje raporti vetijak me te per te perfaqesuar dhe mbrojtur interest e tij.

Po ashtu ligjvenesi ne nenin 216 te K.Familjes ka percaktuar dhe kohezgjatjen e pergjegjesise prinderore e cila vazhdon deri ne arrijten e moshes madhore te femijes e cila eshte percaktuar me ligj se eshte mosha 18 vjec<sup>145</sup>. Pra ky eshte kufiri kohor i kohezgjatjes se pergjegjesise prinderore. Ne kete moshe pra lindin disa te drejta dhe nje nga keto te drejta eshte dhe e drejta per te lidhur martese ligjore. Vlen per tu permendur dhe fakti tjeter se kufizimi i pergjegjesie prinderore lidhet edhe me nenin 6 te K.Civil ku eshte percaktuar se femra fitone zotesine e plote per te vepruar si rezultat i lidhjes se

---

<sup>142</sup> Neni 1 Konventa Nderkombetare per te Drejtat e Femijeve.

<sup>143</sup> Neni 12 Konventa per te Drejtat e Femijeve

<sup>144</sup> Neni 12 Konventa per te Drejtat e Femijeve

<sup>145</sup> Neni 216 Kodi I Familjes

marteses ligjore<sup>146</sup>. Pra edhe pse ligjvenesit ne parimin e pergjithshem ka percaktuar kete moshe si kufi kohor per pergjegjesine prinderore, ne parimin e posacem ai ka sanksionuar se ne raste te vecanta me vendim te gjykates dhe konkretisht ne nenin 7 te K.Familjes mund te lejohet lidhja e marteses ligjore edhe ne moshe me te vogel se 18 vjec sipase rasteve fatore dhe si rrjedhoje kufiri i pergjegjesise prinderore ne raste te tilla kufizohet me vendim te gjykates deri ne nje moshe me te vogel se ajo 18 vjece, duke percaktuar keshtu nje tjetër kufi kohor per kohezgjatjen e pergjegjesise prinderore<sup>147</sup>. Por kemi dhe nje rast tjetër te posacem te kufizimit dhe kohezgjatjes se pergjegjesise prinderore ku ligjvenesit ka percaktuar se pergjegjesia prinderore perfundon pas arritjes se moshes madhore, per femijet madhore qe ndjekin studimet, deri ne moshen 25 vjec. Ne kete rast eshte percaktuar dhe nje nga obligimet me madhore qe ka prindi per femijen per edukimin nepermjet shkollimit dhe arsimimit te femijes.

Ne kete integral te caktuar nga –A- ne –B- kemi te bejme me fillimin e pergjegjesise prinderore si dhe me perfundimin e pergjegjesise prinderore.

Nisur nga fakti se pergjegjesia prinderore perfaqeson ne thelb nje marredhenie juridike mes prindit dhe femijes dhe si e tille ajo integrohet ne kohe te caktuar e cila fillon me lindjen e femijes, te personit gjalle sipase nenit 2 te K.Civil, e cila lidhet me zotesine juridike ku femija e gezon kete zotesi juridike qe nga zenia e tij kur ai lind i gjalle<sup>148</sup>. Atehere kjo eshte dhe koha kur fillon pergjegjesia prinderore qe i pergjigjet germes –A-.te integralit.Dhe nga ana tjetër ajo perfundon sipas trajtimit qe i beme moshes madhore qe i perket germes –B- te integralit te caktuar.

---

<sup>146</sup> Neni 6 Kodi Civil

<sup>147</sup> Neni 7 Kodi i Familjes

<sup>148</sup> Neni 2 kodi Civil

Ne te gjithë kete marredhenie mes prindit dhe femijes eshte e domosdoshme qe edhe nga ana e femijeve te kete jo vetem te drejta por edhe detyrime te cilat konsistojne ne ate te dashurise dhe respektit qe duhet te kene femijet ndaj prinderve te tyre, si dhe i ndihmes qe ata duhet qe ti japin atyre ne cdo kohe.

Kjo eshte e percaktuar edhe ne nenin 217 te K.Familjes nga ligjvenesit persa i perket detyrimeve reciproke ndermjet prinderve dhe femijeve<sup>149</sup>. Po ashtu i sanksionuar eshte edhe detyrimi i ndihmes se prinderve ne nenet 192-213 te K.Familjes<sup>150</sup>, i cili zgjat per aq kohe sa ekzistojne kushtet e parashikuara ne nenin 198 te K.Familjes<sup>151</sup>.

Ne ushtrimin e pergjegjesise prinderore kuptim dhe rendesi te vecante merr dhe parimi themelor ai i barazise ndermjet prinderve ne raport me femijen dhe interesin e tij me te larte. Pikerisht per kete ne K.Familjes i eshte dhene nje hapesire e mjaftueshme dispozitash te cilat hap pas hapi tregojne se nocioni interesi me i larte i femijes nuk eshte nje nocion vetem subjektiv i pare ne kendveshtrimin bardh e zi, por ai formezohe dhe merr karakter formal dhe objektiv duke e interpretuar ne menyre te detajuar dhe kolorite sipase rasteve qe na paraqiten ne praktiken gjyqesore se kush eshte interesi dhe se cfare perben ai per femijen, a perben ne rastin konkret interesin me te larte apo jo!

Sipas nenit 220 te K.Familjes jane percaktuar se subjektet qe ushtrojne pergjegjesine prinderore jane dy prinderit e femijes dhe si rezultat i kesaj duke qene si titullar te pergjegjesise prinderore, ata ushtrojne edhe te drejtat dhe detyrime<sup>152</sup>. Kjo vjen e lidhur edhe me nenet 67 dhe 108 te K.Familjes ne te cilin thuhet se dispozitat qe regullojne pergjegjesine prinderore nuk mund te shmangen edhe nese ka marreveshje

---

<sup>149</sup> Neni 217 Kodi i Familjes

<sup>150</sup> Nenet 192-213 Kodi i Familjes

<sup>151</sup> Neni 198 Kodi i Familjes

<sup>152</sup> Neni 220 Kodi i Familjes

ndermjet bashkeshorteve<sup>153</sup>. Pra asnje marreveshje nuk mund te vij ne kundershtrim, por edhe nese ka te tilla gjykata duhet qe ti konstatoj ato si veprime juridike absolutisht te pavlefshme duke i hapur rruge keshtu detyrimeve qe lindin nga ushtrimi i pergjrgjersise prinderore .

Ushtrimi i pergjegjesise prinderore merr nje karakter te posacem ne klasifikimin e ushtrimit te pergjegjesise prinderore pikerisht sipase dispozitave te neneve 220-221-222 te K.Familjes, per femijet e lindur nga martesja ligjore ku prinderit dhe femijet jetojne se bashku ne nje familje te vetme dhe pergjegjesia prinderore eshte e perbashket e te dy prinderve.Por vecanti kane femijet e lindur jashte marteses ligjore si dhe per femijet e biresuar si dhe ata nenkujdestari, ku ligjvenesit ka percaktuar se kush jane subjektet qe ju perket pergjegjesia prinderore dhe qe ushtrojne pergjegjesine prinderore<sup>154</sup>.

Nuk mund te lihet pa u permendur dhe pa u analizuar ne kete rast qe ligjvenesit ka parashikuar ne dispozita te vecanta te neneve 223-224-225-226-227-228-231-232-237-239-263-306 te K.Familjes edhe pamundesine e ushtrimit te pergjegjesise prinderore nga te dy prinderit si dhe nga njeri prind i vetem, per meshume se nje arsye si dhe ka percaktuar se kush jane rruget ligjore<sup>155</sup> si dhe subjektet qe vihen ne mbrojtje te interesit me te larte te femijeve, si dhe ka percaktuar dhe modalitetet e ushtrimit te pergjegjesise prinderore per cdo antikap te lindur si fizik apo juridik.

### **Pergjegjesia juridike e prinderve**

Nje rendesi te vacante ka edhe vendosja e sanksioneve qe ligjvenesit ka vendosur kundrejt prinderve ne lidhje me pergjegjesine juridike te prinderve te cilet nuk

---

<sup>153</sup> Nenet 67, 108 Kodi i Familjes

<sup>154</sup> Nenet 220-221-222 te kodit te familjes

<sup>155</sup> Nenet 223-306 te kodit te familjes

permbushin detyrimet prinderore gjate ushtrimit te pergjegjesise prinderore te cilat jane konkretisht ne nenet 223-228 te K.Familjes<sup>156</sup>.Ne kete kontekst, nese pergjegjesia prinderore ushtrohet ne kundershtrim me dispozitat ligjore urdheruese, prindi ndeshkohet ne raport me shkallen e mospermbushjes se detyrimeve ligjore. Mospermbushja e detyrimit ligjor mund te pas sjelle pasoja penale, civile, administrative e familjare te parashikuara keto ne dispozita te vecanta te K.Penal, K.Civil, K.Familjar etj.

Kjo mund te ndodh dhe do te ndodh vetem atehere kur prinderit t`a shikojne jo vetem si nje detyrim ligjor ushtrimin e pergjegjesise prinderore, por si nje permbushje te detyrimeve morale e familjare te dashurise dhe afeksionit qe duhet te kene prinderit per femijet.

Nga keto sanksione mund te vijne si pershembull heqia e pergjegjesise prinderore e cila eshte e percaktuar ne nenin 228 te K.Familjes dhe hiqet me vendim te gjykates te cilen e vendos ne levizje prindi tjetër ose te aferm te femijes si dhe prokurori. Keto raste jane kur prindi shperdoron pergjegjesine prinderore ose tregon pakujdesi te rende ne ushtrimin e saj ose me veprimet apo mosveprimet e tij ndikon ne menyre te demshme ne edukimin e femijes.Ky eshte nje nga sanksionet me te renda i parashikuar nga K.Familjes. Po ashtu ne zbatim te nenin 229 te K.Familjes<sup>157</sup> gjykata nepermjet vendimit te saj ka diskrecion dhe mund te vendose qe efektet te shtrihen mbi nje, disa, ose te tere femijeve te personit qe i hiqet pergjegjesia prinderore te cilat quhen si pasoja juridike te heqjes se pergjegjesise prinderore.Perveç efekteve te larte permendura qe sjell vendimi gjyqesor i heqjes se pergjegjesise prinderore, ky vendim sjell edhe pasoja te tjera si dhe efekte te tjera te lidhura ne menyre analitike me te parat te cilat

---

<sup>156</sup> Nenet 223 -228 Kodi i Familjes

<sup>157</sup> Neni 229 Kodi i Familjes

korespondojne me papajtueshmerine e ketij subjekti per te qene kujdestar ne baze te nenit 270 te K.Familjes<sup>158</sup>. Gjithashtu ka paaftesi per te biresuar ne baze te nenit 245 te K.Familjes<sup>159</sup>, si dhe paaftesi per te dhene pelqimin per biresim te femijes ne baze te nenit 246 te K.Familjes. Po ashtu pergjegjesia prinderore mund te kthehet me vendim te gjykates kur pushon shkakun per te cilin eshte hequr kjo pergjegjesi, kjo e parashikuar edhe ne nenin 230 te K.Familjes<sup>160</sup>.

Kurse dispozita e nenit 223 te K.Familjes eshte nje dispozite mbrojtese per femijen ne lidhje me sanksionet e humbjes se pergjegjesise prinderore sikurse edhe ato te heqies se pergjegjesise prinderore te nenit 228 te K.Familjes. Te dy keto dispozita sebashku si neni 223 dhe neni 228 i K.Familjes kane per qellim te privojne nga ushtrimi i te drejtave e detyrimeve, prinderit te cilet konsiderohen te padenje per t'u kujdesur ne vazhdimesi ndaj femijeve te tyre<sup>161</sup>.

Per te zbatuar denimin e heqies se pergjegjesise prinderore eshte e domosdoshme qe prindi te jete denuar me vendim te formes se prere per kryerjen e veprave penale te parashikuara rast pas rasti nga ligjvenesit sipas K.Penal.

Ne keto raste apo edhe ne raste te tjera kur zgjidhet martesja, gjykata mund te marr vendim per kalimin e ushtrimit te pergjegjesise prinderore apo nje pjese te saj, personave te trete. Ky si sanksion duhet kuptuar si nje nga sanksionet me te lehta ne raport me sanksionet e tjera te lartpermendura i cili ka nje karakter te perkohshem dhe mund te vazhdoje per nje kohe deri sa prinderit ti provojne gjykates ndryshimin e rrethanave lidhur me kushtet qe gjykata ka marre vendimin e meparshem. Pra keto

---

<sup>158</sup> Neni 270 Kodi i Familjes

<sup>159</sup> Nenet 245,246 Kodi i Familjes

<sup>160</sup> Neni 230 Kodi i Familjes

<sup>161</sup> Nenet 223, 228 te kodit te familjes

vendime jane gjithmone te ndryshueshme dhe merren vazhdimisht nga gjykata per te mbrojtur interesin me te larte te femijes ne raport me veprimet apo mosveprimet e kryera ne dem te tyre nga ana e prinderve gjate detyrimeve qe ata kane ne ushtrimin e pergjegjesise prinderore.

Ne te Drejten Familjare ne marredheniet ndermjet prinderve dhe femijeve vec atyre te karakterit personal jopasuror te cilat i trajtuam me siper, nje aspekt te rendesishem ze edhe pergjegjesia prinderore ne pasurine e femijes. Ne shprehjen e mendimit juridik shqiptar eshte trajtuar me kujdes edhe perkujdesja e femijes per<sup>162</sup>mes jovehem te mbrojtjes se personalitetit te tij por edhe te te drejtave pasurore te tij. Ne nenin 217 te K.Familjes tregohet qartazi edhe njehere se ndermjet prinderve dhe femijeve ekziston nje bashkesi interesash te lidhura ngushtesisht ndermjet vlerave afektive dhe materiale. Por jo vetem kaq, por ligjvenesit ka pershkruar ne nje kre te tere ne K.Familjes se si rregullohen marredheniet pasurore mes prinderve dhe femijeve<sup>163</sup>. Keto rregulla jane vendosur per perfaqesimin ligjor dhe administrimin e pasurise se femijes si dhe perdorimin e kesaj pasurie nepermjet veprimeve te ndryshme juridike qe i perkasin nocionit te pasurise se femijes te cilat mund te jene sende te luajtshme apo te paluajtshme si dhe te drejta te tjera reale mbi to te fituara permes trashegimise, kontratave te ndryshme te dhurimit, atyre ne dobi te personave te trete, te ardhurave te fituara nepermjet punes, apo te nje aktiviteti familjar.

### **Perfaqesimi ligjor i femijes**

Ne kete kuader nje rol te rendesishem ne mbrojtjen e interesit me te larte te femijes ze edhe perfaqesimi ligjor i femijes ne zbatim te nenit 232 te K.Familjes ku percaktohet

---

<sup>163</sup> Neni 217 I kodit te familjes

se prindi perfaqeson femijen e tij te mitur qe nuk ka mbushur moshen 14 vjec ne te gjitha veprimet juridike, me perjashtim te atyre qe, sipas ligjit, i mituri mund t'i kryej vete<sup>164</sup>. I mituri qe ka mbushur moshen 14 vjec i kryen vete veprimet juridike, por kurdohere me pelqimin paraprak te prindit, me perjashtim te atyre qe, sipas ligjit, mund ti kryej vete. Per shkak se detyrimi i prinderve per perfaqesimin e femijes buron nga dispozitat ligjore, prinderit konsiderohen perfaqesues ligjor te femijeve ne kryerjen e veprimeve juridike si dhe perpara gjykates apo cdo institucioni publik apo jo publik i cili shqyrton objektin e se drejtes se femijes. Fusha e veprimit te perfaqesimit ligjor varet gjithmon nga karakteri i ceshtjes. Ne kete kontekst percaktohet dhe qellimi i perfaqesimit ligjor si dhe kufijte e perfaqesimit ligjor sepse zevendesimi i vullnetit te femijes ne kryerjen e veprimeve juridike, vlen vetem per veprime te cilat nuk kane karakter ngushtesisht personal. Ne zbatim te nenit 64 te K.Civil<sup>165</sup> perfaqesimi nuk eshte i mundur ne ato raste kur ligji parashikon se veprimi duhet te kryhet nga vete subjekti i se drejtes. Nga ketu lind pergjegjesia juridike qe buron nga cenimi i perfaqesimit ligjor sepse nga ana tjeter, mospermbushja e detyrimit te perfaqesimit ligjor perben premise per heqien e pergjegjesise prinderore, pasi prindi qe gjate ushtrimit te pergjegjesise prinderore, neglizhon perfaqesimin ligjor, apo e kryen ate ne kundersizim me ligjin dhe me interesin e femijes, perben shkak per te sjelle pasoja permes sanksioneve te vendosura per keto raste nga ligjvenesit.

Edhe pse femijet jane titullare te se drejtave te fituara sa mesiper, ushtrimi i te drejtave qe rrjedhin prej tyre do te realizohen nga prinderit qe ushtrojne pergjegjesine prinderore permes perfaqesimit ligjor, administrimit ligjor te pasurise se tyre duke bere keshtu njekohesisht dhe klasifikimin e veprimeve juridike te administrimit te kesaje

---

<sup>164</sup> Neni 232 i kodit te familjes

<sup>165</sup> Neni 64 Kodi Civil



pasurie, si nje nga prerogativat me te rendesishme ne lidhje me ndarjen e administrimit te zakonshem dhe atij jo te zakonshem te pasurise se femijes persa i perket regjimit juridik te veprimeve te administrimit<sup>166</sup> te zakonshem dhe jo te zakonshem dhe fushes se zbatimit te tyre si dhe rasteve te sanksionit te zbatueshem te kryerjes se veprimeve nga vete i mituri, duke perjashtuar mepas ate nga perfaqesimi i veprimeve te administrimit te zakonshem dhe jo te zakonshem dhe deri tek pushimi I se drejtes se perdorimit te pasurise se femijes nga ana e prindit sipase nenit 237 te K.Familjes .

Deklarata e Pergjithshme mbi te Drejtat e Njeriut e perkufizon familjen si berthama natyrore dhe themelore e shoqerise e cila gezon mbrojtjen e shtetit. Shoqeria civile e ndergjegjesuar tashme ne kete kontekst duhet te pajis femijet me informacione dhe edukim te nevojshem ne lidhje me te dretat e tyre. Te bindur se familja, si njesi baze e shoqerise dhe mjedis natyror per rritjen dhe mireqenien e te gjitha anetareve te saj dhe vecanerisht te femijeve, duhet te kete mbrojtje dhe perkrahje te nevojshme qe mund te marre persiper plotesisht rolin e saj ne bashkesi. Duke pranuar se femija, per zhvillimin e plote dhe te harmonishem te personalitetit te tij, duhet te rritet ne mjedis familjar, ne nje atmosfere lumturie, dashurie dhe mirkuptimi. Duke pasur parasysh se femija duhet te pergatitet plotesisht per te bere nje jete individuale ne shoqeri dhe te edukohet ne frymen e idealeve te shpallura ne Karten e Kombeve te Bashkuara dhe sidomos ne frymen e paqes, te dinjitetit, tolerances, lirise, barazise dhe solidaritetit .

**Ne kete menyre: Nderojme te Shkuaren! Respektojme te Tashmen! Gezojme te Ardhmen !**

---

<sup>166</sup> Neni 237 I kodit te familjes

## **5.5. Mbrojtja e Mardhenieve te Punesimit Permes Lirive dhe te Drejtave te Njeriut Dhe Shtetit te se Drejtes.**

### **Liria e Punes- & - E Drejta Per Pune –**

Mardheniet e punesimit jane nje funksion i integrueshem ne shoqerite e lira dhe te hapura ne sistemet demokratike.

Ne kete kontekst ato konsistojne ne dy shtylla kryesore te cilat jane liria e punes dhe e drejta per pune. Ato gjenden te sanksionuara ne lirite dhe te drejta ekonomike, sociale dhe kulturore si dhe ato Kushtetuese. Mbrojtja dhe zhvillimi i tyre sasior dhe cilesor gjen nje imunitet sa juridik, etik dhe moral, permes nje organizimi, bashkepunimi dhe bashkimi sindikal, duke krijuar keshtu te drejten e mbrojtjes shoqerore te punes, sepse gjithë jeta e njeriut ne zhvillimin dhe perparimin e tij shoqeror ka ne themel punen e cila eshte e lidhur ngushtesisht si e drejte me te drejten e jetes, te drejten e prones dhe te drejten familjare si dhe ate Kushtetuese.

Ky sistem vlerash duhet zhvilluar ne tregun e lire te punes permes kerkeses dhe ofertes qe ligjet moderne te punes te rregullojne nje mori aspektesh substanciale te mardhenieve te punesimit dhe te teorive te pergjithshme te punesimit ne mbarevajtjen e mireqenies dhe te progresit njerezor.

### **Puna ne historine e zhvillimit te njerezimit**

Ne historine e zhvillimit te njerezimit nje vend te vacante ze dhe puna.

Gjate gjithë periudhave dhe etapave te ndryshmeve te njeriut dhe njerezimit, puna dhe punesimi kane qene si atribut i skllaverise dhe roberise. Nepermjet punes se tyre

sklleverit dhe roberit kane kryer pune nga me te ndryshmet permes imponimit te dhunes dhe detyrimit.

Me vendosjen ne vend te dinjitetit njerezor ne sistemet demokratike ne Konventen Europiane te te Drejtave te Njeriut ne nenin 4<sup>167</sup> u percaktua taksativisht “Ndalimi i skllaverise dhe i punes se detyruar”. Ne kete nen, pra ne nenin 4 vendet antare kane vendosur se:

- 1- Askush nuk mund t`e mbahet ne skllaveri ose ne roberi.
- 2- Askujt nuk mund t`i imponohet qe te kryeje nje pune me dhune ose me detyrim.
- 3- Nuk quhet si “pune e imponuar me dhune ose me detyrim”ne kuptimin e ketij neni:
  - a) Cdo pune, qe kerkohet normalisht nga nje njeri qe peson privimin e lirise ne kushtet e parashikuara nga neni 5<sup>168</sup> i kesaj Konvente (E drejta per liri dhe siguri) ose gjate qendrimit te tij ne lirim me kusht.
  - b) Cdo sherbim me karakter ushtarak, ose ne rastin e kundershareve te ndergjegjes ne vendet, ku kundershtimi I ndergjegjes eshte pranuar me ligj, nje sherbim tjetere ne vend te sherbimit ushtarak te detyrueshem;
  - c) Cdo sherbim, qe kerkohet ne rast krizash ose fatkeqesish, qe kercenojne jeten ose mireqenien e bashkesise njerezore;
  - d) Cdo pune ose cdo sherbim qe ben pjese ne detyrimet qytetare normale.

Ne teorine e relativitetit i madhi Ajnshtajn ka theksuar se ”Asgje nuk eshte absolute por cdo gje eshte relative.” Kurse absolute eshte se cdo gje eshte relative. Une mendoj dhe theksoj se ne teorine e punesimit “cdo kontrate me objektun dhe punesimi

---

<sup>167</sup> Neni 4 KEDNJ

<sup>168</sup> Neni 5 KEDNJ

qendron permes ofertes dhe kerkeses ne tregun e lire te punes dhe kjo eshte relative, por ajo qe eshte absolute ne kete pune dhe punesim eshte se ndalimi i skllaverise dhe roberise permes detyrimit dhe dhunes eshte absolute”.

Ne kete kontekst dhe ne kete fryme duhet pare kjo e drejte dhe kjo liri si ne aspektin e ndertimit te se drejtes nderkombetare permes akteve dhe marreveshjeve nderkombetare dhe ne aspektin e ndertimit te se drejtes se brendshme persa, perket Kushtetutes dhe legjislacionit te posacem mbrojtës te cdo shteti pjesemarres ne kete Konvente si dhe atyre shteteve qe kane radifikuar kete konvente e cila eshte bere pjese tashme e se drejtes se brendshme jo vetem te shteteve anetare por edhe me gjere.

Ne kendveshtrimin natyror pra defakto te ketij perkufizimi, objekti natyror i pergjigjet konotacioni ekstrem i shprehjes se dhunes dhe detyrimit per te kryer nje pune skllaveruese dhe roberuese ne kushtet e nje ekstremiteti i cili konsiston qe te jete dhe te kryhet jashte cdo limiti te dinjitetit njerezor. Kurse ne kendveshtrimin juridik pra dejure, objekti si dhe shkaku ligjor i saj eshte mbrojtja e marredhenieve te punesimit permes lirive dhe te drejtave te njeriut dhe shtetit te se drejtes ku spikat liria e punes dhe e drejta per pune e cila eshte nje vlere e shtuar e sistemeve demokratike ku shteti i se drejtes eshte ndertuar per mbrojtjen dhe zhvillimin e lirive dhe te drejtave te njeriut ku ne qender eshte dinjiteti njerezor.

Pare ne kete aspekt te nenit 4 te Konventes<sup>169</sup> do te verejme se kjo norme juridike ne vetvete permban nje limit te poshtem i cili nuk mund te shkelet nga askush, pra si nga punedhenesi dhe nga punemarresi kushdo qofte ai person fizik apo juridik, privat

---

<sup>169</sup> Konventa europiane e te drejtave te njeriut.

apo shteteror ne sjelljen e tij kontraktuale qofte kjo nje kontrate individuale punesimi si dhe qofte kjo nje kontrate kolektive punesimi.

Pra nga ky limit i poshtem i cili eshte vendosur ne kete dispozite do te jemi perpara ketyre rasteve vec te tjerash edhe kur ekziston, apo kur ndermerret, apo realizohet me ane te shtrengimit fizik ose psikik, nje pune e imponuar ne menyre te paligjshme dhe te mundimshme e cila ka karakter shtypes dhe shkakton vuajtje te paperligjur.

Per vec ketyre dy aspekteve kryesore qe gjejme te sanksionuar ne nenin 4 te Konventes <sup>170</sup>arsyetimi ligjor shkon pertej edhe ne aspektin tjetër te kesaj dispozite dhe pikerisht ravijejimit te pikes 3/a-b-c-d ne te cilen eshte sanksionuar kuptimi gramatikor nepermjet gjuhes laike, si dhe kuptimi juridik nepermjet interpretimit literal dhe ligjor se ne keto raste te larte permendura nuk mund te quhen si pune te imponuara pikerishte rastet e parashikuara nga keto dispozita.

Ne rastin konkret kemi te bejme me disa dispozita kalimtare te cilat na cojne ne pjesen gri te dispozites ne te cilen na tregohet se kur na paraqiten raste te tilla duhet ti neneshtrohemi perceptimit rast pas rasti duke vendosur ne peshoren juridike keto marredhenie punesimi, dy aspektet kryesore, pra lirine e punes dhe te drejten per pune.

### **Mbrojtja e marredhenieve te punesimit**

Pra rast pas rasti duke njohur mire perkufizimin dhe konceptin e tyre, na interson qe ne ndertimin e mbrojtjes do te verejme gjithmone ndalimin e pergjithshem dhe absolut te kesaj pune.

---

<sup>170</sup> Neni 4 K.N.D.NJ

Kjo vjen ne koneksitet edhe me nenin 11<sup>171</sup> te Konventes nga i cili buron e drejta e krijimit te sindikatave dhe aderimit ne to. Ne kete dispozite pra ne nenin 11 te Konventes kerkohet qe shtetet ti mbrojne te drejtat qe mundesojne ushtrimin e sukseshem te lirise sindikaliste te cilat kane per objekt dhe qellim mbrojtjen e interesave te veta , pra te interesave profesionale. Ne kete mision te sindikatave vlen per tu permendur fakti se ato kerkojne mbrojtjen e interesave profesionale te anetareve te sindikatave permes levizjes sindikaliste. Kete te drejte e siguron Konventa, ndersa shteti duhet te lejoje dhe te mundesoje organizimin dhe zhvillimin e saj. Dhe per te realizuar kete qellim anetaret e sindikatave kane te drejte qe te kerkojne qe sindikatat e tyre te degjohen. Kjo vjen permes zhvillimit te dialogut pasi nje nga tiparet kryesore te demokracise eshte menyra e zgjidhjes se problemeve ne vend permes dialogut konstruktiv, edhe i hidhur qofte, per te mos iu drejtuar dhunes, pasi demokracia lulezon fale lirise se shprehjes. Kjo gjen vend edhe ne nje menyre tjeter te sjelljes sindikaliste tek marrja pjese tek kontrata kolektive si dhe tek e drejta e realizimit te tubimeve dhe grevave per realizimin e te drejtave te tyre nepermjet tubimeve paqesore.

Per te ndertuar kete mbrojtje juridike te punesimit sindikatat nepermjet levizjes sindikaliste kane aritur ne nje stad atraktiv persa i perket organizimit adekuat te tyre ne menyre statutore dhe programore duke realizuar nje nga aspiratat e tyre kryesore qe te arrijne dhe te vendosin marreveshjen e “Tripartizmit” e cila ne themel te sajje ka mbrojtjen e marredhenieve te punesimit. Ne kete marreveshje jane pale puedhensit, punemarresit dhe sindikatat, e cila funksionon me se miri dhe eshte e misheruar edhe ne lidhjen e kontrates kolektive te punesimit.

---

<sup>171</sup> Neni 11 KNDNJ

Mbrojtja e marredhenieve te punesimit ku spikat liria e punes dhe e drejta per punesim ka gjetur nje diapazon te gjere edhe tek mendimi juridik shqiptar i cili eshte misheruar tashme ne Kushtetute, ne legjislacionin e punesimit i cili ka qene dhe eshte nje legjislacion i kodifikuar permes *Kodit te Punes*. Po ashtu mbrojte te thelle marredheniet e punesimit ne kete kontekst ka edhe permes legjislacionit te sigurimit shoqeror dhe atij shendetesor.

### **E drejta per pune**

Me zhvillimin e shoqerise shtohen edhe kerkesat per kushte sa me te mira punesimi duke kerkuar keshtu zhvillimin e nje tereni sa me te mire per realizimin e produktit qe vjen nepermjet punes dhe punesimit ligjor. Ky produkt shkon per nje jete me te mire dhe per nje jete me te mbrojtur. Kjo e beri shtetin qe duke qene perballe ketyre kerkesave te evolimit te shoqerise si dhe te zhvillimit ekonomik te cilat nisen gjithmone dhe kurdoher, nga parime demokratike, qe te kryej reforma legjislative ne favor te realizimit te kerkesave te te punesuarve.

Ne kete pikpamje e drejta per pune eshte e garantuar me Kushtetute dhe konkretisht ne nenin 49<sup>172</sup> te saj ligjvenesit ka sanksionuar se:

-1-Seicili ka te drejte te fitoje mjetet e jeteses se tij me pune te ligjshme, qe e ka zgjedhur ose pranuar vete. Ai eshte i lire te zgjedhe profesionin, vendin e punes, si dhe sistemin e kualifikimit te vet profesional.

-2- Te punesuarit kane te drejten e mbrojtjes shoqerore te punes.

---

<sup>172</sup> Neni 4 Kushtetuta e Republikes se Shqiperise

Pare ne kendveshtrimin doktrinal kushtetues verejme se ne keto dispozita kushtetuese gjen vend inkorporimi *I Konventes Europiane per te Drejtrat e Njeriut* te cilen e trajtuam me lart ne pjesen hyrese. Pra ka nje bashkim mendimesh, idesh juridike tashme te strukturuara mire te kesaj te drejte te individit per te perfituar me pune te ligjshme, e cila pervec interesit vetiak, fiton rendesi edhe nga pikpamja sociale, pasi puna si profesion eshte nje vlere edhe per kontributin qe i sjell shoqerise ne teresi. E drejta per pune dhe liria e profesionit nenkupton cdo veprimtari te ligjshme qe sjell te ardhura dhe qe nuk ka kufizime dhe afat te percaktuar, me perjashtim te rregullimeve te vecanta ligjore. Garancia qe i jep Kushtetuta individit lidhur me te drejten per pune dhe lirine profesionale, ka si qellim mbrojtjen e tyre nga kufizimet e paperligjura te shtetit. Kjo per faktin se liria e zgjedhjes dhe ushtrimit te profesionit nuk eshte vetem nje e drejte per te patur nje vend pune, por ajo duhet te kuptohet edhe si nje e drejte sociale. Gjithashtu ajo ne frymen e Konventes duhet pare edhe si nje e drejte dhe liri negative qe nuk lejon nderhyrjen ose pengimin e shtetit, gjate ushtrimit te saj. Po ashtu kjo dispozite Kushtetuese sanksionon edhe nje detyrim pozitiv te shtetit i cili duhet te angazhohet per krijimin e kushteve te pershtatshme per realizimin e nje te drejte te tille, por edhe detyrimin negative, i cili kerkon mosnderhyrjen e shtetit per te cenuar kete te drejte.

Ne kete menyre e trajton te drejten per pune edhe doktrina kushtetuese, duke theksuar se liria per pune mbrohet nga rregullimet kushtetuese.

Vec Kushtetutes kjo e drejte mbrohet edhe permes Kodit te Punes persa i perket si dispozitave te pergjithshme te ketij kodifikimi, po ashtu edhe persa i perket dispozitave te posacme te tij.



### **Mbrojtja per shkak te races, prejardhjes, gjinise, besimit dhe bindjes politike.**

Permes Kodit te Punes<sup>173</sup> gjejme nje mbrojtje te posacme si persa i perket punemarreseve te gjinise femerore, po ashtu edhe te te miturve. Nje vend te vacante ze mbrojtja kundrejt mosdiskriminimit te punemarresit per shkak te races, prejardhjes, gjinise, besimit dhe bindjes politike. Kjo e parashikuar ne nenin 146 e vijues te K.Punes<sup>174</sup> kur punedhenesi zgjidh kontraten e punesimit pa shkaqe te arsyeshme si dhe per shkak te ketyre motiveve gjykata vendos duke e detyruar punedhenesin per te demshperblyer punemarresin deri ne 12 paga mujore etj. Po ashtu ne K.Punes jane percaktuar dhe kushtet e vendit te punes si dhe orari i punes si dhe shperblimet qe vijne si rezultat i punes jashte orarit zyrtar si dhe shume qendrimet qe mbrojne te drejten negative sipas lidhjes se kontrates individuale te punesimit, apo te kontrates kolektive te punesimit.

Gjithcka qe i perket kontrollit ligjor qe i behet marredhenieve te punesimit rast pas rasti, ligjvenesit nepermjet vellimit te tagreve qe parashikon K.Punes, ia ka deleguar kete te drejte Gjykates e cila vihet ne levizje permes disponibilitetit nga subjektet e ndryshme te cilat jane me cilesine e punedhenesit apo punemarresit. Ne kete rast gjykata permes diskrecionit te saj vendos nese jemi perpara shkeljeve ligjore apo mosrespektimit te dispozitave urdheruese te ligjit me veprim apo me mosveprim te paleve ndergjyqese.

### **Mbrojtja e lirise sindikale.**

Nje mbrojtje tjeter te punesuarit gjejne ne dispozitat kryesore kushtetuese. Kjo e parashikuar ne nenin 50 te Kushtetutes<sup>175</sup> i cili thote:

---

<sup>173</sup> Kodi I punes se R SH

<sup>174</sup> Neni 146 i K.P

<sup>175</sup> Neni 50 i Kushtetutes

Te punesuarit kane te drejte te bashkohen lirisht ne organizata sindikale per mbrojtjen e interesave te tyre te punes.

Ky inters i ligjshem, pra interesi i punes gjendet i mbrojtur permes lirive dhe te drejtave te njeriut dhe garancive kushtetuese. Kjo e pare dhe analizuar nga ana ime ne korpusin e *Konventes* si dhe ate te *Kushtetues* ku gjendet e lidhur analitikisht si nje strukture e pandashme mbrojtja e kesaj te drejte negative edhe ne menyre te organizuar nga sindikatat ne levizjen e tyre sindikaliste perballe shkeljeve ligjore me mosveprim apo me veprim te strukturave shteterore nepermjet te drejtes positive.

Kjo e parashikuar edhe ne te drejten e lirise sindikale ku nepermjet organizimit dhe pjesmarrjes ne to subjekte te ndryshme fizike apo juridike bashkojne interesat e tyre profesionale, duke pasur keshtu nje akses ne organizimin e grevave per mbrojtjen e te drejteve te tyre.

Kjo e drejte pervec Konventes eshte e parashikuar dhe e sanksionuar edhe ne nenin 52 te Kushtetutes<sup>176</sup> ne te cilen thuhet ne menyre esplicite se:

-1-E drejta e te punesuarit per greve qe ka te beje me marredheniet e punes, eshte e garantuar.

-2- Kufizime per kategori te vecanta te punesuarish mund te vendosen me ligj per t'i siguruar shoqerise sherbimet e nevojshme.

Ne keto dispozita kushtetuese pervec te drejtes se greves jane percaktuar edhe kufizimete e disa personave fizik apo juridik qe nuk mund te marin pjese dhe te organizohen ne organizata sindikale dhe ne levizjen sindikaliste. Kjo eshte e percaktuar

---

<sup>176</sup> Neni 52 I Kushtetutes

ne ligje te posacme te organizimit dhe funksionimit te disa institucioneve Kushtetuese dhe te disa institucioneve te posacme.

Pra ne kete kuader e drejta kushtetuese dhe doktrina kushtetuese ka interpretuar me kujdes dhe ka trajtuar rast pas rasti sjelljen kushtetuese te ketyre subjekteve ne funksion te garantimit kushtetues te te drejtes se greves si dhe te sigurimit kushtetues persa i perket sherbimeve te domosdoshme qe ka nevojte shoqeria demokratike ne respektrimin e te drejtave ligjore dhe kushtetuese.

Ne respektrim te Konventes dhe te Kushtetues, pra ne kete fryme harmonie juridike, ligjvenesit ka parashikuar dhe ka sanksionuar keto parime edhe ne legjislacionin e se drejtes se greves dhe tubimeve paqesore ku ka percaktuar ne menyre procedural kete te drejte te mbrojtjes se te drejtave te punesimit.

### **E drejta e sigurimeve shoqerore.**

Nje mbrojtje tjeter marredhenia e punesimit gjen edhe nepermjet nenit 52 te Kushtetues e cila thote

-1- Kushdo ka te drejten e sigurimeve shoqerore ne pleqeri ose kur eshte i paafte per pune, sipas nje sistemi te caktuar me ligj.

-2- Kushdo, kur mbetet pa pune per shkaqe te pavarura nga vullneti i tij dhe kur nuk ka mjete te tjera jetese, ka te drejten e ndihmes ne kushtet e parashikuara me ligj.

Pra permes ketyre dispozitave kushtetuese i eshte rezervuar nje mbrojtje e posacme te punesuarve permes nje punesimi te ligjshem qe me ligj te posacem dhe konkretisht ate te skemes se sigurimeve shoqerore dhe shendetesore te kene mundesi qe nga pagesa ne vite te ketyre kontributeve i cili lind nga puna dhe punesimi i ligjshem te perfitoj nje

nga llojet e pensioneve te parashikuara nga ky legjislacion i posacem ne kohen e mbushjes se moshes per pension. Po ashtu nepermjet ketyre dispozitave nje mbrojtje te posacme marrin edhe subjektet te cilet kane humbur aftesine shendetesore per punesim nga skema e mbrojtjes se sigurimeve shoqerore permes ketije legjislacioni.

Ne kete arene juridike ne respektim te dispoziteve Kushtetuese si dhe Konventes te cilat jane nje preambul e legjislacionit te posacem, nisur dhe nga qellimi se puna, punesimi dhe produkti i punes kane dhe karakter social, atehere ligjvenesit ka misheruar nje solidaritet brezash ne skemat e sigurimeve shoqerore dhe atyre shendetesore si dhe atyre te ndihmes ekonomike dhe perkrahjes ekonomike ne kufije te nje asistence sociale per ti ardhur ne ndihme njerezve dhe shtresave ne nevoje permes nje page sindakale per te permbushur nje minimum jetik.

Pra ne kete menyre mbyllet tashme edhe limiti i lartem i ketyre dispozitave persa i perket mbrojtjes se marredhenieve te punesimit.

### **Te drejtat dhe detyrimet ne kuader te globalizimit**

Limiti juridik do te gjeje nje kufi hapsinor edhe ne te *Drejten Europiane* te *Globalizimit te se Drejtes* persa i perket te *Drejtes se Migrimit* si dhe te aderimit te *Shqipërisë ne Bashkimin European*.

Pra ne kete hapësire europiane lindin te drejta dhe detyrime ekstra komunitare, komunitare dhe europiane te cilat duhet te integrohen ne nje pakete te perbashket ligjore ne kete kuader per te arritur mireqenien individuale, familjare, sociale edhe persa i perket mireqenies Globale e cila do te vije nepermjet solidaritetit te shoqerive demokratike dhe shteteve anetare ne respektimin e te drejtave dhe lirive te individit te cilat jane ne themel te shtetit te se drejtes.

Ne zhvillimin ekonomik, politik, juridike shoqeri te caktuara jane zhvilluar ne menyra te ndryshme dhe dikush me shpejt dhe dikush me me ngadale. Kjo ka ndodhur jo vetem per kushtet e ndryshme shoqerore, historike dhe gjeografike apo klimaterike qe ato jane zhvilluar, por ka ardhur mbi te gjitha nga resurset dhe burimet njerezore te cilat jane potencuar nepermjete energjive positive njeresore, mendimit pozitiv, veprimit pozitiv, ndjenjes positive duke krijuar permes ketij solidariteti te padiskutueshem nje klime gjithmone positive ne progresin shoqeror .

Pra zhvillimi ka ardhur permes egos njerezore ne krijimin e vetvetes, familjes, shoqerise, demokracise dhe shtetit te se drejtes, clirimit te saj, pra te egos nepermjet, besimit, fese filozofise, politikes, ekonomise, jurisprudence, shkences, teknikes, artit, sportit dhe gjithckaje te bukur ne kete jete.

Por kryesisht zhvillimi njerezor sipas meje ka ardhur nga clirimi kryesor i egos njerezore ne clirimin dhe ngritjen shpirtore permes besimit te zoti si dhe clirimit dhe ngritjes mendore permes shkences dhe teknikes.

Jo rastesisht formimi njerezor ka ardhur permes se drejtes natyrore dhe te drejtes positive.

Per ta vertetuar kete pohim po e mbyll me nje shprehje se:

-Jeta eshte levizje dhe levizja eshte jete!

Ne kete jete njeriu do te gjendet permes fese dhe shkences te cilat do te jene ne nje raport te tille bashkejetese ne jeten njeresore e ne nje binom te tille se:-

Shkenca pa fene eshte si nje e cale!

Ndersa

Feja pa shkencen eshte si nje e verber!

## **KAPITULLI VI: ANALIZA 3**

### **6.1. LIGJI, E DREJTA, DREJTESIA.**

**-Permes disponibilitetit dhe diskrecionit.**

**-Ne mbrojtje te lirive dhe te drejtave te njeriut.**

**-La legge e uguale per tutti!**

-Eshte kjo nje aksiome juridike sa e vjeter dhe e re per vete faktin se i ka rezistuar kohes dhe metronomit te saj juridik (koha ndryshon) ne qendrushmerine dhe sigurine juridike si nga forma dhe permbajtja.Pasi eshte nje“idiome juridike “e cila ka ne vetvete disa pikpyetje te cilat kerkojne pergjigje ne fokusin juridik permes nje elaborimi ne nje kendveshtrim bashkekohor te koncepteve te se drejtes.Duke njohur njekoheisht se cilat jane funksionet e se drejtes ne epoken bashkekohore, dhe cilat jane teorite moderne juridike.Duke kerkuar zbatimin e tyre ne implementimin e normave juridike ne nje sistem ballafaques vlerash krahasuese te nocioneve dhe kategorive juridike te shkences juridike bashkekohore ne funksion te interpretimit te shkences juridike bashkekohore per te arritur qellimin final te saj “Dhenien e Drejtesise “, e cila eshte fitorja me e madhe e te gjitha koherave te njerzimit.

Nga sa me siper duke interpretuar kete shprehje pra:

- La legge e uguale per tutti!

Lindin keto pyetje:

- a) Ligji eshte i barabarte per te gjithë?
- b) Ligji eshte i njejte per te gjithë?
- c) Ligji eshte afersisht i barabarte per te gjithë?

Per ti dhene pergjigje ketyre pyetjeve une i referohem gjithmone shprehjes ne te drejten "Romake" ku thuhet: "Logjika e juristit eshte afersisht e barabarte me logjiken e matematicienit."Pra mes ketyre dy logjikave ka nje lidhje sepse nese logjika e matematicienit sherben per te interpretuar matematiken dhe ligjet e saj nga ana tjetër logjika e juristit sherben per te interpretuar jurisprudencen dhe ligjet e saj. Duke pranuar kete koneksitet pra kete lidhje shkakesore jemi perpara logjikes formale e cila na ndihmon te hedhim drite mbi rendesine e perdorimit te kesaj logjike ne keto lloje shkencash. Nese shkenca e matematikes eshte nje shkence ekzakte, logjika e matematicienit e ka cuar ate, permes epilogut te sajë ne nje shkence te hapur dhe jo ekzakte, ne lidhje me integralin  $(-\infty; +\infty)$  minus infinit ne plus infint dhe ne perfundimet e disa ushtrimeve dhe problemave te cilat dalin ne perfundim afersisht te barabarta ose me e madhe ose me e vogel etj. Pra eshte kjo logjike e cila i jep pergjigje dhe zgjidhje ketyre problemeve, ne konceptin absolut se  $1+1=2$ , ne konceptin relativ se  $5:3$  afersishte e barabarte me  $1,7$  keto si shembull mes konceptit te absolutes dhe realistes. Pra logjika e matematicienit e ka cuar shkencen ekzakte ate te matematikes nga absolutja tek ajo relativja.

Atehere, lind pyetja:

”Po jurisprudenca, pra shkenca juridike sipas logjikes formale te juristit ne funksion te kesaj shprehje cfare eshte? Pra del qarte se nuk eshte nje shkence ekzakte dhe absolute por relative sepse drejtesia eshte e verteta ne dinamike. Dhe konkretisht nese do ti permbahemi pershtatjes dhe konotacionit te shprehjes, duke arritur ne marveshjen e fjales se:”Ligji eshte i barabarte per te gjithë”! Atehere do te kemi nje pergjigje se kjo eshte absolute. Nese do ti permbahemi pershtatjes dhe konotacionit te shprehjes, duke arritur mareveshjen e fjales se:”Ligji eshte i njejte per te gjithë”! Atehere do te kishim nje pergjigje se kjo eshte relative. Nese do ti permbahemi pershtatjes dhe konotacionit, duke arritur ne mareveshjen e fjales se:”Ligji eshte afersisht i barabarte per te gjithë”! Atehere do kishim nje pergjigje se kjo eshte midis absolutes dhe relatives.

Kjo prudence juridike na ndihmon ne sot pasi gjendemi ne nje pluralizem juridik bashkekohor, ku rikonceptimi i se drejtes vjen permes qartesis se saj ne mbrojtje te lirive dhe te drejtave te njeriut, ne globalizmin e se drejtes, apo te se drejtes se globalizuar ne kontekstin tjetër:

“La legge e uguale per tutti costituzioni “.

### **Dijet ne fushen e se drejtes**

Konceptet ligj, e drejta, drejtesia, permes disponibilitetit dhe diskrecionit, ne mbrojtje te lirive dhe te drejtave te njeriut do te shprehen dhe do te trajtohen ne nje menyre te bashkebisedimit ligjor mes juristash, nepermjet nje procesi te dijeve historike te se drejtes, pra dijeve permbajtesore te cilat ngrihen mbi nivelin e maturise (natyrisht kjo shprehje nuk eshte e mjaftueshme) dhe zgjerohet vazhdimisht me ecurine e studimit ku ajo ndahet me pas ne dy lloje:



-1- Dijet e pergjithshme, ne kuptimin e nje rrjeti strukturues te hapësires dhe kohes qe mundeson orientimin historik te se drejtes e cila sherben si nje strukture baze per pasurimin dhe koncentrimin e vazhdueshmerise.

-2-Dijet speciale, ne ato fusha te se drejtes ne te cilat punohet si nje student i perparuar dhe pastaj si bashkepunetor shkencor etj.

Ne kete kontekst zoterimi ne mase te mjaftueshme i lendes eshte i mundur vetem nepermjet nje sistemimi te dijeve te shtrira rregullisht ne kohe dhe ne hapësire dhe nepermjet te kuptuarit te nje strukturimi ndihmes dhe nxites per punen shkencore.

Ketij i pergjigjet fakti qe, historia e se drejtes eshte ndare tashme ne menyra te ndryshme gjate historise se shekujve si pershembull, ne historine e shtetit dhe te se drejtes, ne historine e institucioneven, ne historine e filozofise te se drejtes, ne historine e se drejtes kushtetuese, ne historine e se drejtes civile, penale administrative, familiare, tregtare e ne shume disiplina te se drejtes ne pergjithesi e ne vecanti.

Vete ky proces ndarjeje ne dinamike eshte nje fenomen relevant ne historine e se drejtes.

Ai eshte shprehje e zgjerimit te konceptit historik te se drejtes dhe e ndryshimeve ne interpretimin qe i behet asaj nga juristet.

### **Studimi i historise se se drejtes**

Studimi i histories te se drejtes, si nje studim akademik nga kendveshtrimi i nje juristi ne nje veshtrim krahasues, ka nevoje per dije te llojeve te ndryshme, se pari si nje

kusht dhe pastaj si nje bashkeshoqeruese qe vjen si vlere e shtuar dhe duke marre nuance gjithmone e me te vecante dhe te posacme, pasi jurist nuk te ben vetem shkolla por dhe prerja, prirja dhe kultura qe ka individi ne potencimin e dijeve ne ngarkesen positive qe mbart neuroni i dijes ne raport me vetveten dhe shoqerine ku ai jeton per te shprehur vlerat sasiore dhe cilesore ne interes te prosperitetit dhe progresit .

### **Diskutimi sqarues**

Ky proces eshte i lidhur domozdoshmerisht edhe me diskutimin sqarues, me vete teorine e ketij procesi dinamik, teorine e shkences se histories te se drejtes si nje proces njohjeje nepermjet studimit i cili kuptohet qe eshte depertimi thelbesisht i pavarur, kritik e rikonfirmues i kryer mbi bazen e dijeve te arritura ne procesin e perpunimit te nje materije te percaktuar shkencerisht, te permyllur, te zgjerueshme dhe qe ka nje permbajtje te paraqitshme e te korrigjueshme. Procesi i te mesuarit, ne kuptimin e pervetesimit te rrethanave te hulumtuara dhe te hulumtimit aktiv e pozitiv, eshte parimisht i pafund. Cdo permyllje a perfundim i ketij procesi mund te jete vetem i vullnetshem dhe nuk mund te nenkuptoje qe eshte pervetesuar gjithcka sepse shkenca dhe te mesuarit jane te lira ne drejtim te dijeve te orientuara, dijeve teknike dhe dijeve plotesuese.

### **Roli i juristit**

Roli i juristit dhe i nje komuniteti juristash te formuar, profesionisht te dallueshem ne krijimin e elitave ne kete fushe eshte i rendesise se vecante ne lidhje me perdorimin e forces se logjikes ne inetpretimin dhe arsyetimin ligjor te se drejtes ne nje shoqeri te hapur dhe demokratike, te cilet i bejne te mundur subjekteve te ndryshme qe te zbatojne ligjin ne nje shtet te se drejtes, ku kontrata kryesore eshte ajo mes lirive dhe te drjetave

te njeriut dhe shteti te se drejtes e sanksionuar ne Kushtetute, ku permes detyrimeve dhe te drejtave subjektet fizike apo juridike i lind detyrimi ligjor i respektimit te ligjit dhe shtetit te se drejtes i lind detyrimi te mbroj lirate dhe te drejtat e njeriut pasi kjo eshte infrastruktura e sigurise juridike te nje shoqerie te lire dhe demokratike.

### **Siguria juridike**

Doktrina e se drejtes kushtetuese ka pranuar se siguria juridike eshte nder elementet thelbesore te shtetit te se drejtes. Kjo siguri presupozon vec te tjerash besueshmerine e qytetareve tek shteti dhe pandryshueshmerine e ligjit per marredheniet e rregulluara. Besueshmeria ka te beje me faktin se qytetari nuk duhet te shqetesohet vazhdimisht per ndryshueshmerine dhe pasojat negative te akteve normative qe cenojne dhe perkeqesojne nje gjendje te vendosur me akte te meparshme. “Nuk do te kishim te benim me nje rast te garantimit te besueshmerise ne sistemin e normave juridike nese siguria lidhur me nje shtete te caktuar nuk mund te justifikohet dhe te mbrohet materialisht”. Duke afirmuar parimin e sigurise juridike dhe te elementeve kryesor e perberes te saj, *Gjykata Kushtetuese*<sup>177</sup> ve ne dukje se ky parim nuk mund te prevaloje ne cdo rast. Kjo do te thote se nese paraqitet rasti qe nje rregullim ligjor ndryshe i nje marredhenie ndikohet drejtperdrejt nga nje interes publik, me te gjitha elementet e tij thelbesore, ky interes natyreshem do te kete perparesi ndaj parimit te sigurise juridike.

Ne kete kontekst ky parim themelor i rendesishem gjen misherim ne *nenin 17 te Kushtetutes*<sup>178</sup> ku percaktohet ne menyre tasksative se kufizimi duhet te jete ne perpjestim me gjendjen qe e ka diktuar ate. Pra keto kufizime nuk mund te cenojne thelbin e lirive dhe te te drejtave dhe ne asnje rast nuk mund te tejkalojne kufizimet e

---

<sup>177</sup>V.GJ.K 47/2012

<sup>178</sup> Neni 17 I Kushtetutes

parashikuara ne Konventen per te Drejtat e Njeriut<sup>179</sup>. Ne vijim te kesaj per *Gjykatën Kushtetuese* paraqet rendesi te vecante ceshtja nese dispozita ligjore, objekt kontrolli, mbeshtetet ose jo ne kriteret kushtetuese te kufizimit te te drejtave dhe lirive themelore parashikuar nga *neni 17 i Kushtetutes se Republikes se Shqiperise*. Per te justifikuar ne pikpamje te Kushtetutes, prekjen e te drejtave dhe lirive themelore te individit, eshte e domosdoshme te permbushen disa kushte sic jane ato qe kufizimi te realizohet me ligj, te jete bere ne mbrojtje e te drejtave te te tjereve, te jete ne perpjestim me gjendjen qe e ka diktuar, si dhe te mos cenoje thelbin e te drejtave dhe te lirive themelore. Pra kjo dispozite kushtetuese kerkon vleresimin e domosdoshmerise se nderhyrjes ligjore te shtetit, ne varesi te natyres se te drejtes, te karakterit te interest public qe duhet te mbrohet, te rrethanave konkrete qe e diktojne nje nderhyrjen ne minimum dhe sa me pak te demshem nga pikpamja e te drejtave te njeriut.

### **Mbrojtja e barabarte me ligj**

Klauzola e mbrojtjes se barabarte me ligj ne thelb perben nje kufizim per shtetin ne procesin ligjvenes, duke e detyruar ate qe ne nje kuptim te pergjithshem njerez te vacanet apo grupime njerezore me karakteristika te ndryshme t'i trajtoj ne menyre te barabarte.

Megjithate, favorizimi absolut i individit ne raport me shtetin ne kete drejtim pothuajse do ta pamundesonte veprimtarine ligjvenese te shtetit, sepse do te bente te pavlefshem pjesen me te madhe te legjislacionit. Cdo veprimtari ligjvenese ka ne themel te saj projektimin e rrugezgjidhjeve te ndryshme per situatat qe paraqiten ne jeten e nje shoqerie te caktuar. Ne kete kuader ne menyre te domosdoshme e te pashmangshme do

---

<sup>179</sup> Konventa per te Drejtat e Njeriut

te behen edhe klasifikime te individeve ne grupime perkatese. Per rrjedhoje, ne aspektin objektiv, eshte e pamundur qe disa njerez te mostrajtohen ne menyre te ndryshme nga njerez te tjere ten je grupimi tjetër.

Sidoqofte, parimi kushtetues i mbrojtjes se barabarte me ligj kerkon nga ligjvenesit qe detyrimisht te vendose disa standarte ballancimi, si ne raport shtet-individ (apo grupim shoqeror), ashtu edhe ne raportet e individeve apo te individeve apo te grupimeve shoqerore midis tyre. Si rregull i pergjithshem, ne dallim me klauzolen e procesit te rregullt ligjor, ku peshimi i balances ku ne cdo rast interpretohet ne favor te individit apo te grupimit shoqeror perkates, ne klauzolen e mbrojtjes se barabarte me ligj, peshimi i balances interpretohet ne favor te shtetit. Kjo do te thote se shteti, domethene ligjvenesit dhe ekzekutori, eshte i lire te projektoje drejtimet e zgjedhjet qe cmon te nevojshme e te pershtatshme, duke bere dallimet e duke i trajtuar njerezit ne menyra te ndryshme. Megjithate, keto trajtime te ndryshme nuk duhet te kalojne caqet racionale e te pranueshme e te prishin balancen.

Parimi kushtetues i mbrojtjes se barabarte me ligj kerkon qe ligjvenesit te beje klasifikime te domozdoshme e te perjashtojte klasifikimet arbitrare e te dyshimta, por dallimet qe behen ndaj individeve apo grupimeve te caktuara ne raport me te tjeret jane te pranueshme per aq sa mbajne lidhje te arsyeshme me objektivat ligjitime te shtetit te cilat sidoqofte nuk mund te bien ndesh me te drejtat themelore te njeriut.

Si rrjedhoje e drejta njerezore per t'u trajtuar si te barabarte prej ligjit do te vihet ne vend duke shpallur antikushtetues cdo dispozite ligjore qe bie ndesh me parimet baze kushtetuese permes nje procesi te rregullt te kontrollit kushtetues nga gjykata kushtetuese e cila ka diskrecionin kushtetues qe te marre ne shqyrtim dhe te vendosi per

kerkesat nepermjet disponibilitetit qe kane subjekte te ndryshme fizike apo juridike qe i drejtohen kesaj gjykate per tu shprehur ne lidhje me objektin e pakushtetuesmerise se nje dipsozite te caktuar ligjore nepermjete te ciles pretendohet se cenon interesat e ligjshme te kerkuesve duke kerkuar nje rregullim te ri juridik te marredhenieve mes shtetit dhe individit apo nje grupimi individesh si dhe te individeve mes njeri tjetrit pasi asnje nuk mund te ve ne dyshim dhe as mund te kundershtoj qellimin social te ligjit edhe nepermjet ndonje pretendimi eventual sipase te cilit shteti mund te gjeje rruge te tjerra me te pershtashme e me te efektshme ne arritjen e ketij qellimi, nuk ka baze ta vendos ne diskutim dhe ne dyshim kushtetuesmerine e ligjit, nga ky kendveshtrim si jurist respektoj parimin se gjykata flet dhe shprehet vetem permes urdherave dhe vendimeve dhe cdo koment tjetër është i tepert pasi metej i mbetet ligjvenesit te transformoje kete jurisprudence te akteve normative ne perputhje me parimet kushtetuese te njohura dhe te gjithperfshira tashme ne te drejten e brendeshme dhe ne te drejten nderkombetare.

Nisur nga ky fakt dalim ne sanksionimin kushtetues qe ligjvenesit ka deskriptuar ne *nenin 16 te Kushtetutes*<sup>180</sup> se te drejtat e lirite themelore, si dhe detyrimet e parashikuara ne Kushtetute per shtetasit shqiptare vlejne njelloj edhe per te huajt sepse nuk ka baza per te supozuar se dispozita te caktuara, dhe aq me teper e gjithë konventa jane pjese e te drejtes se brendeshme dhe se drejtes komunitare. Ne kete rast ne gjykimin qe mund te beje qofte Gjykata Kushtetuese, qofte Gjykate e Stasburgut apo e Lizbones do te ishin ne aspektin e vleresimit te pajtuesmerise me ligjin te nje akti i cili kufizon nje liri qe rrjedh nga konventa ne koherence juridike gjithmone ne pajtuesmerine e tij me te drejtat e njeriut te garantuara ne Konvente. Por asnjehere mbrojtja e te drejtave te

---

<sup>180</sup> Neni 16 i Kushtetutes

njeriut nuk mund te vij si atribut i pengeses ne realizimin e qellimit te Komunitetit. Nuk mund te nenvleftesoj efikasitetin e se drejtes komunitare ne rendet juridike te shteteve qe hyjne ne perberjen e saj sepse po ti rreferohemi Konventes eskluzivisht ne cilesine e direktivave per mbrojtjen e te drejtave te njeriut, qe ndihmojne ne percaktimin e permbajtjes se parimeve themelore te se drejtes komunitare sepse mbrojtja e te drejtave te njeriut nuk mund te perbej pengese ne realizimin e qellimit te Komunitetit. Sepse efikasitetin dhe unitetin e se drejtes komunitare si dhe rendesia e parimeve komunitare ne kete raport mund te gjykohen vetem nen driten e se drejtes komunitare. Ato nuk mund te vihet ne diskutim duke argumentuar se jane ne kundërshtim me te drejtat themelore te njeriut ne kushtetuten e shteteve anetare.

E drejta per tu drejtuar gjykates eshte nje nga aspektet e te drejtes per shqyrtim, e sanksionuar ne *nenin 42 te Kushtetutes*<sup>181</sup>. Kjo e drejte kushtetuese, nder te tjera, ka perqellim te garantoj shtetasin nga cdo veprim qe u shkakton cenim te te drejtave te tyre pa perjashtuar rastet kur cenimi vjen nga ndonje akt i administrates shteterore. Shteti i se drejtes presupozon qe cdo nderhyrje e autoriteteve ekzekutive ne te drejtat e individit apo te personave juridike, duhet te jete objekt i nje kontrolli efektiv nga nje organ qe ofron garantimin e pavaresise dhe paanesise gjate procesit te shqyrtimit te kerkeses. E drejta per t'iu drejtuar gjykates (e drejta e aksesit), nenkupton te drejten qe ka cdo individ per te ngritur padi ne nje gjykate qe ka juridiksionin e plote per te zgjidhur ceshtjen. Pra e then ndryshe objekti i padise per tu shqyrtuar eshte permes disponibilitetit te paditesit dhe diskrecionit qe ka gjykata kopetente per te shqyrtuar brenda nje afati te arsyeshem dhe ligjor duke dhene nje vendim te drejt te bazuar ne prova ne fakte dhe ne ligj.

---

<sup>181</sup> Neni 42 I Kushtetutes

Ne kete kendveshtim dua te theksoj se e drejta kerkohet proceduralisht dhe materjalisht qe do te thote se nga ana subjektive dhe ana formale e dispozitave te ligjit procedural civil, K.Pr.C<sup>182</sup> cakton rregulla te detyrueshme, te njejta, te barabarta, per gjykimin e mosmarreveshjeve civile e te mosmarreveshjeve te tjera te parashikuara ne kete Kod e ne ligje te vecanta.

Gjykata ne kete rast nuk mund te refuzoje te shqyrtoje dhe te jape vendime per ceshtjet qe i paraqiten per shqyrtim, me arsyetimin se ligji mungon, nuk eshte i plote, ka kunderthenie ose eshte i paqarte.

Pasi vetem palet mund te vene ne levizje gjykatën per fillimin e nje procesi gjyqesor, pervec kur ligji parashikon ndryshe.

Palet jane te lira qe ne cdo kohe te terheqin padine, por gjithmone perpara shuarjes se saj per efekt gjykimi ose ne baze te ligjit.

Edhe ne keto raste perseri kemi kufizime te aksesit per ngritjen e padise pasi nje person fizik i mitur nuk mund te ngre padi, po ashtu edhe nje person i cili nuk ka zotesi per te vepruar nuk mund te ngre padi, por ata marrin pjes ne gjykim civil vetem nepermjet perfaqesuesit ligjor i cili ushtrone te gjitha te drejttat procedurale sipas dispozitave qe regullojne zotesine e tyre.

Pra ligjvenesit ka percaktuar ne kete rast dispozita ndaluese dhe frenuese per te realizuar te drejten procedural civile.

Po ashtu ne ushtrimin e te drejtes se ngritjes se padise ligjvenesit pervec parimit te pergjithshem qe i ka dhene akses cdo personi fizik apo juridik i cili nuk ka ndalime, i ka

---

<sup>182</sup> Kodi I Procedures Civile



dhene te drejte qe te paraqesi padi edhe perfaqesuesi ligjor i paditesit apo avokati i tij me prokure duke shprehur qartazi kete lejim si tager ne prokuren e tije te posacme.

Ne kete rast kemi dispozita lejuese te cilat garantojne nga pikepamja procedural realizimin e kesaje te drejte.

Pra del qartazi edhe nje here se edhe pse ligji eshte i barabarte per te gjithë, subjekte te ndryshme kane te dreejta te ndryshme edhe pse perpara ligjit te gjithë jane te barabarte.

Po ashtu dispozitat procedural te K.Familjar percaktojne ne menyre te shprehur dhe qarazi se padia per zgjidhjen e martesës mund te ngrihet nga te dy bashkeshortet si dhe nga sejcili vec e vec, por asnjehere nga perfaqesuesi i tyre ligjor apo avokati ne fjale pasi eshte nje e drejte eskuzive vetem e ketyre subjekteve te cilet kane lidhur martesën dhe kerkojne qe ta zgjidhin ate si defakto dhe dejure.

Po ashtu ne keto dispozita te *K.Familjes ne nenin 2*<sup>183</sup> te tije eshte percaktuar se prinderit, organet kopetente dhe gjykatat, ne vendimet dhe veprimtarine e tyre, duhet te kene si considerate paresore interesin me te larte te femijes. Pra ky interes prevalon mbi cdo interes tjeter te ligjshem.

Edhe ne *K.Pr.Penale*<sup>184</sup> jane percaktuar ne menyre taksative nga ligjvenesit detyrat e legjislacionit procedural penal si dhe respektimi i normave procedural perpara nje gjykate te pa anshme dhe te pavaruer e cila vendos ne baze te ligjit dhe jep vendim ne baze te provave.

---

<sup>183</sup> K.Familjes ne nenin 2

<sup>184</sup> Kodi I Procedures Penale

Ky legjislacion procedural penal ka per detyre te siguroj nje procedim te drejte, te barabarte e te rregullt ligjor, te mbroje lirite personale dhe te drejtat e interesat e ligjshme te shtetasve, te ndihmoje per forcimin e rendit juridik dhe zbatimit te Kushtetutes dhe te ligjeve te shtetit.

Ne keto dispozita procedural jane caktuar rregullat per menyren e ushtrimit te ndjekjes penale, te hetimit dhe te gjykimit te veprave penale, si dhe te ekzekutimit te vendimeve gjyqesore te cilat jane te detyrueshme per subjektet e procedimit penal, per organet shteterore, personat juridik dhe shtetasiot.

Edhe ne keto dispozita ligjvenesit ka percaktuar ne menyre taksative se subjete te ndryshme nuk jane te barabaret perpara ligjit dhe konkretisht te miturit, grate, ato shtatezene e tje nuk mund te jene te barabarte perpara ligjit me subjektet e tjera te veprave apo kundravajtjeve penale si persa perket moshes, persa perkete pergjegjesise penale, seksit, gjinise dhe statusit juridik.

Po ashtu ne keto dispozita urdheruese jane marre parasysh ne menyre eksplicite se per vepra penale qe ndiqen kryesisht, te drejten e ngritjes se akuzes e ka prokurori. Nersa per ato vepra penale qe parashikohen ne *nenin 59 K.Pr.P* te drejten e nritjes se akuzes e ka i demtuari akuzues. Kurse per ato vepra penale te parashikuara nga *neni 284 K.Pr.P*, ndjekja penale mund te filloje me ankimin e te demtuarit i cili mund ta terheq ate ne cdo faze te procedimit.

Gjithashtu vlen per tu permendur se nje hapesire te mjaftueshme procedural ne keto dispozite te *nenit 61 e vijues te K.Pr.Penale*<sup>185</sup> ka akses dhe padia civile ne procesin penal te cilin e ngre ai qe ka pasur deme nga vepra penale ose trashegimtare e

---

<sup>185</sup> K.Pr.Penale

tij etj si kujdestari, perfaqesuesi ligjor dhe cdo person qe ka interes te ligjshem nga lidhja mes vepres penale dhe demtimeve si pasoje e saj.

Pra edhe ne keto dispozita subjekte te ndryshme kane te drejta te ndryshme dhe detyrime ligjore te ndryshme.

Ne kete kontekst ligjor dhe kushtetues Gjykata Kushtetuese ka interpretuar *nenin 18 te Kushtetutes*<sup>186</sup> duke u shprehur se: "Barazia ne ligj dhe para ligjit nuk do te thote qe te kete zgjidhje te njellojta per individe ose kategori qe jane ne kushte objektive te ndryshme. Barazia para ligjit dhe ne ligj presupozon barazine e individeve qe jane ne kushte te barabarta," si dhe "vetem ne raste perjashtimore dhe per shkaqe te arsyeshme objektive mund te perligjet trajtimi i ndryshem i kategorive te caktuara qe perfitojne nga kjo e drejte".

Asgje nuk humbet ne jete pasi cdo gje shnderohet, nga nje gjendje ne nje gjendje tjeter.

E marre kjo shprehje si preambul e cdo shkence, ajo eshte e njejte edhe per shkencen juridike e marre ne aspektin krahasues, e cila e vendos ligjin, te drejten dhe drejtesine si tri kordinate te rendesishme dhe thelbesore per regjime juridike bashkohore ne funksion te shtetit te se drejtes dhe lirive themelore te individit duke krijuar "sisteme semafor te se drejtes" ku ajo qe ndalohet nuk lejohet, ku ajo qe lejohet nuk ndalohet dhe ku ajo qe lejohet lejohet dhe ajo qe ndalohet ndalohet.

Ketyre tri koordinateve duke i shtuar dhe koordinaten e katert ne hapesire e cila eshte koha, e ben njerezimin te punoj per kohen dhe kohen qe te punoje per njerezimin ne funksion te "amendamentit te kohes" i cili eshte brezi i ri qe do te paguaj faturen e

---

<sup>186</sup> Neni 18 I Kushtetutes

ndryshimeve pasi cdo ndryshim ka nje pasoje te ciles i pergjigjet nje fature ne thonjeza te reticencen juridike ne trashegimine e kultures juridike.

## **6.2. Lirite dhe te Drejtat e Njeriut Flasin Shqip.**

### **Preambula**

Ne populli Shqiperise, krenar dhe te vetedijshem per historine tone, me pergjegjesi per te ardhmen, me besim tek Zoti dhe/ose vlera te tjera universale, me vendosmeri per te ndertuar nje shtet te se drejtes, demokratik e social, per te garantuar te drejtat dhe lirite themelore te njeriut, me frymen e tolerances dhe te bashkejeteses fetare, me zotimin per mbrojtjen e dinjitetit dhe te personalitetit njerezor, si dhe prosperitetin e te gjithë kombit, per paqen, mireqenien, kulturen dhe solidaritetin shoqeror, me aspiraten shekullore te popullit shqiptar per identitetin dhe bashkimin kombetar, me bindjen e thelle se drejtesia, paqja, harmonia dhe bashkepunimi ndermjet kombeve jane nder vlerat me te larta te njerezimit.

Qe ne kete preambul te Kushtetutes sone qendron vetedija dhe krenaria kombetare per historine tone, duke e vene ate ne themel te Rendit Kushtetues, duke marre pergjegjesi per te ardhmen e ketij kombi te lashte European, i cili eshte ne familjen e madhe Europiane duke shprehur besimin tek Zoti si dhe te vlerat e tjera universale, pra duke treguar besim ne vlerat me te mira si dhe vendosmerine per te ndertuar ate shtet te enderuar brez pas brezi, pra shtetin e se drejtes, demokratik e social, ku te jene te garantuara te drejtat dhe lirite themelore te njeriut, pra ku kontrata sociale e individit me shtetin ne sistemin demokratik eshte kontrata kryesore ne nje shtet te se drejtes, ku te drejtat dhe detyrat jane te sanksionuara ne Kontraten Kryesore pra ne Kushtetute te

cilen e kemi krijuar per te pasur vlere ne shtetin e se drejtes pershkruar nga fryma e tolerances e te bashkejeteses fetare, me zotimin per mbrojtjen e dinjitetit dhe te personalitetit njerezor si dhe prosperitetinn e te gjithë kombit per paqen, mireqenien, kulture dhe solidaritetin shoqeror duke u bindur se keto jane vlerat me te mira qe meshiron ky komb ne bindjen e tij te thelle se drejtesia, paqja, harmonia dhe bashkepunimi ndermjet kombeve jane nder vlerat me te larta te njerezimit te cilat ky komb i ka pasur dhe do ti kete ne perkrenaren e tij jetesore.

Te drejtat dhe lirite themelore te njeriut jane te pandashme, te patjetersueshme e te padhunueshme dhe qendrojne ne themel te te gjithë rendit juridik.

Organet e pushtetit publik, ne permbushje te detyrave te tyre, duhet te respektojne te drejtat dhe lirite themelore te njeriut si dhe te kontibuojne ne realizimin e tyre.

Te drejtat e lirite themelore si dhe detyrimet e parashikuara ne Kushtetute per shtetasit shqiptar vlejne njelloj edhe per te huajt e per personat pa shtetesi ne teritorin e Republikës se Shqiperise, me perjashtim te rasteve kur Kushtetuta e lidh ne menyre te posacme me shtetesine shqiptare ushtrimin e te drejtave, lirive dhe detyrimeve.

Kufizime te te drejtave dhe lirive te parashikuara ne Kushtetute mund te vendosen vetem me ligj per nje interes publik ose per mbrojtjen e te drejtave te te tjereve. Kufizimi duhet te jete ne perpjestim me gjendjen qe e ka diktuar ate.

Keto kufizime nuk mund te cenojne thelbin e lirive dhe te te drejtave dhe ne asnje rast nuk mund te tejkalojne kufizimet e parashikuara ne Konventen Europiane per te Drejtat e Njeriut.

Te gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendje ekonomike, arsimore, sociale ose perkatesia prinderore.

Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqet e përmendura më lart nëse nuk ekziston një përgjigje e arsyeshme dhe objektive.

Kushdo që lind duke pasur qofte edhe njërin prej prindërve me shtetësi shqiptare e fiton vetiu shtetësinë shqiptare. Shtetësia shqiptare fitohet edhe për shkaqe të tjera të parashikuara në ligj.

Shtetësi shqiptar nuk mund ta humbasë shtetësinë, përveç kur ai heq dorë prej saj.

Personat që u perkasin pakicave kombëtare ushtrojnë barazi të plotë për ligjin të drejtat dhe liritë e tyre.

Ata kanë të drejtë të shprehin lirisht, pa u ndaluar as detyruar, perkatesinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore. Ata kanë të drejtë të ruajnë e zhvillojnë ato, të mesojnë dhe të mesohen në gjuhën e tyre amtare si dhe të bashkohen në organizata e shoqata për mbrojtjen dhe të identitetit të tyre.

Te gjitha këto sa më sipër përmendem janë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe konkretisht bëjnë pjesë në parimet e përgjithëshme të sanksionuara në Kushtetutën Shqiptare dhe janë në pjesën e dytë si dhe në kreun e parë të saj, ku tregohet qartë se një element thelbësor i demokracisë kushtetuese është edhe vendosja e kufizimeve specifike mbi tagrat (kompetencat) e shtetit kundrejt individit.

Kjo pjesë e Kushtetutës rreshton të drejtat dhe garancitë që çdo individ, shqiptar ose i huaj, gëzon ndaj nderhyrjes së shtetit në jetën e tij. Kufizimet e këtyre të drejtave

lejohen kur jane ne interesin publik ose per mbrojtjen e te drejtave te te tjereve. Cdo kufizim duhet te jete ne perpjestim me rrethanat qe kane kushtezuar dhe nuk duhet ti kaloj ato, e pranuar kjo ne *Konventen Evropiane te te Drejtave te Njeriut* i cili eshte akt universal per mbrojtjen e te drejtave.

Kjo konvente u perfundua ne Rome ne vitin 1950 dhe hyri ne fuqi ne vitin 1953 duke u definuar si nje traktat nderkombetar me ane te te cilit shtetet anetare te Keshillit te Evropes jane angazhuar te garantojne disa te drejta njerezore themelore per te gjitha ata persona qe jane nen juridiksionin e tyre. Rendesia e kesaj konvente qendronte jo vetem ne gjeresine e te drejtave te perfshira ne te por dhe per faktin se ajo shoqerohet nga nje mekanizem mbrojtës qe eshte ngritur ne Strazburg per te evidentuar shkeljet eventuale dhe per te siguruar respektimin e angazhimeve qe jane marre ne baze te konventes. Nga ana tjetër ajo parashikon, si duke shtuar me tej listen e te drejtave te garantuara ne formen e nje katalogu ashtu edhe duke permiresuar procedurat ekzistuese ne formen e nje pyetsori dhe infrastrukture ligjore. Kjo per faktin se konventa dhe mekanizmat e saj nuk kane per detyre te zene vendin e sistemeve kombetare per mbrojtjen e te drejtave te njeriut. Por qellimi i tyre eshte qe te japin nje garanci nderkombetare qe i shtohet te drejtes per ankim dhe rishikim ne shtetet e vecanta.

Përvec shteteve pale edhe ne kemi radifikuar dhe e kemi tashme pjese te perfshire ne te drejten e brendeshme cka do te thote se cdo person mund te paraqese nje ankese ose kerkese per apel ne nje gjykate ose organ kopetent, duke u bazuar drejt per drejt ne dispozitat e konventes. Por edhe ne ato vende ku ajo nuk eshte perfshire ne te drejten e brendshme, nuk duhet te kete konflikt midis saj dhe dispozitave te konventes.

Duke pare Kushtetuten e shkruar vem re, fill pas preambules sa saj eshte vendosur ne pjesen e pare parimet themelore ne 14 nene ku jane percaktuar elementet baze te nje shteti demokratik mbi te cilat do te oregonizohet shtet i ri demokratik. Ky seksion vendos qe shteti shqiptar te jete nje republike parlamentare e bazuar ne ndarjen dhe balancimin e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe atij gjyqesor.

Nepermjet kesaj ndarje dhe balance realizohet nga njera ane detyrimi kushtetues per krijimin e institucioneve kushtetuese dhe nga ana tjeter realizon detyrimin e ketyre institucioneve te cilat kane per detyre te zgjedhin mosmarreveshjet kushtetuese ne lidhje me ndarjen e pushteteve si dhe merren me shqyrtimin e kerkesave dhe ankesave te individeve lidhur me cenimin e te drejtave kushtetuese.

Jo vetem kaq por ne nenin 8 te Kushtetutes gjen vend mbrojtja nga Republika e Shqierise e te drejtave kombetare te popullit shqiptar qe jeton jashte kufijeve te vet gjithashtu u siguron ndihme shtetasve shqiptare qe jetojne dhe punojne jashte shtetit per te ruajtur e per te zhvilluar lidhjet me trashegimine kulturore kombetare<sup>187</sup>.

Ne kete veshtrim sa me siper ka lidhje analitike dhe koherence juridike me dispozitat e konventes persa i perket mekanizmit nderkombetar te mbrojtjes i cili ka dy menyra veprimi dhe konkretisht se pari cdo shtet pale ka te drejte te ankohet prane *Komisionit Evropian te te Drejtave te Njeriut* ne qofte se ai mendon se nje shtet tjeter pale nuk i permbush detyrimet e tij ne baze te konventes (dhe ketu kemi raste ku shteti tjeter ka prekur midis te tjerash situaten e te drejtave te njeriut persa i perket shtetasve shqiptar etj). Se dyti i jep mundesi cdo individi ti drejtohet drejteperdrejt ketij komisioni

---

<sup>187</sup> Kushtetuta e Republikes se shqiperise



me nje ankese kundrejt nje shteti qe eshte pale por qe ka bere nje deklarate te posacme me anen e se ciles njeh kompetencen e komisionit ne kete fushe.

Per sa me siper konventa parashikon tre organet qe duhet te luajne nje rol ne vendimet lidhur me nje ankim te paraqitur nga nje individ ose nga nje shtet pale. Keto jane si vijon:-

- Komisioni Evropian i te Drejtave te Njeriut
- Gjykata Evropiane e te Drejtave te Njeriut
- Komiteti i Ministrave i Keshillit te Evropes

Ne kuadrin kushtetues te radifikimit te konventes nje vend te vacante dhe te rendesishem zene edhe lirite dhe te drejtat vetiake te cilat jane te sanksionuara ne kushtetute ne kreun e dyte te saj ku vec te tjerash jane dy me te rendesishmet dhe konkretisht:-

-E drejta e Jetes! Ajo mbrohet me ligj ne baze te nenit 21 te kushtetutes e cila i le vendin legjislacionit dhe vendimeve gjyqesore persa i perket shenjterise dhe paprekshmerise se jetes se individit.

Kushtetuta as e lejon as e ndalon shprehimisht denimin me vdekje.

E Drejta e Jetes eshte sanksionuar ne nenin 2 te kushtetutes e cila percakton taksativisht:-

E drejta e cdo njeriu per jeten mbrohet me ligj. Askush nuk mund te privohet qellimisht nga jeta, me perjashtim te rastit te zbatimit te gjykates i cili denon nje krim per te cilin ligji parashikon keta denim.

Vdekja nuk quhet e shkaktuar ne kundershtrim me kete nen, ne rastet kur ajo eshte pasoje e perdorimit te forces, i bere absolutisht i domosdoshem:-

- Per te siguruar mbrojtjen e kujdoqofte kunder dhunes se paligjshme.
- Per te kryer nje arrestim te rregullt ose per te penguar arratisjen e nje njeriu ligjerisht te burgosur.
- Per te kundershtuar ne perputhje me ligjin nje tubim ose nje kryengritje.

Po ashtu ne protokollin nr.6 eshte vendosur heqia e denimit me vdekje duke u shprehur se:-

Denimi me vdekje hiqet. Askush nuk mund te denohet me nje ndeshkim te tille dhe as te ekzekutohet.

Ne nenin 2 ajo parashikon dispozita te posacme lidhur me parashikimin me ligj qe shtetet anetare kane te drejte qe me ligjet qe veta ata vendosin per veprime te kryera ne kohe lufte ose rreziku shume te afert te luftes. Nje ndeshkim tille pra do te zbatohet vetem ne rastet e parashikuara me keto ligje dhe ne perputhje me dispozitat e tyre. Kjo dispozite ka formen urdheruese duke urdheruar dhe detyruar pra shtetin ne fjale pra ka detyrimin ligjor qe ti komunikoj Sekretarit te Pergjithshem te Keshillit te Evropes dispozitat qe perfshijne ligjet ne fjale.

Nisur nga fakti se e drejta per jeten eshte nje e drejte e vecante, respektimi i saj eshte kusht i pare dhe themelor per ekzistencen e te gjitha lirive dhe te drejtave te tjera. Shtetet nuk mund ti shmangen detyrimeve qe burojne nga neni 2 madje edhe ne situatat e jashtezakonshme neni 15 i konventes dhe se bashku me nenin 3 te konventes ai shpreh nje nga vlerat themelore te shoqerive demokratike qe formojne Keshillin e Evropes.

- E Drejta e Prones! Edhe kjo eshte nje e drejte vetjake e cila eshte sanksionuar ne kushtetute dhe konkretisht ne nenin 41 ku eshte percaktuar menyra e fitimit te pronesise private me dhurim, me trashegimi, me blerje dhe me cdo menyre tjeter klasike te parashikuar ne Kodin Civil.

Ne keto dispozita eshte percaktuar se ligji mund te parashikojte shpronesime ose konfiskime ne ushtrimin e te drejts se prones vetem per interesa publike dhe kundrejt nje shperblimi te drejte. Gjithashtu eshte sanksionuar edhe reabilitimi ose te zhdemtimit ne perputhje me ligjin, ne rast se eshte demtuar per shkak te nje akti, veprimi apo mosveprimi te paligjshem te organeve shteterore pasi:- Liria, prona dhe te drejtat e njohura me kushtetute dhe me ligj nuk mund te cenohen pa nje proces te rregullt ligjor. Kete koherence juridike e gjejme dhe ne konvente<sup>188</sup> dhe pikerisht ne nenin 1 te protokollit nr.1 ku eshte sanksionuar mbrojtja e prones se cdo personi fizik ose juridik i cili ka te drejte per respektimin e pasurise se tij. Respektimi i prones dhe me gjere i pasurise nenkupton mundesine e perfitimit te papenguar te saj. Ne gjykimin e problemeve qe jane shfaqur ne lidhje me kete ne ceshtje te ndryshme organet e konventes jane perpjekur dukshem qe te vecojne privimin nga pasuria prej rregullimeve te menyres se perfitimit nga ajo. Nderhyrja ne te drejten e pronesise vjen zakonisht si rezultat i vendimeve administrative. Ajo mund te rezultojte edhe nga vendimet gjyqesore apo edhe nga normat juridike si dhe rezultat i veprimeve te subjekteve te tjera te ndryshme nga subjektet si per shembull nga subjekte private.

---

<sup>188</sup> K.E.D.Nj

Ne kreun e IV te kushtetutes<sup>189</sup> jane sanksionuar lirite dhe te drejta ekonomike, sociale e kulturore ku ne do te marrim ne kete studim dy prej tyre dhe konkretisht:-

-E Drejta Familjare! E cila ka nje vend te rendesishem ne te drejta e njeriut pasi cdo njeri ka te drejta te martohet dhe te kete familje te cilat gezojne mbrojtje te vecante te shtetit. Keto te drejta jane sanksionuar konkretisht ne nenet 53 e vijues te kushtetutes<sup>190</sup> si dhe nenin 12 te konventes<sup>191</sup>. Jo vetem kaq por konventa dhe ligjet e posacme parashikojne ne themel te saj barazine e bashkeshorteve ne vijim te barazise gjinore te cilet keto te drejta dhe pergjegjesi me karakter civil midis tyre dhe ne marredhenie me femijet e tyre duhet ti respektojne si gjate marteses dhe gjate zgjidhjes se saj duke pare interesin me te larte te femijeve. Kjo e drejte eshte percaktuar nga ligjveneresi edhe ne Kodin e Familjes qe con ne marrjen e vendimeve ne interesin me te larte te femijes. Ne konvente garantohen te drejta themelore te burrit dhe te gruas per tu martuar dhe per te krijuar familje dhe ushtrimi i kesaj te drejte implikon pasoja te medha personale, shoqerore dhe juridike, duke ju referuar gjithmone mbrojtjes se aktit te lidhjes se marteses dhe konkretisht marteses tradicionale mes nje burri dhe nje gruaje, bashkjeteses si pjese e jetes familjare per maredheniet e pronesise te te drejtave te femijesve te lindur brenda apo jashte martese, te barazuar me ta apo te adoptuar, biresuar, nen kujdestari etj. Dispozitat ligjore te Kodit te Familjes rregullojne kushtet procedural dhe materjale (materjalojuridike) te marteses e cila ka karakter public dhe ecurise se ceremonies martesore si dhe aftesise per te lidhur martese rrethanat te cilat kerkojne dhenien e pelqimit, pengesave etj. Pra familja e krijuar si rezultat i kesaj martese perfiton mbrojtje te vecante!

---

<sup>189</sup> Kushtetuta e Republikes se Shqiperise

<sup>190</sup> Kushtetuta e REpublikes se Shqiperise

<sup>191</sup> K.E.D.NJ

-E Drejta e Punes! Edhe kjo e drejte ka vend te vecante ne dispozitat kushtetuese ne konvente si dhe ne Kodin e Punes dhe ligje te posacme. Kjo e drejte eshte sanksionuar ne nenin 49 e vijues te kushtetutes<sup>192</sup> ku percaktohet se sejcili ka te drejte te fitoje mjetet e jeteses se tij me pune te ligjshme qe e ka zgjedhur ose pranuar vet. Ai eshte i lire te zgjedhe profesionin, vendin e punes si dhe sistemin e kualifikimit te vet profesionit dhe po ashtu ata kane te drejten e mbrojtjes shoqerore te punes.

Sistemi i legjislacionit te punes i paraqet dhe eshte ne pajtim me te drejten nderkombetare te punes si dhe jurisprudences dhe praktikes gjyqsore te Bashkimit European te gjykates ne Strasburg dhe te gjykates se Luxemburgut te cilat perbejne ne thelb standardet qe ne dhe vendi yne permbushim ne prespektiven Europiane. Ne vijim ky legjislacion percohet edhe nga dy karta nderkombetare dhe konkretisht nga Karta Sociale Europiane qe u nenshkrua ne Torino ne dt.18 Tetor te vitit 1961 dhe hyri ne fuqi ne 26 Shkurt te vitit 1965 e cila u konceptua si nje plotesi e Konventes Europiane per te Drejtat e Njeriut ne fushen sociale. Ajo garanton ushtrimin efektiv te 19 te drejtave sociale themelore<sup>193</sup>. Po ashtu zbatim gjen edhe karta e Kombeve te Bashkuara e cila u nenshkrua ne San Franciko ne dt.26 Qershor te vitit 1945 i cili perben nje akt te rendesishem me vlere burimore dhe gjen zbatim te drejteperdrejte ne te drejten e brendeshme pasi kete fuqi juridike ia ka dhene vete neni 5 i kushtetutes ku eshte percaktuar taksativisht se Republika e Shqiperise zbaton te drejten nderkombetare te ndryshueshme per te. Konventa vec te tjerash ka parashikuar edhe mekanizmat mbikqyrese edhe infrastrukturen juridike te kerkesave dhe ankimeve si dhe institucionet ligjore te mbrojtjes se kesaj te drejte.

---

<sup>192</sup> Kushtetuta e Republikes se Shqiperise

<sup>193</sup> K.E.D.NJ

Ne kreun e II te kushtetutes ku jane percaktuar lirite dhe te drejta vetiake ne nenin 24 nje vend te vacante per studimin tone ze edhe liria e ndergjegjes dhe e fese e cila eshte e garantuar dhe sejcili eshte i lire te zgjedhe ose te ndryshoje fene ose bindjet si dhe ti shfaq ato individualisht ose kolektivisht ne publik ose ne jeten private nepermjet kultit, arsimit, praktikes ose kryerjes se riteve. Shteti garanton me kushtetute dhe ligje te posacme qe askush nuk mund te detyrohet ose te ndalohej te marre pjese ne nje bashkesi fetare ose ne praktiken e saj si dhe te beje publike bindjet ose besimin e tij. Ne kete aspekt dhe ne kete kend veshtirim liria e mendimit, e ndergjegjes dhe e besimit gjen mbrojtje juridike nga konventa e cila ne nenin 9 te saj ka pershkruar ne vetevete duke shpjeguar se eshte nje nga bazat e shoqerise demokratike. Zbatimi i nenit 9 te konventes lidh pazgjidhshmerisht eksperiencen e pluralizmit me shoqerine demokratike te cilat jane fituar me veshtiresi pergjate shekujve duke mbrojtur ne radhe te pare sferen e bindjeve personale dhe fetare te individit ate qe shpesh quhet forum i brendshem duke ruajtur keshtu pavaresine ne sferen shpirtore e cila nuk mund ti nenshtrohet asnje kufizimi. Ne rastin tone ekziston bashkejetesa mes besimeve te ndryshme pasi ne nje shoqeri demokratike ku jetojne prane njeri-tjetrit njerez qe perfaqesojne religjone te ndryshme, disa kufizime do te ishin te nevojshme per te pajtuar ketu interesat e grupeve te ndryshme dhe per te siguruar respektimet e bindjeve te ndryshme te cdo personi. Pacifizimi si filozofi gjendet ne kufijte e se drejtes per lirin e mendimit dhe te ndergjegjes. Pozicioni pacifist mund te quhet nje bindje qe mbrohet nga neni 9 pika 1. Nga ky nen buron nje lloj shprese se bashkesia ka liri veprimi te papenguar nga nderhyrjet arbitrare te shtetit. Kjo autonomi ze nje vend themelor ne sistemin e mbrojtjes se lirive se ndergjegjes dhe besimit. Shteti duhet te krijojte kushtet per garantimin e e ushtrimit te lirshem te te drejtes parashikuar ne nenin 9. Ai pergjigjet per

menyren ne te cilen ferkohen publikisht bindjet fetare dhe doktrinat prandaj mund te quajme te nevojshme ndermarrjen e masave represive ndaj formave te caktuara te sjelljes ne kundërshtim me tolerancën e cila duhet te karakterizojë shoqërinë demokratike. Megjithatë masat duhet te jene te karakterit propocional dhe te karakterit juridik si instrumente baze te mos pengimit te lirive te tilla. Ne kreun e III te kushtetutes jane sanksionuar liritë dhe te drejtat politike dhe konkretisht ne nenin 45 e vijues eshte vendosur se cdo shtetas qe ka mbushur 18 vjec qofte edhe ditën e zgjedhjeve ka te drejten te zgjedh dhe te zgjidhet. Ne kete dispozite jane percaktuar edhe ndalime pra raste perjashtimore nga e drejta e zgjedhjes shtetasit e deklaruar me vendim gjyqësor te forms se prere si te paafte menderisht, te denuarit qe kane vuajtur denimin me heqie te lirise kane vetem te drejte per te zgjedhur. Ne votim vota eshte vetjake, e barabarte, e lire dhe e fshehte. E Drejta Zgjedhore! Eshte nje e drejte kushtetuese dhe e drejte per zgjedhje te lira qe ka pa asnje ekuivok cdo individ i cili mund te ushtroje nje prej te drejtave te rendesishme politike. Ne nenin 3 te protokollit nr.1 eshte percaktuar vetem metoda e zgjedhjes “se trupit ligjvenes” dhe jo te zgjedhjeve te tjera si per shembull te zgjedhjeve lokale pasi keto lloj zgjedhjesh jane te sanksionuara ne Karten e te Drejtave Komunale. Pervec percaktimit ne kushtetute te se drejtes zgjedhore kemi dhe ligjin e posacem dhe koncretisht Kodin Zgjedhor, e ku ne boshtin kryesor te ketij legjislacioni jane dy institucione ato te integritetit te votes dhe te fshehtesise se saj. Nese bien keto dy institucione atehere bie gjithë sistemi zgjedhor. Mirepo per qellim te nenit 3 te protokollit cdo sistem electoral duhet vleresuar duke marre parasysh evolucionin politik ne nje vend te dhene. Disa tipare qe mund te jene te papranueshme per njerin sistem mund te jene te arsyetuara per tjetrin. Parimi i “zgjedhjeve te lira” do te thote se nuk mund te ushtrohet presion mbi shtetasin per ta

detyruar atë të votojë për një parti apo kandidat konkret pasi bie ndesh me “lirinë e shprehjes së mendimit të popullsisë në zgjedhjen e trupit ligjvënës”. E drejta e votimit dhe e kandidimit në zgjedhje e garantuar nga kushtetuta dhe konventa është e pandashme nga sistemi i demokracisë së vertetë, do të mbetet iluzive nëse do të ekzistonte mundësia e heqjes arbitrare të kësaj së drejte në çdo rast. Pavarësisht qëllimit të garantimit të pavarësisë së deputetit ose lirisë së zgjedhësve këto kritere ndryshojnë në varësi të faktoreve historik dhe politik të çdo shteti.

### **6.3. --EPILOG--**

#### **-“PROCESI INCIDENTAL”-**

Sistemi ynë i së drejte i përket sistemit të “civil law”, por ligjvënësi në ligjet procedurale dhe konkretisht në nenin 1-6-14-481-të Kodit të Procedurës Civile, në nenin 2 të Kodit të Familjes, në nenin -38 të Ligjit nr 49/2012, të nenit -367, të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur në dispozita të posacme edhe procesin incidental i cili i përket sistemit të “Common Law”, pra i përket sistemit të precedentit, rastit, të drejte se pa shkruar.

Në këto dispozita ligjvënësi i ka dhënë tagre, pra i ka dhënë të drejtë gjykates që të anashkalojë ç’do ligj apo akt nenligjor të cilet mund të jenë marrë në kundërshtim me frymën Kushtetuese, si dhe lirive themelore dhe të drejtave të njeriut, apo konventave ndërkombetare të ratifikuara edhe nëse nuk janë bërë objekt gjykimi për shfuqizimin e tyre si anti kushtetues përmes një kontrolli Kushtetues si dhe nuk janë bërë objekt gjykimi për shfuqizimin apo anulimin e tyre të mara në kundërshtim me ligjin pra si



akte me karakter relativisht apo absolutisht te pavlefshme permes nje kontrolli ligjor, duke i dhene diskricion qe te meret, te analizoj dhe te arsyetoj dhe me pas te shprehet me vendim per rastin,pra per precedentin.

Kjo e drejte qe ligjvenesit i ka dhene gjyqesorit eshte shprehje e nje kontrolli ligjor qe i behet rastit nga gjykata e cila merr ne shqyrtim dy te drejta, ku nga keto dy te drejta prevalon precedenti.

Kjo risi e ben te drejten tone dhe konkretisht ate procedurale te qendroje ne konspiracion, pra ne frymarrje te perbashket permes sistemit te civil law dhe atij common law.

Pra nese e drejta kerkohet proceduralisht dhe materialisht dhe jane palet ato qe e vene ne levizje gjykatat te cilat kane disponibilitet mbi kerkesat dhe akses ne rrugen qe zgjedhin per te mbrojtur te drejten e tyre edhe pse ligji mungon, apo ka kunderthenie apo nuk eshte i qarte, gjykata merr rol aktiv ne shqyrtimin e rastit duke zgjeruar edhe hetimin dhe ne fund merr vendimin e saj.

Po ashtu roli i saj aktiv del edhe tek krijimi i jurisprudences se gjykates se larte permes vendimmarrjes nga Kolegjet e Bashkuara per unifikimit te praktikës gjyqesore.

Si konkluzion dua te sjell ne vemendjen juridike se ne globalizimin e se drejtes dhe te drejtes globale do te kemi edhe nje system miks mes rregullave te shkruara dhe atyre te pashkruara qe i perkasin dy sistemeve klasike civil law dhe atij common law.

Kjo nevoje e kohes vjen si nje imperative juridike ne zgjidhjen e problemeve gri qe sjell situatë gri e ligjit dhe e se drejtes.

## **KAPITULLI VII: KONKLUZIONE**

Te mesosh si te shprehesh idete e tua dhe te pranosh ato te te tjereve, eshte nje pune qe ta shperblen.

Gjeja ideale do te ishte qe cdo teme per te cilen shkruajme te jete me interes per ne. Po ashtu ajo duhet te jete brenda games se pervojes dhe aftesive tona si dhe t'i coje keto pervoja dhe aftesi me tej, ne menyre qe te mos pertypim e ripertypim gjera qe i dime. Tema duhet te jete ne perputhje me gjatesine qe duhet te kete trajtesa jone e cila nuk mund te trajtohet dot brenda nje eseje me pese faqe. Nga ana tjeter, tema nuk duhet te jete as sa per te kaluar radhen, as e pa rendesishme dhe naive.

Une nuk kam nguruar te shprehem me mendimet e mia si dhe me ndjenjat e mia te cilat jane pjese e rendesishme e kesaj teme. Permes ketyre mendimeve dhe ndjenjave une kam shkruar kete teme se si e kuptoj une kete teme dhe cfare ndjej une per kete teme. Nepermjete ketyre dy elementeve pozitiv une kam zbuluar personalitetin tim i cili me ka shtuar interesin per te shkruar kete shkrim, si dhe ne te ardhmen per shkrime te tjera.

Mendoj se nepermjet kesaj teme i`u kam dhene lexuesve me shume se nje arsye qe te parapelqejne qe permes leximit te pelqejne qe te ndjejne mendjen time te vene ne pune, te degjojne nje ze te qarte, te ndajme se bashku ndjeshmeri te verteta e te pazakonshme.

Nga une eshte zgjedhur nje teme as shume e gjere dhe as shume e thjeshte, por permes saj zbulohet nje ndjenje e vertete e cila e ben me interesante, pasi interesin nuk e perben aq shume tema, sesa ajo qe behet me temen ne fjale.

Detyra ime ka qene ta bej punen sa me te qarte qe lexuesi ta kete me te lehte qe te jete e mundur, kam marre shkas nga thenia qe shkruesit e mire e marrin mundimin te shprehen sa me qarte, ne menyre qe lexuesit te mos lodhen pa nevojte per te kuptuar.

Per te realizuar kete kam bere fillimisht pyetje vetes se cfare medoj se dine ose nuk dine lexuesit e ndryshem? Cfare besojne dhe cfare vleresojne ata? Si mund te ndikoj me ato qe i`u them? Me c`mendime, qendrime dhe veprime do te pajtohen? Cfare mund t`i fyej? Cfare kundershimesh mund te kene ndaj mendimeve te mia dhe si mund t`u dal perpara dhe t`u pergjigjem ketyre kundershimeve?

A ka gjasa te kuptojne ironine? A do te merziten apo dote argetohen nga shakate e mprehta, por jo fort konvecionale?

E thene ndryshe ne pergjigje dua te theksoj se lexuesve nuk u pelqen kur shkruesi niset nga premisa se ata duhet te kene shume njohuri. Perfshirja e fjaleve dhe informacioneve te pazakonta, pa dhene asnje shpjegim, eshte disi perulese, njesoj si t`i thuash "une di me shume se ju". Nga ana tjeter, edhe shpjegimi i gjerave qe dihen nga te gjithete, nenkupton mendim te ulet per lexuesin.

Te vleresosh nivelin e njohurive te lexuesve nuk eshte e lehte, por ne qofte se gabimi eshte i pashmangshem, me mire te gabosh duke thene me shume se sa me pak. Po keshtu, nuk eshte e lehte te masesh bindjen dhe vleren e tyre. Ideja pak a shume e qarte per lexuesin krijohet vetem gradualisht, me grumbullim pervoje, edhe atehere nuk eshte e perkryer. Megjithate, takti dhe respekti hapin cdo dore.

Shkruesit kane egocentrizmin por edhe lexuesit kane egon e tyre. Ne kete kuader nisur nga perkufizimi se qellim do te thote ndikimi qe duam te arrijme mbi lexuesin, ai mund te jete tri llojesh:-per t'i informuar, per t'i bindur dhe per t'i argetuar. Gjithsesi ka edhe nje qellim te katert qe eshte manipulimi dhe corjentimi i lexuesit. Gjithsesi keto qellime nuk perjashtojne njera-tjetren. Une kam pasur per qellim ne kete shkrim qe t'i informoj dhe t'i bind lexuesit e mi te kesaj teme pse eshte e rendesishme qe lexuesit te mos i merzitesh, por kjo nuk do te thote qe t'i bej lajka, apo te kem frike qe te them gjera me te cilat ata mund te mos pajtohen. Kjo do te thote qe lexuesit duhen respektuar dhe se nuk duhet menduar vetja me i mire se ata, por ne te vertete nese besoni ne thonjza me naivitet se jeni superior, une ju bej thirrje duke ju thene se po te jeni te zgjuar, nuk e shfaqni kete ndjenje.

Cilido qellim te jete me kryesor, ai do t'ia dale mbane ose do te deshtoje ne varesi te mases ne te cilen i keni pasur parasysh lexuesit e shkrimit tuaj.

Pra nuk duhet menduar se lexuesi do te jete patjeter i interesuar per ate qe ke shkruar apo qe do te shkruash ne te ardhmen, ose qe ata kane durimin e pashtershem per tu "capitur" neper morine e fjaleve dhe shprehjeve te paqarta, deri sa te arrijne te gjejne kuptimin. Por duhet pranuar sfida sepse:-Cdo person i afte te mendoje, ka shume per te shkruar, por edhe lexuesi ka shume per te thene, por ne duhet te jemi te gatshem qa ta pranojme sfiden. Te shkruarit na ve ne kerkim te burimeve tona dhe, zakonisht, ato nuk jane te mjaftueshme, sepse te shkruash eshte ndryshe nga te folurit pasi te shkruarit dhe te folurit jane te dyja forma te komunikimit qe perdorin gjuhen. Eshte mire qe kur shkruan te perfytyrosh sikur po flet me dike duke u perpjekur t'i shpjegosh idete dhe ndjenjat e tua pasi folesit varen nga nje varg rrethanash jashte gjuhesore te komunikimit si toni i zerit, volumi i ngritur, apo i ulet, nje vetulle ngritur, nje rrudhje supesh, nje gjest

perbuzes apo theksues. Per me teper, zakonisht folesit kane te njejten baze ineresash dhe pervoje me degjuesit, gje qe mund te kompesoje mungesen e qartesis ne gjuhe. Kurse ata qe shkruajne nuk mund te mbeshteten tek afersia me lexuesin, e as t'i bertasin, te pershperitin, t'i shkelin syrin, te bejne shenje me gisht, apo ta kapin prej jake.

Gjithe kuptimi i asaj qe duan te thone shkruesit del permes fjaleve te tyre, dhe ne qofte se ato jane te paqarta, nuk ka menyre tjeter kompesimi.

Te shkruarit na detyron te hulumtojme dhe, si pasoje, te zgjerojme aftesine tone per te menduar, per te ndjere dhe perceptuar. Mesimi i te shprehurit ne leter mund te mos na beje me te mire ne kuptimin moral (megjithese shpresojme qe edhe kjo te ndodh), por na ben individe me te gjithanshem dhe interesant, me te ndergjegjesuar per veten dhe boten perqark nesh.

Thuhet qe te shkruash mund te mesohet, por nuk mund te jepet mesim. Ky paradoks nxjerr ne pah nje kuptim te rendesishem.

Pra, te shkruash jo vetem qe mund te mesohet, ia vlen te mesohet. Ne te vertete, qe te mesosh se si te shkruash do te thote te mesosh per vetveten dhe ta zhvillosh ate. Ne nje kuptim, te shkruarit nuk eshte thjesht "veprimtari". Ai ka te beje me vete qenien tone: cfare dhe kush jemi, cfare besojme, ndejme dhe dime, si na kuptojne te tjeret dhe si lidhen ata me ne. Perfitimi me i madh nga mesimi i te shkruarit nuk eshte se permes tij kenaq vec te tjerash mesuesin, profesorin, kalon klasen apo ben perpara ne karriere, sado te deshirueshme te jene keto synime, del qarte se perfitimi me i madh nga te shkruarit eshte zhvillimi yne vetjak si qenie njerezore.

Arti i te shkruarit eshte nje mrekulli e pafundme, nje sfide intelektuale e rendit te larte. Megjithate, ende nuk eshte percaktuar menyra me e mire per t'i aftesuar ata qe

duan te perballen me kete sfide. Te shkruarit "vuan" nga nje veshtiresi e vecante. Kur shkruajme, bejme nje numer veprimesh pothuajse njekohesisht: organizojme dhe rendisim idete, mendojme per lexuesin, zgjedhim fjalet, togfjaleshit, fjalite etj. Te menduarit, zgjedhja e fjaleve, krijimi i fjalive, te gjitha kryhen pak a shume se bashku, njekohesishte. Megjithate per ta mesuar te shkruarin duhet vendosur nje fare regulli.

Ceshtja eshte nga te fillojme dhe si te vazhdojme.

Pra edhe ne shkrimin ligjor persa i perket dispozitave ligjore te ndryshme, ne duhet qe te fillojme jo vetem me shkrimin laik, por dhe me shkrimin juridik duke vazhduar mepas nepermjete jo vetem fjalorit te gjuhes Shqipe, por dhe nepermjete fjalorit te termave juridike i cili na ben te mundur qe te krijojme shprehje te ndryshme juridike me qellim te leximit, kuptimit, inerpimit, logjikimit, arsyetimit te shkrimit ligjor.

Gjithcka vjen nepermjet edukimit dhe ne vacanti "Edukimit nepermjet ligjit," edukimit qytetar, ku rolin kryesor e luan emancipimi i individit, familjes, shoqerise.

Ne themel te gjithckaje duhet te jete gjithmone dhe vetem gjithmone

- 1- Shteti i se drejtes.
- 2- Lirite themelore te individit.
- 3- Demokracia.

Kjo eshte absolute ne shoqerine kontraktuale ku kontrata sociale me e madhe eshte ***Kushtetuta***.

Qe te kemi nje siguri juridike, ekonomike dhe politike nuk duhet te kemi denatyrin te prones dhe te votes pasi denatyrimi, pra shtremerimi i ketyre dy institucioneve te

rendesishme sjell me pas dhe denatyrimin dhe shtremberimin e njeriut, familjes, shoqerise, institucioneve dhe shtetit te se drejtes.

Por per te aritur ketu duhet shume pune, studim si dhe respektim pasi ligjet nuk jane bere per tu shkelur por per tu zbatuar. Jo vetem kaq por cdo vendim i marre si individ, si familje, si shoqeri dhe si institucione duhet te merret duke pasur ne qellimin e tij interesin me te madh dhe me te larte te femijes sepse kjo eshte e ardhmja jone. Por per te arritur kete imperative te kohes duhet te duam vendin tone qe ti japim atij dhe jo ti marrim, duhet te duam drejtesine per ti dhene asaj dhe jo per ti marre asaj, duhet te krijojme jo nje klime acide, por nje klime bazike sepse nuk eshte rastesisht e sanksionuar ne konventen nderkombetare te te drejtave te femijeve dhe pikerisht ne nenin 1 ku thuhet se:

“Kemi te drejte te jetojme ne nje bote te mbushur plote me dashuri”. Pra a jemi ne ne gjendje qe me ligjet tona, politiken tone qe t’i bejme te mundur femijeve kete bote te mbushur plot me dashuri!

Une them se po, dhe nuk heq dore nga kjo pasi jam i mbrujtur me kete dashuri per femijet, jeten, te drejten, vendin tone.

Ne se do te me pyesnin ne kete moment se cfare ke deshire te besh, do te kerkoja qe te kisha mundesi qe ne pamundesi qe te miratoja nje ligj te posacem per femijet, te kisha mundesi qe te isha femije, atehere lind pyetja se kush mund ta realizoje kete mundesi ..... ! ..... Sa do te doja te isha femije .....!

## **BIBLIOGRAFIA**

1. E Drejta Romake, faqe 525-551 (Ken Dhima Tirane 2007) Botimi i pare MEDAUT.
2. Koncepti i se Drejtes, faqe 67-89 (Herbert.L.A.Hart) Botuar nga ISP & DITA 2000.
3. Kushtetuta e Republikes se Shqiperise Tirane 1998 nenet 41-42-43.
4. Kodi Civil nenet 149-153-168-199-296-302 e vijues te tij.
5. Kodi i Procedures Civile nenet 31-369 e vijues te tij.
6. Kodi Penal nenet 134-140-141-147-199-200-205-206.
7. Kodi i Procedures Penale nenet 61 e vijues te tije.
8. Kodi i Familjes nenet 66-108 e vijues te tij.
9. Drejtësia Kushtetuese, faqe 155-178 (Kristaq Traja Tirane 2000) Shtepia Botuese Luarasi.
10. Kontrolli Kushtetues (Sokol Sadushi Tirane 2004) Shtepia Botuese BOTIMPEX.
11. Njohuri per Ligjin, faqe 30-54 (Fondacioni i Shoqerise se Hapur per Shqiperine) Botimi Horizonti Tirane 2001.
12. Rreth Konventes Europiane neni 6 K.E.D.Nj
13. E drejta per nje proces te rregullt gjyqesor. faqe 159-162 (Marek Antoni Nowicki Tirane 2003) Botimet Morava.
14. Historia e Institucioneve, faqe 157-173 (Aurela Anastasi Tirane 1998) Shtepia Botuese "Libri Universitar".
15. Arsyetimi dhe Shkrimi Ligjor, faqe 7-12, 25-43 (Sokol Berberi Tirane 2012) Botimet Morava.
16. Antropologjia Kulturore Nje Prespektive Bashkohore, faqe 300-315 (Roger Keesing-Andrew Strathern Tirane 1998) botimi i UFO University.
17. Hyrje ne Antropologji botimi 3, faqe 254-272 (Aleksander Dh Dhima Tirane 2010), botimet ideart



18. E Drejta Romake, faqe 525-551 (Ken Dhima Tirane 2007) Botimi i pare MEDAUT.
19. Koncepti i se Drejtes, faqe 67-89 (Herbert.L.A.Hart) Botuar nga ISP & DITA 200.
20. Kushtetuta e Republikes se Shqiperis Tirane 1998 nenet 41-42-43.
21. Kodi Civil nenet 149-153-168-199-296-302 e vijues te tij.
22. Kodi i Procedures Civile nenet 31-369 e vijues te tij.
23. Kodi Penal nenet 134-140-141-147-199-200-205-206.
24. Kodi i Procedures Penale nenet 61 e vijues te tije.Kodi i Familjes nenet 66-108 e vijues te tij.
25. Drejtesia Kushtetuese, faqe 155-178 (Kristaq Traja Tirane 2000)S htepia Botuese Luarasi.
26. Kontrolli Kushtetues (Sokol Sadushi Tirane 2004) Shtepia Botuese BOTIMPEX.
27. Njohuri per Ligjin, faqe 30-54 (Fondacioni i Shoqerise se Hapur per Shqiperine) Botimi Horizonti Tirane 2001.
28. Rreth Konventes Europiane neni 6 K.E.D.Nj
29. E drejta per nje proces te rregullt gjyqesor. faqe 159-162 (Marek Antoni Nowicki Tirane 2003) Botimet Morava.
30. Historia e Institucioneve, faqe 157-173 (Aurela Anastasi Tirane 1998) Shtepia Botuese "Libri Universitar".
31. Arsyetimi dhe Shkrimi Ligjor, faqe 7-12, 25-43 (Sokol Berberi Tirane 2012) Botimet Morava.
32. Antropologjia Kulturore Nje Prespektive Bashkohore, faqe 300-315 (Roger Keesing-Andrew Strathern Tirane 1998) botimi i UFO University.
33. Hyrje ne Antropologji botimi 3 ,faqe 254-272 (Aleksander Dh Dhima Tirane 2010), botimet ideart.
34. Kushtetuta e Rrepublikes se Shqiperise (Tirana 1998 )
35. Kodi I Familjes (Tirana 2003 ,nenet 215,216,217,220,221,222,223,224,225,226,227,228-306, 232337,)
36. Kodi Penal (Tirane 1995)

37. Konventa Nderkombetare e te Drejtave te Femijeve (Miratuar nga asambleja e organizates se kombeve te bashkuara me 20 Nentor 1989)
38. Konventa nderkombetare e te Drejtave te Njeriut.(Botim I qendres shqiptare per te drejtat e njeriut ,Tirane 2003.)
39. Marreveshje per radifikimin e Konventesse Keshillit te Evropes(ligji10425, 10424date 2.6.2011.)
40. -Konventa Europiane e te Drejtave te Njeriut (botimi Morava, Tirane 2003)
41. -Kushtetuta e Republikes se Shqiperise (Botimi I Alb JURIS &Jursprudenca Kushtetuese 2012),
42. -Kodi I Punes se Republikes se Shqiperise I vitit 1995( me ndryshimet dhe plotesimet e bera ne -vitet 1996,2003,2008 ,botime zyrtare)si dhe akte te tjera normative perkatese me kryesore qe kane hyre ne fuqi gjate periudhes prej botimit te meparshem.
43. -E Drejta ePunes (Prof.Dr.Kudret Cela, Botimi XIII, Tirane 2011)
44. E Drejta Romake, faqe 525-551 (Ken Dhima Tirane 2007) Botimi I pare MEDAUT.
45. Koncepti i se Drejtes, faqe 67-89 (Herbert.L.A.Hart) Botuar nga ISP & DITA 200.
46. Kushtetuta e Republikes se Shqiperise Tirane 1998 nenet 17-18-41-42-43.
47. Jurisprudenc e Gjykates Kushtetuese, V.Gj.K(interpretime).
48. Kodi Civil nenet 149-153-168-199-296-302 e vijues te tij.
49. Kodi i Procedures Civile nenet 31-369 e vijues te tij.
50. Kodi Penal nenet 134-140-141-147-199-200-205-206.
51. Kodi i Procedures Penale nenet 61 e vijues te tij. Kodi I Familjes nenet 66-108 e vijues te tij.
52. Drejtesia Kushtetuese, faqe 155-178 (Kristaq Traja Tirane 2000) Shtepia Botuese Luarasi.
53. Kontrolli Kushtetues (Sokol Sadushi Tirane 2004) Shtepia Botuese BOTIMPEX.
54. Njohuri per Ligjin, faqe 30-54 (Fondacioni I Shoqerise se Hapur per Shqiperine) Botimi Horizonti Tirane 2001.
55. Rreth Konventes Europiane neni 6 K.E.D.Nj

56. E drejta per nje proces te rregullt gjyqsor, faqe 159-162 (Marek Antoni Nowicki Tirane 2003) Botimet Morava.
57. Historia e Institucioneve, faqe 157-173 (Aurela Anastsj Tirane 1998) Shtepia Botuese “Libri Universitar”.
58. Arsyetimi dhe Shkrimi Ligjor, faqe 7-12, 25-43(Sokol Berberi Tirane 2012) Botimet Morava.
59. Antropologjia Kulturore Nje Prespektive Bashkohore, faqe 300-315 (Roger Keesing-Andrew Strathern Akademik, Lexime dhe Strategji, faqe 3-33 (Jill Lewis 2005) botimi I (CDE) Qendra per Arsim Demokratik.
60. Hyrje ne Antropologji botimi 3, faqe 254-272 (Aleksander Dh Dhima Tirane 2010) Botimet Ideart.
61. E Drejta Agrare e Shqiperise .faqe 19-36,37-71.(Botim i ripunuar)Prof.Dr Paskal Haxhi&Ma Edvin Haxhi (shtepia botuese” albin”Tirane 2008.
62. Studimi Akademik, Lexime dhe Strategji, faqe 3-33 (Jill Lewis 2005) botimi i (CDE) Qendra per Arsim Demokratik.
63. Studimi Akademik, Lexime dhe Strategji, faqe 3-33 (Jill Lewis 2005) botimi i (CDE) Qendra per Arsim Demokratik.
64. Mbi Frymen e Ligjit, faqe 1-37 (Montesquieu Tirane Luarasi 2000) Shtepia Botuese Luarasi.
65. Mbi Frymen e Ligjit, faqe 1-37 (Montesquieu Tiran Luarasi 2000)S htepia Botuese Luarasi.
66. Mbi Frymen e Ligjit, faqe 1-37 (Montesquieu Tirane Luarasi 2000) Shtepia Botuese Luarasi.
67. Filozofi e se Drejtes, faqe 11-48(Xhefri G.Meri and Xhuls L.Kolman Tirane 1992) Shtepia Botuese Lura.
68. Filozofi e se Drejtes, faqe 11-48 (Xhefri G.Meri and Xhuls L.Kolman Tirane 1992) Shtepia Botuese Lura.
69. Filozofi e se Drejtes, faqe 11-48 (Xhefri G.Meri and Xhuls L.Kolman Tirane 1992) Shtepia Botuese Lura.
70. Historia e Shtetit dhe e se Drejtes ne Shqiperi, faqe 11-23, 62-68, 229-274 (L.Omari-A.Luarasi, Botimi i Trete Tirane 2005) Botuar nga University Press”LUARASI.

71. Historia e Shtetit dhe e se Drejtes ne Shqiperi, faqe 11-23, 62-68, 229-274 (L.Omari-A.Luarasi, Botimi i Trete Tirane 2005) Botuar nga University Press "LUARASI.
72. Historia e Shtetit dhe e se Drejtes ne Shqiperi, faqe 11-23, 62-68, 229-274 (L.Omari-A.Luarasi, Botimi i Trete tirane 2005) Botuar nga nga University Press "LUARASI".
73. Kodi Civil (nenet,2,6,64 ,etj Tirane 1994,)
74. -Dekreti nr 7458 dt.22.01.1991 (per te drejten e greves) botimi zyrtar
75. Ligji nr 7703 dt 11.05.1993" Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise" ,ndryshimet me ligjet(Botim I qendres se publikimeve zyrtare shtator 2010)
76. -V.K.M nr 304 dt 30.06.1994 "Per dokumentacionin e perfitimit te ndihmes ekonomike" (botim I qendes se publikimeve zyrtare shtator 2010)
77. -Ligji nr 7870 dt 13.10.1994"Per sigurimet shendetesore ne republiken e shqiperise"(botim I qendres se publikimeve zyrtare shtator 2010)
78. Ligji nr.8888 dt.25.04.2002"Per ratifikimin e konventes per krimin ne fushen e kibernetikes".
79. Shkrimi legjislativ, faqe 3-19 (Viktor Gumi 2006) Botimet Dudaj.
80. Shkrimi legjislativ, faqe 3-19 (Viktor Gumi 2006) Botimet Dudaj.
81. Shkrimi legjislativ, faqe 3-19 (Viktor Gumi 2006) Botimet Dudaj.